

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës

**PASQYRË MBI SISTEMIN E GJYQËSISË PENALE NË KOSOVË
1 SHTATOR 2000 – 28 SHKURT 2001**

FJALORI I SHKURTESAVE

OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
SMSJ	Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik
DD KB	Departamenti i Drejtësisë i Kombeve të Bashkuara
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së
LP RFJ	Ligji Penal i RFJ-së
LPK	Ligji Penal i Kosovës
SEGJ	Sistemi Emergjent i Gjyqësisë
KPK EGJ	Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës për Emërime në Gjyqësi
KKJ	Komisioni Konsultativ Juridik
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
COMKFOR	Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë
KFOR	Forcat Ushtarake në Kosovë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
KEGjFDKG	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut
QPS	Qendrat për Punë Sociale

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo pasqyrë është raporti i dytë publik mbi sistemin të drejtës penale i përpiluar nga *Seksioni për Monitorim të Sistemit Juridik (SMSJ) të Shtyllës së III të UNMIK-ut (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian – OSBE)*. Raporti mbulon periudhën kohore prej 1 Shtatorit deri me 28 Shkurt.

SMSJ ka monitoruar 62 prej 159 gjykimeve në gjykatat e qarkut të përfunduara këtyre ditëve të fundit (38%). Prej gjykimeve të përfunduara në këtë periudhë kohore, 183 të pandehur janë dënuar ndërsa 63 janë liruar (75% shkalla e dënimit). Ky raport gjithashtu i referohet një numri të gjykimeve të papërfunduara deri me datën 28 Shkurt. Gjithsejt, gjatë 12 muajve të kaluar SMSJ ka monitoruar 139 gjykime në gjykatat e qarkut (50%). Prej të gjitha gjykimeve të përfunduara në këtë periudhë kohore, 323 të pandehur janë dënuar dhe 92 prej tyre janë liruar (78% shkalla e dënimit).

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është i pajisur me pushtetin e tërë ekzekutiv dhe legjislativ, i cili ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP). Mandatin për Administrimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë e ka UNMIK-u, ndërsa Departamenti i Drejtësisë është përgjegjës për menagjimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues. OSBE-ja, si pjesë e UNMIK-ut, bartë përgjegjësinë e cila i'u është dhënë nga Këshilli i Sigurimit të KB “ *për t’u siguruar se çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimit të tyre, janë të adresuara gjatë aktiviteteve të gjithmbarshme të misionit*”.

Ky raport publik ofron një pasqyrë gjithpërfshirëse të sistemit gjyqësor nga perspektiva e ligjeve për të drejtat e njeriut. Në pajtim me *Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB*, dhe letrës së Sekretarit të Përgjithshëm të KB të datës 12 Korrik 1999, dërguar Këshillit të Sigurimit të KB, qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë në “*zhvillimin e mekanizmave të garancioneve që policia, gjyqet, tribunatet administrative dhe organet tjera gjyqësore (të veprojnë) në pajtim me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut*”. Duke u thirrur në këtë mandat raporti mbështet zhvillimin e sistemit të drejtësisë penale duke identifikuar problemet konkrete dhe duke ofruar strategji të adresimit të tyre në një mënyrë koherente dhe gjithpërfshirëse.

Në vitin 1999, UNMIK-u ishte ballafaquar me një detyrë shumë të ndërlikuar dhe të madhe në krijimin e sistemit të drejtësisë penale i cili u nis nga asgjëja, jo vetëm me një kornizë të re ligjore por edhe me anëtarë të rinjë. Për shkak të heqjes së privilegjeve gjyqësore për një numër të rëndësishëm të gjykatësve vendor për një periudhë dhjetëvjeqare e më tepër, gati të gjithë nga gjykatësit dhe prokurorët e tanishëm nuk kanë qenë të privilegjuar në përdorimin e shkathtësive të tyre ligjore apo në vazhdimin e edukimit të tyre ligjor. Duhet shtuar se ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk janë përfillur në kornizën ligjore të vendit deri në shfaqjen e UNMIK-ut. Si pasojë, deri në këtë moment, judikatura nuk ka pasur qasje në këto ligje e as në Ligjet dhe procedurat tjera moderne të Evropës. Gjithashtu pjesa më e madhe e infrastrukturës së gjykatave ishte e varfër.

Duke pasur parasysh këto pengesa, UNMIK-u dhe zyrtarët e judikaturës kanë arritur shumë gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar. Gjykatat e qarkut kanë vazhduar punën me një numër të rëndësishëm të proceseve gjyqësore penale. Pa marrë parasysh problemet e identifikuara në këtë raport, shumë lëndë penale janë zgjidhur drejtë, që do të thotë aktgjykimet liruese dhe ato ndëshkuese kanë qenë të bazuara në dëshmi të mjaftueshme.

Që nga raporti i fundit, ka pasur zhillime përmbajtësore. Inkuadrimi më i madh i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë ka qenë njëri prej zhvillimeve më të rëndësishme. Si përgjigje ndaj shqetësimeve momentale mbi animin (subjektivitetin) gjyqësor kundër Serbëve të Kosovës në sistemin e drejtësisë penale, Rregulloret më të reja lejojnë që palët të kërkojnë bartjen e lëndës në trupin gjykues ku shumica e anëtarëve do të jenë ndërkombëtarë. Zbatimi fillestar në praktikë i kësaj Rregulloreje megjithatë ka pasur rezultate të përziera. Kjo më shumë për shkak të mungesës së politikës së qartë mbi atë se cilat lëndë do të vlejnë për trupin gjykues ndërkombëtar, gjë që pjesërisht ka shkaktuar konfuzion në kuadër të komunitetit ligjor dhe zemërim në judikaturë.

Duke u bazuar në shqetësimet mbi animin gjyqësor, raporti i fundit ka potencuar çështjen se si mungesa e ndonjë monitorimi efektiv dhe mekanizmi disiplinor ka lejuar që administrimi i keq i drejtësisë të kalojë relativisht pa u ndëshkuar. Në këto baza, është krijuar njësitë për inspektimin e gjyqësisë i DD KB dhe tani është duke shqyrtuar pohimet mbi administrimin e keq të drejtësisë. Si përgjigje ndaj kritikave të Komisionit Konsultativ Juridik, struktura e tij (njësitit) është rishqyrtuar, në mënyrë që të sigurohet se do të ketë një mekanizëm efektiv disiplinor. Rastet e fundit vazhdojnë të indikojnë në animin gjyqësor kundër Serbëve të Kosovës dhe rastet e tilla kërkojnë hetime. Dy raste të administrimit të keq të drejtësisë që janë potencuar në raportin e fundit, *Momcilovic* dhe *Berisha* pritet të shqyrtohen.

Përkundër theksimeve të bëra në raportin e kaluar mbi të drejtat e personave të burgosur(paraburgosur), ekziston mungesë e vazhdueshme e ndonjë baze të procedurës *habeas corpus* (me të cilën personi i burgosur (paraburgosur) mund të kundërshtoj ligjshmërinë e burgosjes së tij) dhe procedurave të cilat garantojnë personave të burgosur qasje efektive në mbrojtës. Mungesa e procedurës *habeas corpus* paraqet shqetësim të veçantë për rastet e burgosjeve jashtë-gjyqësore nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe nga prania ushtarake.

Gjatë gjashtëmujorit të kaluar, shumica e qendrave të paraburgimit janë vendosur nën kontrollin e Administrimit Penal të KB. Administrimi Penal i KB ka bërë përpjekje për të siguruar se të miturit e burgosur do të kenë mundësi për edukim të duhur, e gjithashtu përpjekjet janë bërë për zhvillimin e masave edukuese institucionale në kuadër të burgut të Lypjanit. Përdorimi i alternativave – karshi burgosjes (paraburgimit) për të miturit nga ana e gjykatave megjithatë nuk është rast aq i shpeshtë. Në rastet e burgosjes(paraburgimit) të personave të sëmurë psiçikisht, ekziston nevoja për një mekanizëm i cili do të sigurojë të drejtat për një trajtim të duhur dhe një gjykim të drejtë. Në këtë aspekt, mungesa e objekteve të duhura për trajtimin e personave të sëmurë

mentalisht në fazën e paraburgimit dhe në fazën e vuajtjes së dënimit me burg paraqet një shqetësim serioz.

Raporti i kaluar ka potencuar problemet e vonesave në procedurë kundër personave të burgosur si të dyshuar dhe atyre të pandehur. Problemet organizative dhe procedurale me të cilat ballafaqohen gjyqet vazhdojnë të vështirësojnë mundësitë e tyre për zhvillimin efektiv të procedurave, e në veçanti atyre post-aktakuzuese. P.sh. gjykimet shpeshherë janë shtyer për shkak të dështimit në kryerjen e analizave mjeko-ligjore, në vlerësimin e kapacitetit mental të të pandehurit apo në thirrjen e dëshmitarëve. Në shumë raste, gjykatave nuk u është dhënë mundësia dhe mjetet e domosdoshme për administrimin e drejtësisë në mënyrë të drejtë dhe efektive. Problemet e vazhdueshme për një shërbim adekuat të thirrjes gjyqësore paraqesin njërin prej shembujve. Për të shtuar se aktiviteti policor shpeshherë është parë si joefektiv dhe jokonsistent, posaçërisht në mbledhjen e dëshmive. Mungesa e kapacitetit të mjekësisë ligjore elementare, ka shkaktuar dështime në ndjekjen dhe hetimin efektiv të veprave penale serioze.

Mungesa e përgjithshme e mbështetjes për viktimat/dëshmitarët, shërbimeve për ndihmesë dhe mekanizmave mbrojtës kanë qenë faktor dëmtues për procedurat gjyqësore. Raporti i kaluar është fokusuar në këto çështje në kontekst të rasteve të dhunës seksuale (duke përfshirë edhe shkeljet që kanë të bëjnë me trafikimin) dhe rastet e dhunës brenda-familjare (duke përfshirë edhe keqpërdorimin e fëmiut). Institucionet kryesore dhe përgjegjëse për të miturit në shtetin e drejtësisë penale, apo të atyre që kanë qenë subjekt i keqpërdorimit janë Qendrat për Mirëqenie(Punë) Sociale në kuadër të Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky institucion ka për qëllim të merr përsipër rolin kryesor në të gjitha rastet e dhunës familjare dhe të miturve që janë në kundërshtim me ligjin. Pa funksionimin e këtij institucioni, policia dhe gjykatat nuk kanë pasur mundësi të merren në mënyrë të duhur me rastet penale për të miturit dhe rastet e dhunës në kuadër të familjes.

Për dallim prej jurisdikcioneve tjera civilo-juridike, sistemi i tanishëm inkvizitor (akuzator) ka nevojë për një zhvillim, në mënyrë që të takojë sfidat e marrëveshjeve ligjore regjionale dhe ndërkombëtare. Problemet në procedurat penale vazhdojnë të jenë prezente dhe shfaqen me parregullësitë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, pranueshmërisë së dëshmive jorelevante dhe të papranueshme, mungesa e saktësisë gjatë hetimeve dhe në procesverbalet gjyqësore, dhe nevoja për arsyetim (sqarim) gjyqësor gjatë vërtetimit të gjendjes faktike. Ngjashëm, mbrojtësit vazhdojnë të luajnë një rol pasiv gjatë përfaqësimit të klientëve të tyre. Për adresimin e këtyre shqetësimeve është i domosdoshëm një trajnim i obligueshëm dhe i cili do të përqendrohej në zhvillimin e shkathtësive elementare ligjore.

Gjatë gjashtë muajve të kaluar, UNMIK-u ka reaguar me vendosmëri ndaj shumë mangësive në sistemin juridik të Kosovës. Në të vërtetë, për zhvillimin e një sistemi të tillë, analiza dhe zgjidhja e problemeve bëhet një nevojë e përditshme. Krahas kësaj, megjithatë nevojitet të zhvillohet një qasje sistematike dhe strategjike për adresimin e çështjeve të nënvizuara.

Krahas kësaj, kjo ka shkaktuar një tension të panevojshëm në mes të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nevojës për sigurimin e ligjit dhe rendit. Dilema me të cilën përballohet momentalisht sistemi gjyqësorë nuk është ajo e konfliktit në mes të sigurisë dhe drejtësisë, për por ajo e nivelit të procesit të sfidave për krijimin e procedurave dhe politikave të reja për adresimin e nevojave reale për gjykatat dhe organet e rendit publik – duke garantuar për të pandehurit një procedurë të drejtë dhe trajtim konsekuent. Kërkesa për vendosjen e kufizimeve të bazuara në ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duket se nuk do të zgjidhë problemet në sistemin gjyqësor dhe as që do të adresoj në mënyrë efektive problemin e sigurisë. Krijimi i një strategjie të qartë, të planifikuar, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për adresimin e problemeve akute dhe afatgjate në sistemin e drejtësisë, duke garantuar proces të drejtë, akoma paraqet sfidë kritike për UNMIK-un.

Ky raport nuk do të mund të realizohej pa ndihmesën e personelit gjyqësor dhe profesionistëve juridik. OSBE, dëshiron të shprehë falenderim për personelin gjyqësor të cilët kanë mundësuar monitoruesve të SMSJ, kryerjen e detyrave të veta. OSBE, gjithashtu dëshiron të shprehë falenderim për Drejtorët e Burgjeve, për Policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in.

PËRMBAJTJA

Fjalori i shkurtesave

Përmbledhje ekzekutive

Pjesa 1: Monitorimi	9
I. Mandati i Seksionit për Monitorim të Sistemit Juridik	9
II. Raporti me Shtyllat tjera	10
III. E drejta në gjykim objektiv (të drejtë)	11
IV. Rastet prioritare	11
Pjesa 2: Ligji i zbatueshëm	16
I. Zhvillimet e rëndësishme në Ligjin e zbatueshëm	16
II. Ritheksimet nga Raporti i kaluar	17
III. Grupi punues për implementimin e Raportit të parë të SMSJ-së për të drejtësinë penale	21
Pjesa 3: Paraburgimi	23
I. Paraburgimi jashtë-gjyqësorë	23
II. Afatet kohore të mbajtjes në paraburgim dhe zgjatja e paraburgimit,	27
III. Burgosja e personave të sëmurë mentalisht	31
IV. Të miturit në paraburgim	36
Pjesa 4: Gjykatat: I. Çështjet Organizative	39
I. Qasjet ndaj Arsytimit ligjor	39
II. Problemet procedurale	44
III. E drejta në përfaqësim ligjor efektiv	46
IV. Trajnimi	49
Pjesa 5: Gjykatat: II. Administrimi i drejtësisë	50
I. Mjetet hetimore, kapacitetet mjeko-ligjore dhe thirrja e dëshmitarëve	50
II. Frikësimi i Gjyqësisë	56
III. Gjyqësia	58
Pjesa 6: Viktimat e dhunës seksuale	63
I. Viktimat e veprave penale që kanë të bëjnë me Trafikimin	64
II. Deliktet seksuale	70

Pjesa 7: Viktimat e dhunës familjare	75
I. Dhuna ndaj femrave në shtëpi	76
II. Nevoja për mbrojtjen e të miturve si viktimat të dhunës familjare	80
Pjesa 8: Krimet e luftës dhe krimet etnikisht të motivuara: Paanshmëria e gjykatave,	85
I. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64	86
II. Rasti i Lulzim, Bajram dhe Agim Gashit	90
III. Gjykimet për krime të luftës dhe krime etnikisht të motivuara	93
IV. Padrejtësitë në të kaluarën: Statusi i Ankesës/Rishqyrtimit	100
Pjesa 9: Akuzat për gjenocid	105
I. Gjenocidi në kuadër të ligjit vendor	
II. Aktakuzat/Gjykimet	106
III. Trajnimi mbi Ligjin Humanitar Ndërkombëtar	112

PJESA 1: MONITORIMI

I. Mandati i Seksionit për Monitorim të Sistemit Juridik

Me *Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB*, Këshilli i Sigurimit i KB ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KB që në Kosovë të themelojë prezencën civile ndërkombëtare, e cila do të vendoste një administratë të përkohshme. Njëra prej përgjegjësive kryesore të prezencës ndërkombëtare ishte “mbrojtja dhe afirmimi i të drejtave të njeriut”. (Para. 11 (j)).

Sekretari i Përgjithshëm i KB në referimin e tij para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 Korrik 1999, rolin udhëheqës për ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut i'a ka caktuar OSBE-së dhe ka vënë në pah se njëra prej detyrave të Shtyllës së Ndërtimit të Institucioneve (Shtylla III) do të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 Korrik 1999, janë dhënë instrukcione UNMIK-ut për themelimin e mekanizmave bashkërendues në mënyrë që të lehtësohet monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimi i drejtë i sistemit gjyqësor duke shtuar këtu se raportimi duhet të zhvillohet në mënyrë të bashkërenditur në mënyrë që të lehtësohet zotësia e veprimit. E në veçanti:

“UNMIK-u do të ketë një trup monitoruesish dhe këshilltarësh për të drejtat e njeriut dhe të cilët do të kenë *qasje të papenguar* në të gjitha pjesët e Kosovës për të hetuar cenimet e të drejtave të njeriut dhe do të sigurojnë që shqetësimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut të jenë të shfaqura nëpërmjet të aktivitetit të gjithmbarshëm të misionit. Monitoruesit e të drejtave të njeriut lidhur me informatat e mbledhura i raportojnë Përfaqësuesit Special përmes Zëvendësit të tij të ngarkuar për Ndërtimin e Institucioneve. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit e të drejtave të njeriut do të publikohen në baza të rregullta dhe do të shkëmbehen sipas nevojës edhe me mekanizmat për të drejtat e njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, e në konsultim me Zyren e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. UNMIK-u do të mundësoj raportimin bashkërendues dhe zotësinë për të vepruar”. (Para. 87).

Në dokumentin e marrëveshjes në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Operacione Paqëruajtëse dhe Kryesuesit të Radhës të Zyres së OSBE-së, vendoset që Shtylla III, OSBE-ja do të zhvilloj mekanizma për të garantuar se gjyqet, tribunalet administrative dhe strukturat tjetra gjyqësore të veprojnë në harmoni me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut. Për më shumë, duke u thirrur në *Rregulloren 2000/15* të datës 21 Mars 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë, është marrë konfirmimi nga ana e Departamentit Administrativ të Drejtësisë që OSBE-ja të jetë organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues.

II. Raporti me Shtyllat tjera

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës pranë OSBE-së, si pjesë e Shtyllës për Ndërtimin e Institucioneve punon me një bashkëpunim të ngushtë me organizatat e KB siç janë OHCHR, UNHCR dhe UNICEF. Departamenti është njëri prej akterëve kyq në Ekipin e Përbashkët për Destinim të Posaçëm për Minoritetet, i themeluar nga UNHCR-ja dhe në Ekipin e Përbashkët për Destinim të Posaçëm për Legjislacionin për të Miturit, e icili udhëheqet nga UNICEF-i. Departamenti bashkëpunon gjithashtu edhe me organizatat tjera ndërkombëtare dhe të vendit siç janë Këshilli i Evropës, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (**orig. ICRC**) dhe Dhoma e Avokatëve Amerikanë-Iniciativa Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (**orig. ABA-CEELI**).

Përderisa Sektori i Sundimit të së Drejtës në kuadër të Departamentit, në mënyrë aktive mbështet Departamentin e Drejtësisë në zhvillimin e gjyqësisë, Sektori i të Drejtave të Njeriut ka një pozitë unike në raport me Shtyllën për Asistencë Humanitare (Shtylla I) dhe Administratën Civile (Shtylla II). Megjithëse pjesë e strukturës së UNMIK-ut, mandati i këtij sektori parasheh një rol kinse të pavarur të monitorimit dhe vëzhgimit të drejtave të njeriut në Kosovë, përfshirë këtu edhe sistemin gjyqësor i cili administrohet nga Shtylla II.

Si pjesë e Shtyllës III dhe pjesë e UNMIK-ut si tërësi, mandati i OSBE-së për monitorimin të sistemit gjyqësor përfshinë raportimin real dhe të menjëhershëm në kuadër të UNMIK-ut mbi:

- i. statistikat aktuale mbi sistemin e drejtësisë penale,
- ii. shkeljet sistematike të së drejtës ndërkombëtare, dhe
- iii. shkeljet e rënda të standardeve mbi gjykimin objektiv në rastet individuale të cilat duhet menjëherë të menjanohen (shërohen).

SMSJ, si pjesë e Sektorit të Drejtave të Njeriut, mban raporte konsistente dhe bashkëpunuese me Shtyllat tjera dhe me agjencitë tjera ndërkombëtare. Këtij Sektori i drejtohen DD KB dhe Zyra e PSSP-së me kërkesa për informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me gjendjen e sistemit të drejtësisë penale, siç janë gjendja e lëndëve në procedurë e sipër, të miturit e paraburgosur, dhe personave ndaj të cilëve është ngritur aktakuza. Shkeljet sistematike, trendi aktual, problemet individuale dhe çështjet të cilat identifikohen nga ana e SMSJ-së, u janë komunikuar departamenteve tjera dhe si dhe agjencive në kuadër të UNMIK-ut. Shumica prej këtyre departamenteve dhe agjencive janë të ngarkuara me përgjegjësinë për gjetjen e mjeteve dhe zgjidhjeve konkrete për problemet kyqe (p.sh. nevojat për përkrahjen materiale të gjyqësisë, çështjet e sigurisë, keqpërdorimet në gjyqësi dhe stërvitjen *inter alia* të profesionistëve ligjor).

III. E drejta në gjykim objektiv (të drejtë)

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pjesë e legjislacionit pozitiv në bazë të *inter alia Rregullores 1999/24*, e cila obligon bartësit e funksioneve publike në Kosovë që ti përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut. Krahas kësaj, Republika Federative e Jugosllavisë është palë e një numri të instrumenteve për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe *Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)*, i cili për ndryshe obligon secilin organizëm qeveritar në këtë territor që ti garantojë popullit të Kosovës këto të drejta.

SMSJ, analizon ligjin dhe praktikën vendore lidhur me pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe objektivitetin në procedurën penale. Standardet ndërkombëtare janë të precizuara, *inter alia* në nenet 9,10,14 të PNDCP dhe nenet 5,6 të *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)* dhe standardeve tjera të KB që nuk përfshihen në Pakte. Ligji vendor – kryesisht *Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së (LPP)* dhe *Ligji Penal i Kosovës (LPK)*, në bazë të analizës së SMSJ-së. Analiza e “Gjykimit objektiv” në bazë të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut fillon prej momentit kur individit arrestohet nga ana e autoriteteve, deri në shtjellimin përfundimtar të rastit.

SMSJ, monitoron rastet të cilat përshkojnë tërë sistemin penal të drejtësisë, prej momentit të arrestimit dhe/apo paraburgosjes(paraburgimit) deri te gjykimi (seanca kryesore) dhe ankesa. SMSJ, monitoron rastet që kanë të bëjnë me vepra të rënda penale, shumica prej të cilave janë të parapara nga SMSJ, si raste prioritare dhe që bijnë në kompetencën e gjykatave të qarkut. Disa raste në gjykatat komunale apo ato kundërvajtëse mund të monitorohen nëse përfshijnë çështje prioritare siç janë rastet ku përfshihen minoritetet, të miturit dhe gratë.

Para pjesëmarrjes në procedurën formale të gjykimit, dhe aty kur kjo është praktike, monitoruesit e SMSJ-së, hetojnë rastin në mënyrë që të sigurohen se ka pasur mundësi të parashtrihen dhe të trajtohen të gjitha çështjet lidhur me të drejtat para fillimit të gjykimit. Hetimi në fjalë krijon bazën për monitoruesit e SMSJ-së, për analizën e procedurës gjyqësore. Monitoruesit e SMSJ-së, mbledhin të dhëna duke shqyrtuar lëndën, nëse ka qasje; dhe, bëjnë intervistimin e të dyshuarve/të burgosurve, policisë/KFOR-it, avokatëve mbrojtës, prokurorëve publik, gjykatësve hetues dhe të tjerëve. Monitoruesit e SMSJ-së, marrin pjesë në gjykime dhe raportojnë mbi praktikën e përdorur në procedurën para-penale dhe atë penale dhe në pikpamje të standardeve ndërkombëtare dhe vendore.

IV. Rastet prioritare

Megjithëse prioritetet për këto 12 muaj të kaluar kanë mbetur të njëjta, SMSJ, ka thelluar vëmendjen në këto prioritetet të njëjta. Çështjet që kanë të bëjnë me qasjen, efektivitetin e mbrojtjes e gjithashtu edhe keqpërdorimet nga ana e organeve të prokurorisë dhe gjyqësisë janë të mbuluara në kontekst të monitorimit të rastit. Ky është një proces i cili është në ecje e sipër meqenëse SMSJ, i përgjigjet çështjeve të cilat dalin në dritë karhas zhvillimit të sistemit juridik:

- i. Krimet e luftës
- ii. Krimet e motivuara etnikisht
- iii. Krimet e motivuara politikisht
- iv. Trajtimi i të miturve
- v. Viktimat e dhunës seksuale përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës familjare dhe të trafikimit të femrave.
- vi. Trajtimi i personave të sëmurë mentalisht
- vii. Burgosja (paraburgimi, ndalimi, mbajtja në burg)

SMSJ, monitoron burgjet pasi që kanë të bëjnë me çështjet e “qasjes në drejtësi”. SMSJ, nuk monitoron burgjet për çështjet e kushteve nëpër burgje apo të keqtrajtimit nëpër burgje meqenëse këto çështje janë të mbuluara nga zyrtarët e OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe *KNKK*-së.

TË DHËNAT NGA GJYKATAT E QARKUT (1 SHTATOR 2000 – SHKURT 2001)

	Gjykime të mbajtura	Të monitoruara	Të fajshëm	Të pafajshëm	Aktakuz- a të hudhura	Përkatësia etnike
Prishtinë 64 të pandehur	49	24	46	10	8	Të pandehur: Të gjithë SH/K tjerët 3 S/K Viktima: Të gjithë SH/K tjerët 3 S/K
Gjilan 47 të pandehur	36	7	30	13	4	Të pandehur: 33 SH/K, 3 S/K, 1 R/K Viktima: të gjithë SH/K tjerët 5 Min./K
Prizren 34 të pandehur*	17	11	25	9	1	Të pandehur: Të gjithë SH/K tjerët 1 S/K, 2 Min./K Viktima: të gjithë SH/K tjerët 2 Min./K
Pejë 66 të pandehur*	36	9	51	29	asnjë	Të pandehur: 62 SH/K, 1 S/K, 2 Shtetas të Shqipërisë Viktima: të gjithë SH/K
Mitrovicë 32 të pandehur*	21	11	31	2	asnjë	Të pandehur: 27 SH/K, 5 S/K Viktima: të gjithë SH/K, tjerët 5 S/K, ndërkombëtarë

*përfshinë të pandehurit të paditur për më shumë se një vepër penale.

PR: Vrasje: 15 dënime, 2 lirime; **Tentim vrasje:** 2 dënime, 1 lirim; **Dhunim seksual:** 8 dënime, 3 lirime, 2 aktakuza të hudhura; **Tentim dhunimi seksual:** 1 dënim, 2 lirime; **Plaçkitje e armatosur:** 4 dënime; **Tentim plaçkitje e armatosur:** 3 dënime; **Narkotikë:** 1 dënim, 4 aktakuza të hudhura; **Rrezikim i përgjithshëm:** 1 dënim; **Armë:** 9 dënime, 1 lirim, 2 aktakuza të hudhura; **Plaçkitje:** 1 lirim; **Falsifikim:** 1 dënim; **Lëndime të rënda trupore:** 1 dënim.

GN: Krime të luftës: 1 dënim; **Vrasje:** 9 dënime, 5 lirime; **Dhunim seksual:** 1 lirim; **Narkotikë:** 12 dënime, 3 lirime; **Armë:** 8 dënime, 4 aktakuza të hudhura; **Shkaktim të rrezikut:** 1 lirim; **Shtrengim:** 2 lirime; **Vjedhje:** 1 lirim.

PZ: Vrasje: 5 dënime, 3 lirime; **Tentim vrasje:** 2 dënime, 1 lirim; **Tentim vjedhjeje të rëndë:** 2 dënime; **Dhunim seksual:** 1 aktakuzë e hudhur; **Armë:** 6 dënime; **Rrezikim i sigurisë:** 1 dënim; **Falsifikim i dokumentit:** 1 dënim; **Lëndime të lehta trupore:** 1 dënim; **Rrezikim i përgjithshëm:** 1 lirim; **Ndihmë gjatë plaçkitjes së armatosur:** 6 dënime, 4 lirime; **Mshefje:** 1 dënim.

PE: Vrasje: 3 dënime, 1 lirim; **Tentim vrasje:** 2 dënime; **Vepra të jonatyrshme seksuale:** 1 dënim; **Dhunim seksual:** 1 lirim; **Tentim dhunimi:** 1 lirim; **Plaçkitje e armatosur:** 5 dënime, 2 lirime; **Tentim plaçkitje të armatosur:** 2 dënime; **Vjedhje e rëndë:** 1 dënim, 3 lirime; **Lëndime të rënda trupore:** 1 dënim; **Lëndime të lehta trupore:** 4 dënime; **Vjedhje:** 1 dënim; **Falsifikim:** 2 dënime; **Armë:** 25 dënime, 21 lirime; **Ndërmjetësimi në prostitucion:** 1 dënim; **Tentim rrëmbimi:** 1 dënim; **Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare:** 1 dënim.

MI: Gjenocid: 1 dënim; **Krime të luftës:** 1 dënim; **Vrasje:** 4 dënime; **Bashkëpjesmarrje në vrasje:** 1 dënim, 1 lirim; **Tentim vrasje:** 3 dënime; **Dhunim seksual:** 7 dënime; **Rrëmbim:** 1 dënim; **Bashkëpjesmarrje në rrëmbim:** 2 dënime; **Marrëdhënje seksuale me personin nën 14 vjet:** 1 dënim; **Sulm kundër personit zyrtar:** 2 dënime; **Armë:** 3 dënime, 1 lirim; **Narkotikë:** 1 dënim; **Plaçkitje e armatosur:** 1 dënim; **Ndërmjetësim në prostitucion:** 3 dënime.

A. Mesatarja e gjatësisë së dënimit të shqiptuar:

- i. Vrasje:**
PR: 7 vjet 3 muaj; **GN:** 9 vjet e 8 muaj; **PZ:** 11 vjet e 8 muaj; **PE:** 9 vjet; **MI:** 7 vjet e 6 muaj.
- ii. Dhunim seksual:**
PR: 4 vjet; **MI:** 1 vjet e 3 muaj.
- iii. Plaçkitje e armatosur:**
PR: 1 vjet; **PE:** 3 vjet e 6 muaj.
- iv. Mbajtje e armëve: ***
PR: 9 muaj; **PZ:** 5 muaj; **GN:** 12 muaj; **PE:** 12 muaj

*Shumica e të pandehurve të përkatësisë Shqipëtare kanë marrë dënime me kusht.

B. Gjykata Supreme e Kosovës.

Ankesa të parashtruara

32 Ankesa të parashtruara

16 aktgjykime të shkallës së parë të kthyera për rigjykim:

4 aktgjykime të rikthyera në bazë të ankesës së prokurorit publik

13 aktgjykime të rikthyera në bazë të ankesës së mbrojtësit

(një ankesë është parashtruar nga të dyja palët)

11 aktgjykime të shkallës së parë të vërtetuara

3 aktgjykime të shkallës së parë të ndryshuara:

3 ankesa të parashtruara nga mbrojtësi janë aprovuar e që kanë rezultuar në shqiptimin e dënimit apo në ndryshimin e sanksionit (duke vendosur për kohëzgjatjen e dënimit si dhe kualifikimit ligjor të veprës).

1 ankesë e prokurorit publik është tërhequr si e “palejueshme apo e përfunduar”.

1 ankesë e mbrojtësit është rikthyer në shkallë të parë për tu përsëritur.

C. Statistikat tjera

- i. Për këtë raport SMSJ ka intervistuar 118 të pandehur;
- ii. SMSJ ka monitoruar 62 prej 159 gjykimeve të përfunduara në Gjykatat e Qarkut (38%);
- iii. 159 gjykime kanë përfshirë 242 të pandehur;
- iv. 183 të pandehur janë dënuar (75% shkalla e dënimit)
- v. 63 të pandehur janë liruar;
- vi. 13 aktakuza janë hudhur;

- vii. Minoritetet: **të pandehur**: 13 Serb të Kosovës, 1 Rom i Kosovës, 2 Musliman të Kosovës (të gjithë të dënuar përveç dy S/K). **Viktima**: 13 Serb të Kosovës, 2 Musliman të Kosovës, 2 Ndërkombëtarë.

PJESA 2: LIGJI I ZBATUESHËM

I. Zhvillimet e rëndësishme në ligjin e zbatueshëm

Gjashtëmujori i mbuluar me këtë raport ka shënuar disa zhvillime të rëndësishme në ligjin e zbatueshëm, ku disa prej të cilave janë parashtruar, në vijim:

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, mbi emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndërrimin e vendit të mbajtjes së gjykimit.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, parimisht mëton zhvillimin e një sistemi për ndarjen e lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë dhe mëton adresimin e nevojës për shumicën e trupit gjykues ndërkombëtar në zbutjen e shqetësimeve që kanë të bëjnë me animin (subjektivitetin) gjyqësor. Rregullorja parasheh që pala e autorizuar përfshirë këtu edhe mbrojtësin mund të parashtrorj kërkesë DD KB-së, që lënda ti ndahet prokurorit ndërkombëtar dhe trupit gjykues ku shumica do të jenë gjykatës ndërkombëtarë. Vendimi final mbi ndarjen e lëndës bëhet nga ana e PSSP-së, pas rekomandimeve të propozuara nga DD KB.

SMSJ, përshëndet rregulloren si një mjet efektiv të zbutjes së shqetësimeve lidhur me çështjet e animit në gjyqësi.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/62 Mbi përjashtimin e personave në afat të kufizuar për qëllim të sigurimit të qetësisë, sigurisë dhe rendit publik

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/62, është dekretuar me 30 Nëntor 2000. Kjo Rregullore jep pushtet organeve relevante të rendit publik që ato të lëshojnë urdhëresë për përjashtim në kohëzgjatje prej 30 ditësh kur ekzistojnë “dyshime të bazuara që ...një person është apo ka qenë i përfshirë në kryerjen, pregaditjen apo nisjen e veprimeve të dhunës të cilat mund të ndikojnë në qetësinë dhe rendin publik, brenda apo jashtë territorit të Kosovës”.

Rregullorja parasheh të drejtën për përfshirjen në ndaj të cilit është shqiptuar urdhëresa, që ai të nis rishqyrtimin kundërshtues para gjykatësit ndërkombëtar kundër urdhëresës (vendimit) për përjashtim. SMSJ, përshëndet prezentimin e rishqyrtimit gjyqësor në Rregullore dhe do të inkurajoj për një dispozitë të ngjashme në *Rregulloren e ndryshuar 2000/26*.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1, Mbi ndalimin me ligj të gjykimeve në mungesë për shkeljet e rënda të Ligjit ndërkombëtar humanitar.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/1, ofron mbrojtjen kundër gjykimeve në mungesë (*in absentia*) të cilat tejkalojnë shumë kompetenca (jurisdikcione). Kjo Rregullore përshëndetet gjithashtu për shkak se ajo do të sigurojë ndarjen e mjeteve vështirë të arritshme për lëndët në procedurë e sipër, me ç'rast të pandehurit gjenden në burg.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/2, Mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6, Mbi emërimin dhe shkarkimin nga funksioni të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar.

E dekretuar me 12 Janar 2001, *Rregullorja e UNMIK-ut 2001/2*, zgjeron llojin e rasteve në të cilat prokurorët publik mund të ndërhyjnë. Duke shfrytëzuar dispozitat e LPP të RFJ, mbi të drejtën në ngritjen e padisë private, kjo Rregullore lejon prokurorët ndërkombëtarë të vazhdojnë procedurën në rastet kur prokurori publik tërhiqet nga ndjekja penale apo nëse vendosë se nuk ka bazë për ndjekje penale. Zgjerimi i kompetencave në këtë mënyrë është i mirëseardhur, e posaçërisht për faktin se mundëson një masë mbrojtëse shtesë kundër lëndëve të cilat hudhen si rezultat i animit gjyqësor (subjektivitetit). Sa i përket lëndëve në të cilat prokurori është tërhequr para hyrjes në fuqi të Rregullores, prokurori publik mund të fillojë përsëri shqyrtimin e lëndës konform Rregullores, vetëm brenda afatit prej 30 ditësh prej hyrjes në fuqi të Rregullores.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 inkriminon aktivitetin apo organizimin e trafikimit me njerëz, e që bartë sanksionin e mundshëm prej dy deri në dymbëdhjetë vite burgim. Nëse viktimat janë të moshës më të re se tetëmbëdhjetë vjet, ekziston dënimi i rëndë maksimal prej pesëmbëdhjetë vitesh burgim. Personat të cilët me vetëdije shfrytëzojnë shërbimet seksuale prej viktimës së trafikimit, gjithashtu hasin në dënim me burg në kohëzgjatje deri në pesëmbëdhjetë vite.

Rregullorja shkon më tutje në krijimin e dispozitave të posaçme që kanë të bëjnë me hetimet dhe konfiskimin e pasurisë apo mbylljen e bizneseve të cilat lidhen me trafikimin. Është bërë edhe ndalimi i pranueshmërisë së dëshmive të karakterit të keq paraprak apo autobiografisë personale të viktimës së supozuar. Dëshmia e tillë megjithatë mund të jetë e pranueshme pas procedurës relevante provuese të dëgjimit *in camera* (duke përjashtuar publikun dhe të pandehuri) të palës.

Për t'u marrë me këto raste kur viktimat e trafikimit janë deportuar, Rregullorja në mënyrë eksplicite thekson se atëherë kur i pandehuri është viktimë e trafikimit, dënimet për prostitucion apo për hyrje të palejueshme, nuk do të paraqesin bazë për deportim.

II. Ritheksimet nga raporti i kaluar

Njëri prej problemeve qëndrore në raport me ligjin e zbatueshëm që është identifikuar në Raportin e parë të SMSJ-së, ka qenë mungesa e qartësisë mbi atë se, cilat ligje duhet zbatuar dhe si duhet zbatuar ato.

Si rrjedhojë e kundërthënjeve në rritje lidhur epërsinë e ligjeve për të drejtat e njeriut, SMSJ, i ka rekomanduar Përfaqësuesit Special që të vëjë në qarkullim instrukcione të shkruara që do të kenë për pasojë që ligjet për të drejtat e njeriut do të kenë epërsi ndaj të gjitha ligjeve tjera, dhe që gjykatësit dhe prokurorët nuk do të zbatojnë dispozitat e ligjeve vendore që janë në kundërshtim me këto ligje dhe që për plotësimin e

zbratësirave ligjore në legjislacionin vendor do të mund të thirreshim në ligjet për të drejtat e njeriut. Pas publikimit, ky rekomandim është përkrahur nga DD KB, dhe nga gjyqësia vendore dhe ndërkombëtare. Deri në kohën e përpilimit të këtij raporti akoma nuk është bërë asnjë sqarim lidhur me këtë çështje.

Nevoja për një sqarim zyrtar lidhur me zbatimin e ligjit në fakt nuk është parashtruar që në fillim kur janë dekretuar ligjet e reja apo kur janë ndryshuar ligjet ekzistuese. Rregulloret në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpeshtë vetëm se shkaktojnë huti në legjislacionin pozitiv, ose përmes mangësisë së ndërlidhshmërisë së tekstit të shkruar dhe përmbajtjes apo për shkak të faktit se disa Rregullore vetvetiu paraqesin shkelje të dispozitave për të drejtat e njeriut.

Këto probleme së paku pjesërisht, paraqesin simptome të procesit legjislativ. Ecuria e konsultimeve dhe hartimeve të ligjeve të reja shpeshherë vazhdon të zhvillohet në mënyrën *ad hoc*. Posaçërisht, për ligjet e reja nuk është parashtruar ndonjë kërkesë që ato të përmbajnë sqarime lidhur me objektin dhe qëllimin e tyre, apo udhëzimin për zbatimin e tyre. Gjyqësia vendore dhe grupet tjera kryesore të komunitetit ligjor, shpeshherë nuk janë konsultuar për miratimin e ligjeve të reja e as që ka ndonjë proces efektiv të përhapjes publike të informacioneve. Draftet e ligjeve të reja nuk marrin në mënyrë sistematike rishqyrtime mbi pajtueshmërinë e këtyre drafteve me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga ana e ekspertëve për të drejtat e njeriut apo komponentat e të drejtave të njeriut të UNMIK-ut.¹

Në kontekst të sistemit të drejtësisë Kosovare, ku akterët ndërkombëtarë janë të involvuar në sistemin vendor të gjyqësisë, është jetike që ligjet të përkthehen sa më shpejtë. Pas miratimit, megjithatë ligjet nuk përkthehen menjëherë dhe nuk ka qasje ndaj tyre gjë që pengon implementimin e tyre. Sipas të dhënave që disponon SMSJ, deri në momentin e përpilimit të këtij raporti, asnjë prej Rregulloreve të UNMIK-ut të miratuara në vitin 2001 nuk janë përkthyer zyrtarisht në gjuhën Shqipe dhe/apo Serbe. Për më shumë, ka pasur shqetësime lidhur me cilësinë e përkthimeve zyrtare të Rregulloreve, duke theksuar nevojën për përkthyes të kualifikuar me kërkesë të njohurisë së terminologjisë juridike.

Për dallim nga qasja e hartimit të rregulloreve, Komisioni i Përbashkët Konsultativ (KPK – orig.JAC) inkuadron një proces konsultativ dhe bashkëpunues në mes të juristëve ndërkombëtarë (KB, OSBE dhe Këshilli i Evropës) dhe juristëve vendor për një reformë ligjore afatgjate. KPK, është përfshirë në një rishiqim dhe revidim të gjërë të procedurës penale dhe ligjeve penale. Ligji penal i modernizuar dhe i reviduar është në përfundim e sipër. KPK, rishtazi ka mbajtur një konferencë në të cilën njëra prej çështjeve të diskutuara ishte mënyra e rritjes së pjesëmarrjes në procesin e reformës ligjore.

KPK-ja megjithatë nuk është konsultuar në mënyrë sistematike lidhur me projekt rregulloret. Zyra e Këshilltarit Juridik të PSSP-së, nuk është e kushtëzuar që të konsultoj KPK-në, e gjithashtu asnjë aspekt tjetër të misionit gjatë hartimit të këtyre ligjeve. Është deklaruar që rregulloret e një karakteri më shumë “intervencionist” shpeshherë nuk do t’i

¹ P.sh. Njësia për të drejtat e njeriut dhe për çështje të komunitetit, pranë PSSP-së, nuk i rishiqojnë në mënyrë sistematike ligjet e reja.

nënshtrohen rishiqimit të KPK-së, pasi që përmbajtja e tyre si rregull, do të jetë më shumë e natyrës politike se asaj juridike. Megjithatë, ekzistojnë shumë shembuj të rregulloreve të “reformës ligjore” të cilat nuk u janë dorëzuar KPK-së, për rishiqim.

Mungesa e vazhdueshme e *Habeas Corpus*

Mungesa e ndonjë mekanizmi efektiv me të cilin do të sfidohej ligjshmëria e urdhëresave (vendimeve) për burgosje (paraburgim), shpeshherë të referuara në një mekanizëm *habeas corpus*, vazhdon të paraqes dështim elementar por kritik në zbatimin e ligjit. Një dispozitë eksplicite është bërë për një mekanizëm të tillë në nenin 5 (4) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 9 (4) të Paktit Nërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, me një pako arsyesh që sigurojnë të drejtën për të burgosurit që të kontestojnë ligjshmërinë e burgosjes (paraburgimit) të tyre dhe të drejtën e rishqyrtimit të bazës së mbajtjes së tyre në burg kur rrethanat kanë pësuar ndryshime të dukshme. Të gjitha rdhëresat për burgosje (vendimet për caktimin e paraburgimit), përfshirë këtu edhe urdhëresat ekzekutive dhe “ndalimet (*mbajtjet*)” e “COMKFOR”-it, duhet ti nënshtrohen një rishqyrtimi të tillë. Kolegjet gjyqësore të parapara me *Rregulloren 64*, së bashku me shumicën prezente të gjyqësisë ndërkombëtare, pakësojnë së paku në masë të caktuar shqetësimet lidhur me animin (subjektivitetin) gjyqësor.

Përkundër natyrës fundamentale të procedurës së tillë, ligji i zbatueshëm ende nuk përmbanë ndonjë mekanizëm të rishqyrtimit *habeas corpus* dhe të burgosurit nuk kanë mundësi të iniciojnë brenda afatit të duhur shqyrtimin e nevojës apo ligjshmërisë së burgosjes (paraburgimit) të tyre të vazhduar. Problemi i mugesës së procedurës *habeas corpus* gjithashtu edhe me *Rregulloren 1999/26*, është anashkaluar. Raporti i SMSJ, Nr. 6, *Zgjatja e paraburgimit dhe të drejtat e të burgosurve: Kundërligjshmëria e Rregullores 1999/26* e datës 29 prill 2000, ka vënë në pah se *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/26* shkelë ligjin mbi të drejtat e njeriut në atë se ka dështuar në dhënjen e mundësisë për rishqyrtimin e urdhëresave për burgosje (vendimeve për caktimin e paraburgimit). Kjo çështje është ritheksuar në raportin e parë të SMSJ. Përkundër kalimit të gati dymbëdhjetë muajve pas raportit të parë, *Rregullorja 1999/26* nuk është ndryshuar.

Mungesa e vazhdueshme e qasjes efektive në mbrojtës.

Dispozitat e papajtueshme të ligjit vendor dhe dështimi në zbatimin e ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë luajtur një rol të theksuar në reduktimin e pranisë dhe efikasitetit të mbrojtjes. Mbrojtësi i emëruar nga gjykata vazhdon të caktohet në procedurën para gjykatësit hetues gjatë dëgjimit të parë hetues, e që të pandehurit në mungesë të përfaqësuesit të tyre ligjor, kanë qenë paraprakisht të marrur në pyetje nga organet e rendit publik. Të dhënat e mbledhura gjatë kësaj interviste krijojnë bazën për të vendosur nëse duhet burgosur të dyshuarin, të nisen hetimet dhe për zbulimin e dëshmimeve të tjera që do të përdoren në procedurën hetimore. Krahas kësaj, pamarrë parasyshë dispozitat që kundërshtojnë këtë, rastet tregojnë se të dhënat në dosjet policore shpeshherë përdoren gjatë gjykimit.

Gjykatësit vazhdojnë të zbatojnë dispozitat e LPP të RFJ-së të cilat çenojnë ligjet mbi të drejtat e njeriut dhe të cilat kanë ndikim të dëmshëm për mundësitë e të pandehurit në pregaditjen e mbrojtjes së tij. Neni 74 i LPP të RFJ-së, lejon gjykatësin hetues të monitoroj dhe të kufizojë komunikimin e të pandehurit me avokatin e tij. Përkundër faktit se SMSJ, e ka potencuar këtë dispozitë në raportin e parë, neni 74 i LPP të RFJ vazhdon të zbatohet. Në anketimin e 41 personave të burgosur në Gjilan, 26 prej të cilëve u përgjigjën pyetjeve të parashtruara, 13 prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur mundësi të komunikojnë me avokatë në mënyrë *private* (kofidenciale). Shumica prej tyre kanë vënë në pah se rojet e burgut kanë qenë prezente gjatë bisedës së tyre. Në Prishtinë 10 prej 28 të burgosurve kanë deklaruar se nuk kanë pasur komunikime *private* (kofidenciale). Në Mitrovicë, para ngritjes së aktakuzës, të gjitha komunikimet monitorohen nga gjykata. Janë vendosur gjithashtu edhe kufizime kohore për vizitat e avokatëve, shpeshherë duke kufizuar bisedat deri në 5-10 minuta. Në Pejë dhe Mitrovicë, për të gjitha vizitat, nevojitet autorizimi gjyqësor.

Me 28 Shtator 2000, DD KB, ka lëshuar një Qarkore të Drejtësisë/2000/17 *Mbi zgjerimin e kushteve për mbrojtësin e ermëruar nga gjykata*. Në qarkore qëndron se, nëse personi që akuzohet për veprë penale për të cilën është paraparë denimi prej gjashtë muaj apo më shumë, personi do të ketë të drejtën në mbrojtës që nga marrja e parë në pyetje. Për veprat penale për të cilat është paraparë denimi deri në gjashtë muaj apo më pak, i pandehur ka të drejtë në mbrojtës kur interesi i drejtësisë ashtu kërkon. Qarkorja nuk shkon më tepër në detaje për të rregulluar çështjen e qasjes në mbrojtës para seancës së parë të dëgjimit, përfshirë këtu edhe intervistimet policore.

Çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në mbrojtje efektive nuk janë risi dhe në fakt ato kanë qenë të theksuara në raportet nr. 7 dhe 8 të SMSJ-së, *Mbi qasjen efektive në mbrojtës*, të datës 23 Maj 2000 dhe 20 Korrik 2000.¹ Në adresimin e çështjeve të ndryshme të identifikuara në raporte, progresi megjithatë ka qenë jashtëzakonisht i ulët. Në Gusht të vitit 2000, është krijuar grupi punues mbi “*qasjen*” dhe i cili është i përfaqësuar nga OSBE-ja, PSSP, Administrimi Penal në kuadër të KB, UNICEF, OHCHR dhe DD KB. Në Tetor 2000, grupit punues i është prezentuar një pako e propozim ligjeve, duke adresuar çështjet elementare që kanë të bëjnë me qasjen efektive në mbrojtës në rastet e arrestimit dhe burgosjes (paraburgimit), komunikimin privat (kofidencial) dhe mundësinë e shiqimit të dokumentacionit relevant gjyqësor. Si rezultat i diskutimeve në kuadër të grupit punues, me 1 Dhjetor 2000, propozimi final ka qenë i gatshëm. Kjo pako e propozim ligjeve nuk është implementuar, dhe si duket një proces i ri dhe i mëtutjeshëm i rihartimit të propozimeve është ndërmarrë nga DD KB. Propozimi i ri mëton reduktimin e të drejtave të ofruara të pandehurit, përfshirë këtu edhe kufizimet kohore për komunikimin privat (kofidencial) dhe reduktimin e rolit të mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje. Për SMSJ-në, kjo nënkuptohet se hartimi i mëtejshëm mbetet në kuadër të Zyrës së Këshilltarit Ligjor.

¹Raporti 6 i SMSJ, *Qasja efektive në mbrojtës: Arrestimi deri në dëgjimin e parë në procedurën hetimore* (23 maj 2000)

Raporti 8 i SMSJ, *Qasja efektive në mbrojtës: Procedura hetimore deri në ngritjen e aktakuzës* (20 korrik 2000).

III. Grupi punues për implementimin e Raportit të parë të SMSJ-së për drejtësinë penale

Si përgjigje ndaj raportit të parë të SMSJ-së për sistemin gjyqësor, OSBE dhe DD KB kanë formuar grupin punues që të studjoj rekomandimet dhe të propozoj veprime të duhura për autoritetet relevante atëherë kur shfaqet nevoja. Përderisa grupi punues vetvetiu nuk është përgjegjës për reforma legjislative dhe reforma tjera ligjore, niasiativa është përkrahur fuqimisht, posaçërisht duke u bazuar në faktin se organet dhe akterët kyq për implementimin e kësaj niasiatve janë kyqur në procesin e konsultimeve.

Që nga Shkurti 2001, grupi i përbashkët në punën e tij ka shqyrtuar në mes tjerash edhe:

- Revidimet e propozuara për dispozitat e LPP të RFJ, që nuk janë në harmoni me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Momentalisht është përpiluar një “doracak” që i referohet ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare.
- Është propozuar një Udhëzim/Sqarim Administrativ mbi epërsinë e ligjeve për të drejtat e njeriut. Ky propozim ende nuk është bërë publik dhe grupi punues momentalisht është duke diskutuar qasjet e ndryshme se si të prezentohen konceptet.
- Një *pilot* projekt është inicuar në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit për përpilimin e *verbatim* (fjalë për fjalë) procesverbaleve në procedurë. Projekti ka të bëjë vetëm me rastet të shqyrtuara nga gjykatësit ndërkombëtarë dhe përfshinë inqizimin simultan në kompjuter të dëshmisë së dhënë. Nuk ka ndonjë plan për zgjerimin e këtij projekti në regjionet tjera.
- Janë përpiluar propozim instrukcionet për ligjshmërinë e burgosjes (paraburgimit), të destinuara për Drejtorët e Burgjeve. Si plotësim i kësaj, Administrimi Penal i KB gjithashtu ka propozuar një propozim të procedurave për t’u siguruar që personat nuk do të burgosen në mënyrë kundërligjore.
- DD KB, ka përpiluar një Qarkore të Drejtësisë/2000/27, të datës 19 Dhjetor 2000, me të cilën përkujtohen gjykatësit se të gjitha vendimet mbi burgosjet (paraburgimet) duhet të bëhen me vendime të shkruara dhe duhet të jenë të arsyetuara plotësisht.

Zhvillimet tjera:

- Janë ndërmarrë hapa në krijimin e “Qendrës Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike”, si rezultat i diskutimeve që janë bërë me akterët relevant ndërkombëtarë dhe vendor e posaçërisht me Dhomën a Avokatëve të Kosovës. Qendra ka për qëllim të veproj si një trup stërvitës dhe i resurseve, me zotësinë që kur kërkohet nga kjo, të ofrojë ndihmë të drejtpërdrejtë për rastet.
- Propozim rregullorja mbi ndalimin me ligj të dhunës familjare i është prezentuar KPK-së. Propozim rregullorja mëton të sigurojë ndjekjen penale dhe një qasje multi-institucionale për çështjet e dhunës familjare. KPK, momentalisht është duke shqyrtuar metodat se si të zhvillojë çështjet e shtruara.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar në Nëntor të vitit 2000, kurse për gjykatësit dhe prokurorët e rinjë. Këto seminare kanë përfshirë si referencë nenet 5 dhe 6 të *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Në mars të vitit 2001 janë

planifikuar stërvitje plotësuese mbi LPP të FRJ, për gjykatësit vendor dhe ata ndërkombëtarë.

- Një propozim rregullore gjithashtu është përpiluar për krijimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili do të zëvendësoj Komisionin e Përbashkët Konsultativ. Pritet që të hyjë në fuqi në Prill të vitit 2001, me përbërje të shumicës ndërkombëtare.
- Një grup punues momentalisht është duke reviduar ligjin vendor lidhur me burgosjen e personave të sëmurë mentalisht. Grupi ka konsultuar ekspert të ndryshëm ndërkombëtarë të shëndetësisë dhe ekspert ligjor dhe propozon të përfshijë kartën e të drejtave të pacientëve në kuadër të propozim rregullores.
- Është formuar grupi punues për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

PJESA 3:Paraburgimi

Hyrje

Ndalimi i arrestimit dhe burgosjes arbitrare është pjesë fundamentale e legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ashtu siç është diskutuar në Pjesën e Ligjit të zbatueshëm, përkundër theksimeve substanciale të bëra në raportin e kaluar mbi çështjet e burgosjeve arbitrare, UNMIK-u ka ndërmarrë disa hapa për adresimin e gjërë të problemit. Mungesa e mekanizmit *habeas corpus* posaçërisht është brengosëse, sikundër që janë rastet të cilat përfshijnë burgosjen jashtë-gjyqësore dhe shkeljet e afateve ligjore të mbajtjes në paraburgim të cilat janë shtuar gjatë gjashtë muajve të kaluar. Krahas kësaj në disa raste të burgosurit vazhdojnë të nënshtrohen vonesave serioze në të shumtën për shkak të administrimit të gjykatave. Në rastet e tilla gjykatat duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për trajtimin e këtyre rasteve me nguti. Në rastet kur bëhet burgosja jashtë-gjyqësore nga ana e ekzekutivit apo nga ana e ushtrisë, kërkohet një nguti e posaçme në procedurë.

Burgosja e personave të sëmurë mentalisht mbetet çështje serioze meqenëse nuk ka ndonjë objekt të duhur për trajtimin dhe burgosjen e personave të tillë të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale. Mungesa e këtyre objekteve, ka lënë vetëm disa opsione për gjykatat dhe burgjet e rregullta. Nuk ka ekspertë të psikiatrisë të cilët vizitojnë objektet e burgjeve, por edhe nuk ekziston ndonjë mekanizëm i cili garanton atëherë kur kjo nevojitet komunikimin para gjykatës të diagnozës dhe gjendjes mendore të të burgosurit. Ligji sa i përket masave të sigurisë kërkon të reformohet kështu që personat e sëmurë mentalisht mos të jenë subjekt i burgosjes (paraburgimit) së pakufizuar.

Një numër i konsiderueshëm i të miturve është përfshirë në procedurë serioze penale. Të miturit vazhdojnë të privohen nga të drejtat e tyre gjersa gjinden nën arrest policor. Pa funksionimin e institucioneve sociale për mirëqenie dhe mbrojtje të fëmijëve, gjykatat si duket ngurrojnë në caktimin e një numri të caktuar të masave alternative karshi burgosjes (paraburgimit) e cila parashihet me ligj. Në rastet kur të miturit kanë nevojë për mbrojtje të caktuar apo largim nga ambienti shtëpiak, momentalisht nuk ka ndonjë institucion të caktuar për vendosjen e tyre, përpos qendrave të burgosjes(paraburgimit) dhe “institucionit të masës edukues”. Përpjekjet për t’u siguruar se të miturit trajtohen në vijë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ato që kanë të bëjnë me drejtësinë për të miturit, dhe që preventiva kundër delikvencës së të miturve të jetë efektive, momentalisht pengohen nga mungesa e funksionimit të mbrojtjes sociale dhe institucionit të mirëqenies për fëmijë.

I. Paraburgimi jashtë-gjyqësor

Pushteti ekzekutiv, PSSP, dhe prania ushtarake, KFOR-i, vazhdojnë paraburgosjen e personave jashtë procedurave gjyqësore. Rastet e burgosjes (paraburgimit) jashtë-gjyqësore të shtjelluara në këtë raport, përfshijnë shfrytëzimin e pushtetit ekzekutiv dhe ushtarak për burgosjen e personave të cilët janë liruar, nga pushteti gjyqësor. KEDNJ, dhe PNDKP, parashohin se askush nuk mund të privohet nga liria e tyre përveç në baza të cilat janë në pajtim me procedurat e caktuara me ligj. Për më shumë, secili person që

privohet nga liria e tij duhet të ketë të drejtën të sfidoj ligjshmërinë e privimit të tyre në një gjykatë të ligjit. Në rastet kur gjykata gjenë se personi është burgosur në mënyrë të kundërligjshme, ai person ka të drejtë në kompenzim të zbatueshëm. Në këto raste kërkesat e ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk kanë gjetur zbatim.

SMSJ, kupton atë që KFOR-i dhe Zyra e PSSP-së kanë shfaqur brengën se disa vendime liruese të gjyqësisë janë të padrejta dhe që rezultojnë nga animi gjyqësor. Me të vërtetë, ashtu si është raportuar paraprakisht nga SMSJ, ekziston një dëshmi e qartë dhe e fuqishme e animit në sistemin gjyqësor kundër Serbëve të Kosovës. Megjithatë, *Rregullorja 2000/64*, ka krijuar mekanizmin ligjor me të cilin këto raste mund të zgjidhen përmes shqyrtimit gjyqësor i cili përfshinë prokurorin publik ndërkombëtar dhe trupin gjykues të përbërë prej shumicës së ndërkombëtarëve. Nuk ka ndonjë arsytim të justifikueshëm pse ky mekanizëm nuk mund të shfrytëzohet për t'u siguruar se vendimet jashtë-gjyqësore përputhen me ligjet për të drejtat e njeriut.

Gjatë lëshimit të urdhëresave të ekzekutivit dhe të COMKFOR-it për burgosje, autoritetet nuk ofrojnë bazat (arsyet) për burgosje. Në disa raste, këto urdhëresa theksojnë se lirimi i personit mund të shkaktojë “kërcënim për rendin dhe qetësinë publike”, por dështojnë të artikulojnë arsyet për këtë konkludim apo të paraqesin dëshmi në bazë të së cilës kërcënimi në fjalë është vlerësuar. Në disa raste, personave që janë subjekt të urdhëresave të tilla nuk u jipet mundësia e marrjes së kopjeve të këtyre urdhëresave e as që bëhet regjistrimi i informatës ndokund për shiqim publik, sikundër që është rasti me vendimet gjyqësore. Njohuria për ekzistimin e urdhëresës së tillë dhe baza për të, janë të domosdoshme për të burgosurin që të ketë mundësi kundërshtimi.

Urdhëresat ekzekutive të burgosjes (paraburgimit)

SMSJ, është i vetëdijshëm se PSSP-ja, në rrethana të jashtëzakonshme, kur të gjitha rrugët tjera ligjore janë shterrur, mund të ushtrojë autoritetin ekzekutiv për të burgosur individët.

SMSJ, është informuar se procedura në lidhje me lëshimin e urdhëresës ekzekutive për burgosjen e personave është si e paraqitur në vijim:

Së pari, *pesha e rastit* duhet të jetë mjaft e fuqishme për urdhërimin e intervenimit ekzekutiv. Kjo kërkon informata apo dëshmi për mbështetjen e këtij vendimi nga ana e ekzekutivit për burgosjen e individit për veprim të caktuar penal.

Së dyti, ekzistojnë baza për të vlerësuar se lirimi i personit nga paraburgimi do të shkaktonte rrezik për sigurinë publike duke pasur parasyshë peshën e rëndë të krimit të pohuar.

Dhe e treta, ekziston baza për të besuar se intervenimi ekzekutiv është i domosdoshëm për të përmirësuar apo parandaluar *manipulimin* në ndjekjen penale të rastit nga ana e zyrtarëve të gjyqësisë dhe të tjerëve, e cila sjell deri te shpërdorimet gjyqësore, për shkak të animit gjyqësor, keqpërdorimit, apo problemeve të sigurisë.

Këto urdhëresa nuk parashikojnë më shumë se baza të përgjithshme për këtë vendim dhe kjo nuk është e mjaftueshme.

Shqetësimi legjitim është ai se nuk ka ndonjë mekanizëm për të dyshuarin apo avokatin e tij për të kundërshtuar bazat e urdhëresës ekzekutive. Në fakt, lëshimi i urdhëresës ekzekutive momentalisht është arbitrar, pasi që nuk ka ndonjë arsyetim apo ndonjë standard i cili do ta mbështeste. Çështje fundamentale e ligjit për të drejtat e njeriut është ajo se personi i privuar nga liria e tij, të ketë mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e burgosjes së tij. Rishqyrtimi gjyqësor i burgosjeve ekzekutive do të siguronte se ato nuk janë arbitrare.

Në rastin më të hershëm të tre të dyshuarve, urdhëresat ekzekutive të burgosjes janë lëshuar përkundër vendimit të kolegjit gjykues ndërkombëtar, në rastin i cili është ndjekur nga prokurori ndërkombëtar, se nuk ka baza të mjaftueshme për paraburgimin e këtyre personave. Në këto raste, nuk është e mundur të dihet se si është përmbushur kushti i tretë për ekzistimin e kërcënimit për manipulim gjyqësor të rastit.

Është e qartë se përdorimi i jashtëzakonshëm i urdhëresës ekzekutive për burgosje nuk do të duhej të përdoret për kohë të padefinuar apo për objektiva të padefinuara ligjore dhe të justifikueshme. Rasti në fjalë përfundimisht duhet të procedohet nga sistemi gjyqësor. Kjo ishte shqetësuese edhe për rastin e një të burgosuri i cili kishte qenë objekt i urdhëresës ekzekutive përkundër faktit se gjykata kompetente e qarkut, përfshirë edhe gjykatësin ndërkombëtar, dhe Gjykatën Supreme, përfshirë edhe gjykatësin ndërkombëtar, kishin konfirmuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për prokurorin publik ndërkombëtar për të rifilluar ndjekjen e rastit. *Rregullorja 2001/2* ishte shpallur së paku pjesërisht, për të ndryshuar ligjin e zbatueshëm që të lejoj rifillimin e ndjekjes kundër të burgosurit përkundër këtyre vendimeve.

Urdhëresa ekzekutive për paraburgim, gjersa një hetim i ligjshëm policor apo gjyqësor është në zhvillim e sipër, siguron paraqitjen e të dyshuarit në gjykim, nëse paditet, dhe nuk do të mund të kryej vepra tjera gjatë kësaj kohe. Megjithatë, përfundimisht gjykata e pavarur do të vendosë mbi fajësinë apo pafajësinë e personit të paraburgosur dhe do ta denoj atë apo do ta liroj sipas rregullit. P.sh. në një rast, urdhëresa e lëshuar ekzekutive, kishte anuluar vendimin e Gjykatës Supreme ku përfshihej edhe gjykatësi ndërkombëtar, për lirimin e personit.

Në dritë të faktit se natyra e jashtëzakonshme dhe ndërhyrëse e urdhëresave ekzekutive është e pranuar qartazi, duket se rastet e personave që janë objekt i urdhëresave të tilla, duhet të procedohen me një urgjencë të posaçme. Gjykatat dhe policia e inkuadruar në hetimin e këtyre rasteve duhet të kenë detyrë të qartë që ti trajtojnë këto raste me një prioritet të veçantë kështu që përdorimi i urdhëresës ekzekutive të bëhet për kohën sa ma të shkurtë për të vendosur këto raste në binarët e gjyqësisë. Kjo paraqet shqetësim për një rast kur kërkesa në bazë të *Rregullores 2001/2*, për ri-hapjen e hetimeve kishte qenë e suksesshme por bazat për paraburgim nuk kishin qenë të zgjidhura. Edhe pse personi kishte qenë i paraburgosur për 10 muaj të tërë, shumica e kohës së kaluar kishte qenë nën

masën e jashtëzakonshme të burgosjes ekzekutive dhe nuk ishte paditur nga prokurori ndërkombëtar.

Krahas kësaj, për shkak të natyrës së këtyre urdhëresave, përdorimi i tyre duhet të përcjellët për së afërmi dhe duhet të mbahet nën rishqyrtim të rregullt. Ky është një shqetësim si në rastin e një të burgosuri, me ç'rast urdhëresës ekzekutive i kishte skaduar afati me 12 Shkurt 2001 dhe nuk është lëshuar urdhëresë e re ekzekutive. Ky i burgosur nuk ishte liruar përkundër faktit se ai nuk ishte më objekt i urdhëresës ekzekutive për burgosje. Si rezultat i kësaj ky i burgosur ishte mbajtur 8 ditë pa asnjë bazë.

Krahas kësaj, me rastin e lëshimit të urdhëresës ekzekutive, të gjitha informatat relevante në lidhje me vendimin duhet të sigurohen për individin i cili është objekt i kësaj urdhërese dhe gjithashtu avokatëve mbrojtës të tyre. Kjo nënkupton vendimin. Kjo nuk ka ndodhur në shumicën e rasteve. Njohuria dhe posedimi i të gjitha informatave relevante të cilat i përbën urdhëresa, dhe bazat e arsyeshme për këtë urdhërim për rastet e veçanta janë esenciale për të burgosurin dhe mbrojtësin e tij, për mundësinë e tyre të kundërshtimit të urdhëresës.

Ndaljet (mbajtjet) e COMKFOR-it

Në raportin e kaluar, SMSJ ka deklaruar se praktika e KFOR-it për burgosjen e personave, përkundër vendimit të ligjshëm gjyqësor për lirimin e personit, paraqet shkelje të qartë të ndalimit të burgosjes arbitrare. Njëherë pasi që KFOR-i, vendosë personat në kuadër të sistemit civil të drejtësisë penale, nga ata kërkohet të zbatojnë vendimet e gjyqësisë të arritura në pajtim me procedurën e paraparë me ligj. *Rezoluta e KB 1244* nuk i jep KFOR-it pushtetin për shkeljen e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në fakt, si një forcë ushtarake nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara, ajo forcë është e obliguar të përkrah standardet e KB.

Shfrytëzimi i *ndaljes (mbajtjes)* së COMKFOR-it, vazhdon, sidoqoftë në rastet kur gjykatësi në mënyrë të ligjshme ka udhëruar lirimin e personave. Tetë persona, njëri i mitur për afërsisht 15 vjeçar, ende mbahen në burg nga ana e KFOR-it, edhe pse gjykatësi hetues i ka liruar ata. Meqenëse këta persona ende mbahen të burgosur përkundër urdhëresës (vendimit) për lirimin e tyre, ata momentalisht janë subjekt i burgosjes (paraburgimit) arbitrare nga ana e KFOR-it.

Obiliq 9

Në një rast, një pjestarë i ekzekutivit, nën ombrellën e PSSP, gojarisht ka urdhëruar burgosjen jashtë-gjyqësore për disa persona.

Me 27 Nëntor 2000, janë arrestuar nëntë persona të dyshuar për vrasje dhe janë burgosur në Burgun e Prishtinës. Dy ditë më pas, prokurorit publik i'u është dhënë dosja policore. Asnjëri prej personave të burgosur nuk është dërguar para organeve gjyqësore në afatin prej 24 apo 72 orësh prej momentit të arrestimit të tyre për shkelje të ligjit. Në bazë të

vlerësimin të dëshmitëve, prokurori ndërkombëtarë nuk ka parashtruar kërkesën për nisjen e hetimeve e as për vazhdimin e burgosjes(paraburgimit) për të dyshuarit.

Shtatë ditë pas arrestimit të tyre, janë liruar katër prej të burgosurve të cilët ishin të mitur. Deri me 5 Dhjetor 2000, pesë personat tjerë mashkuj akoma ishin subjekt i burgosjes(paraburgimit) por nuk ishin dëgjuar asnjëherë nga gjykatësi hetues. Të njëjtën ditë, Komisioneri i Policisë i ka dërguar Burgut një memo, me ç'rast ka kërkuar lirim të tyre. Ata nuk ishin liruar meqenëse në bazë të një memoje të policisë së UNMIK-ut, Zëvendësi i parë i PSSP, ka urdhëruar që njëri prej të burgosurve të mbetet në burg për "vlerësim mjekësor dhe psikiatrik" dhe që të tjerët të lirohen me 7 Dhjetor 2000.

Pas lirit të burgosurve atyre u është dhënë urdhëresa për përjashtim në bazë të *Rregullores 2000/62*. Një zyrtarë i KB, i ka deklaruar SMSJ-së, se këto urdhëresa për përjashtim janë nënshkruar nga Zëvendësi i parë e PSSP-së, përkundër faktit se ligji parasheh që vetëm organet e rendit (KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut) mund të autorizojnë urdhëresa të tilla. Ky rast ilustron ndërhyrjen jo të drejtë të ekzekutivit në pushtetin e organeve të rendit dhe në pavarësinë e gjykatave.

II. Afatet kohore të mbajtjes në paraburgim dhe zgjatja e paraburgimit

Ndalimi i burgosjes (paraburgimit) arbitrare përfshinë pjesërisht edhe obligimin e autoriteteve për të siguruar se asnjë person i burgosur mos të mbahet i burgosur më shumë se periudha e paraparë me ligj. Ligji në Kosovë ka përcaktuar këto afate ligjore si në vijim: së pari, çdo i burgosur duhet të dërgohet para gjykatësit brenda 24 orëve prej momentit të arrestimit të tyre (apo 72 orë në rrethanat e jashtëzakonshme); së dyti, të dyshuarit të moshës madhore nuk mund të mbahen në burg më gjatë se 12 muaj pa u ngritë aktakuza kundër tyre dhe e treta, nëse mbahen në paraburg ata kanë të drejtë të gjykohen brenda një afati të arsyeshëm kohor apo të lirohen. Ligji vendor kërkon nga gjykatësit që rastet kur i pandehuri mbahet si i paraburgosur, të trajtohet me një urgjencë të posaçme.

(a) E drejta për t'u dërguar menjëherë para autoritetit gjyqësor

Në raportin e kaluar, SMSJ, ka diskutuar detalet në ligjin vendor dhe atë ndërkombëtar sa i përket kësaj të drejte, dhe ka nënvizuar se ligji në Kosovë injorohet gati në mënyrë univverzale. Ligji vendor obligon autoritetet për dërgimin e të burgosurve para gjykatësit hetues brenda 24 orëve prej momentit të arrestimit të tyre. Megjithatë, dispozitat përjashtuese të ligjit vendor në veçanti neni 196 i LPP të RFJ, lejojnë policinë të mbajnë në burg personin deri në 72 orë, para se ta dërgojnë të njëjtin para organeve gjyqësore. Kjo është bërë rregull e përgjithshme. Kjo në veçanti është shqetësuese meqenëse në dhjetor 2000, Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë ka deklaruar nenin 196 të LPP të RFJ-së si jo kushtetues meqenëse lejon organeve të rendit që para organeve gjyqësore të urdhërojnë(caktojnë) burgosjen.

Zyrtarët policor të UNMIK-ut të cilët fillojnë punën tani, janë të stërvitur në mënyrë eksplicite lidhur me afatin 24 orësh të mbajtjes nën arrest policor dhe DD KB, ka

deklaruar se kanë krijuar një orar të gjykatësve kujdestar për këtë arsye. Megjithatë, përkundër faktit që Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, ka lëshuar një memorandum të rumbullaksimit të ligjit për këtë pikë, problemi vazhdon të mbetet i pranishëm.

Krahas kësaj, SMSJ, ka vërejtur se edhe “rregulli i 72 orëshit” vazhdon të cenohet në shumë raste. Rastet e përshkruara në raportin e kaluar kanë demonstruar se organet e rendit kanë dështuar të dërgojnë të burgosurit para organeve gjyqësore para 72 orëve, e më së shpeshti për shkak të urdhëresave gojore për zgjatjen e mbajtjes në burg(zgjatjes së paraburgimit) të bëra nga ana e prokurorëve publik dhe gjykatësve hetues. Shkelje të tilla të ligjit të zbatueshëm vazhdojnë. P.sh. në Prizren, SMSJ, ka dokumentuar dhjetë raste të tilla, kur personat janë mbajtur më shumë se 72 orë, në shumicën e rasteve 5 ditë, në periudhën prej dhjetorit deri në Shkurt 2001. Në fakt, Burgu i Prizrenit i ka konfirmuar SMSJ-së, se zgjatja e 72 orëve me urdhër të gjykatësit apo prokurorit publik është praktikë e rregullt dhe “gjithmonë ka qenë”. Edhe pse është rekomanduar në raportin e kaluar që qendrat e paraburgimit të udhëzohen të lirojnë personat të cilët nuk janë objekt i ndonjë urdhërese të ligjshme për burgosje, një politikë e tillë është zbatuar vetëm në Mars të v. 2001. Në atë politikë qëndron se të burgosurit që biejnë nën të ashtu-quajturën kategori A, nuk mund të lirohen pa pajtimin e Departamentit të Drejtësisë.

(b) E drejta për t’u liruar në bazë të ligjit vendor

Atëherë kur gjykata nuk vepron në bazë të afateve të caktuara me ligj, në veçanti kur kundër të dyshuarit nuk ngritet aktakuza brenda afatit prej 12 muaj sa ai gjindet në burg, ligji kërkon lirimin e tij. Megjithatë, për rastet e tilla nuk është dhënë ndonjë mjet juridik, përkundër faktit se gjykata nuk ka gjetur kushte ligjore apo nuk ka lëshuar urdhëresën për lirim në afatin e caktuar për të. Ashtu siç është përmendur më lartë, burgjet nuk janë duke lëshuar personat të cilët nuk janë subjekt i urdhëresave(vendimeve) ligjore për burgosjen (paraburgimin) e tyre.

Prizren

Lulzim, Bajram dhe Agim Gashi ishin burgosur me 7 Tetor 1999. Në pajtim me *Rregulloren 1999/26*, ata janë mbajtur 12 muaj në burg para ngritjes së aktakuzës. Përkundër faktit se kundër *Gashëve* nuk ishte ngritur aktakuza brenda afatit 12 mujor, kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prizren, përfshirë edhe gjykatësin ndërkombëtarë, zgjatën mbajtjen e tyre në burg deri me 31 Tetor 2000.

Stojan Jovanovic dhe Bogoljub Misic ishin burgosur me 31 Janar 2000. Edhe pse periudha 12 mujore për mbajtjen e tyre në burg kishte skaduar me 31 Janar 2001 para ngritjes së aktakuzës kundër tyre në afatin e duhur, ata nuk ishin liruar. Aktakuza në rastin *Jovanovic* daton me 1 Shkurt 2001 dhe aktakuza kundër *Misic* daton me 5 Shkurt 2001, të dy aktakuzat kanë arritur në Gjykatën e Qarkut në Prizren me 6 Shkurt 2001.

Enver Buzhala ishte burgosur me 2 Nëntor 2000 dhe atij i’u është caktuar burgu në kohëzgjatje prej një muaj, pra deri me 2 Dhjetor 2000 ashtu siç parshihet me ligj. Edhe një urdhëresë (vendim) për burgosje (paraburgim) është lëshuar në kohëzgjatje prej 3

ditësh e që skadonte me 6 Dhjetor 2000. Me 8 Dhjetor 2000, avokati mbrojtës dhe burgu përkatës kanë pranuar një urdhëresë(vendim) të re për burgosje(paraburgim) të *Buzhalës*, prej datës 6 Dhjetor 2000 deri me 6 Shkurt 2001. Kjo është konfirmuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në atë kohë, që urdhëresa(vendimi) për burgosje(paraburgim) ishte diktuar nga ana e gjykatësit ndërkombëtarë me 8 Dhjetor 2000 por e datuar me 6 Dhjetor 2000. LPP i RFJ parasheh që urdhëresa(vendimi) për zgjatjen e burgosjes(paraburgimit) pas periudhës një mujore, mund të bëhet nga ana e kolegjit, më së shumti për periudhën dy mujore.¹ Urdhëresa(vendimi) tri ditëshe dhe ajo e datuar më heret për dy muaj cenojnë këtë kufizim kohor.

Agim dhe Asllan Gashi ishin burgosur me 4 dhjetor 2000. Ata ishin marrë në pyetje nga ana e gjykatësit hetues me 7 Dhjetor 2000. Edhe pse urdhëresa(vendimi) për burgosjen(paraburgimin) e tyre datonte me 7 Dhjetor 2000, SMSJ, ka vërejtur gjykatësin, **jo gjykatësin hetues**, i cili diktonte urdhëresën(vendimin) për burgosje(paraburgim) me 8 Dhjetor 2000. Regjistrat e burgut konfirmojnë se kjo urdhëresë(vendim) është dorëzuar në po të njëjtën datë. Kjo urdhëresë(vendim) ngjanë të jetë e datuar më heret në mënyrë që të përputhet me kushtet ligjore.

Mitrovicë

Individët janë mbajtur në burg disa ditë pasi është urdhëruar lirimi i tyre nga ana e gjykatave, për shkak të problemeve të komunikimit në mes të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe burgjeve të Dubravës dhe Lipjanit. Rasti i *dy të miturve në paraburgim* paraqet shembullin e këtij problemi meqenëse ata ishin burgosur për periudhën prej **nëntë** ditësh për shkak se udhëresa për lirim e tyre nuk ishte komunikuar këtyre institucioneve në afatin e duhur. Dështimi në sigurimin e një sistemi efektiv për shërbimin e urdhëresave(vendimeve) për lirim e të burgosurve ka rezultuar në burgosje(paraburgime) të kundërligjshme në tërë regjionin.

(c) E drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme apo lirim nga paraburgimi

Ligji i zbatueshëm parasheh të drejtën e të burgosurit për një gjykim brenda kohës së arsyeshme apo lirim nga burgju.² Në konkludimin nëse periudha e paraburgimit është e arsyeshme, shteti duhet të tregoj një “përkushtim (elan) të posaçëm” gjatë zhvillimit të proceduës.³ Dispozita të ngjajshme janë të pranishme edhe në LPP të FRJ, të cilat theksojnë se “zgjatja e paraburgimit duhet të reduktohet në kohën më të shkurtër të nevojshme” dhe që shteti duhet të veprojë me urgjencë të posaçme kur i pandehuri është në paraburgim.⁴ Ligji vendor kërkon që gjykatat të caktojnë datat e gjykimeve dy muaj pas ngritjes së aktakuzës. Ekziston një shkelje e shkallës së gjërë e të gjitha këtyre dispozitave, sikundër që gjykatat e qarkut shpeshherë shfaqin mungesë të urgjencës në renditjen dhe përfundimin e gjykimeve penale. P.sh. lëndët shpeshherë shtyhen për shkak

¹ Lexo nenin 197 (2) të LPP të FRJ

² neni 5 (3) KEDNJ dhe neni 9 (3) PNDKP.

³ Tomasi kundër Francës, 27 gusht 1992, 241-A Ser. A para. 84

⁴ neni 190 (2) i LPP të FRJ

të dështimit në zhvillimin/kërkesës për analiza mjeko-ligjore, disa muaj pas ngritjes së aktakuzës.

Besim Hasani ishte burgosur që nga **13 Tetori 1999** dhe aktakuza për vrasje është ngritur me 22 Mars 2000. Në Gusht të v. 2000, është caktuar data për gjykimin e tij me 12 Dhjetor 2000. Në atë ditë gjykimi ishte shtyer për shkak se mbrojtja kishte pasur vërejtje në përfaqësuesin e palës së lënduar dhe për shkak se analizat mjeko-ligjore nuk janë përfunduar. Data tjetër e gjykimit është caktuar për janar 2001, por ishte shtyer dy herë për shaqe sigurie. Gjykimi kishte përfunduar në shkurt të v. 2001.

Zoran Stanojevic ishte burgosur me **14 Gusht 1999** dhe aktakuza kundër tij ishte ngritur me 9 maj 2000, duke u paditur për vrasje të rëndë të një Shqipëtarit të Kosovës gjatë incidentit të *Reqakut* në janar të vitit 1999. Seanca e parë ishte caktuar për datën 25 korrik 2000, por ishte shtyer për kohë të pacaktuar pasi që përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe dëshmitarët nuk u paraqitën në gjykatë. Seanca e dytë (para kolegjit të ri) është mbajtur me 24 janar 2001, por është shtyer për shkak të mungesës së rrymës. Gjykimi është shtyer edhe njëherë për t'u mbajtur me 6 shkurt 2001, kur për shkaqe procedurale është shtyer edhe një herë për një datë të pacaktuar për shkak se dy viktimat e supozuara nuk janë lajmëruar nga ana e prokurorit publik se pohimet e tyre janë tërhejkur nga aktakuza. Gjykimi ri-filloi edhe njëherë me 19 shkurt 2001, por u shtye për shkak se i pandehuri nuk ishte pruar në gjykim. Gjykimi tanimë ka ri-filluar.

Gjykimi për gjenocid i *Igor Simicit*, i cili ishte burgosur në **gusht të vitit 1999** dhe kundër të cilit është ngritur aktakuza në qershor 2000, ka filluar me 5 dhjetor 2000. Ky gjykim është shtyer shumë shpesh dhe atë për arsye të llojllojshme: ngrohje të pamjaftueshme në sallën e gjykimit, dështimi i pajisjeve për përkthim dhe dështimi i personelit të UN, dhe të dëshmitarëve për të marrë pjesë, parimisht për shkaqe sigurie. Pas fillimit të gjykimit, dëshmitarë të ri janë paraqitur për implikimin e *Simicit* në krimet për të cilat ai paditej, duke shtuar këtu edhe vonesa tjera të gjykimit. Me 14 shkurt 2001, kryetari i kolegjit ka informuar gjykatën se përkthimi gjatë dëgjimit në procedurën hetimore ishte aq i dobët sa që ata dëshirojnë përkthimin e ri, gjë që rezultoi në shtyerje të mëtutjshme. Në prill të v.2001 prokurori publik kishte tërhejkur aktakuzën. *Simic* ishte liruar.

Bashkim Hajdari ishte burgosur me **11 dhjetor 1999**. Aktakuza është ngritur me 18 korrik 2000. Edhe pse gjykimi i tij ka filluar me 20 nëntor 2000, ai është shtyer deri me 19 janar 2001 për shkak të mungesës së raportit mjekësor. Që atëherë, gjykimi është shtyer edhe njëherë për 9 mars 2001, në mënyrë që mjeku i mjekësisë ligjore të përpiloj një analizë të raportit mjekësor nga incidenti i cili kishte ndodhur në nëntor 1999. Me 9 mars 2001, rasti është shtyer edhe njëherë për shkak të mungesës së analizës së kërkuar.

Agron dhe Osman Mejzinolli ishin burgosur me **19 shtator 1999** dhe aktakuza kundër tyre është ngritur që nga 10 dhjetori 1999 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjykimi i tyre ka filluar me 1 nëntor 2000 ndërsa janë denuar në dhjetor 2000.

Igor Stanimirovic ishte burgosur që nga **27 marsi 2000**. Aktakuza për plaçkitje të armatosur, ishte ngritur me 21 prill 2000, gjë që ai kishte pranuar veprën. Për këtë rast ka pasur shtyerje të vazhdueshme për shkak se gjykatësi ndërkombëtarë nuk caktonte datën e gjykimit pa e marrë konfirmimin me shkrim nga Policia e UNMIK-ut se i bashkakuzuari ishte arratisur nga burgu në shtator 2000. LPP i RFJ, lejon veçimin e procedurës penale “për arsye të rëndësishme dhe për arsye të ekspedivitetit”.¹ Akoma nuk është caktuar data.

Halit Guri ishte burgosur me **9 korrik 1999** dhe “propozimi për masat e sigurimit” në bazë të asaj se ai është i sëmurë mentalisht, ishte lëshuar me 20 dhjetorë 1999. Edhe pse gjykimi i këtij rasti kishte filluar me 13 mars 2000, ai ishte shtyrë për 18 tetor 2000 për raporte shtesë psikiatrike për të pandehurin. Gjykimi filloi përsëri ndërsa prokurori publik nuk kishte dëshmitarë për të paraqitur, përjashtimisht ekspertëve mjekësor lidhur me shëndetin mental të të dyshuarit. Për shkak se Serbi i Kosovës si dëshmitar kryesor nuk kishte dhënë dëshminë e tij para gjykatësit hetues, prokurori publik kishte kërkuar që deklarata dëshmuese e dhënë para policisë, të lexohet në gjykatë. Edhe me kundërshtimin e avokatit, kolegji aprovoi propozimin. Me rikonvokimin e gjykimit me 17 dhjetor 2000, kolegji ka tërënjohur aprovimin e propozimit të prokurorit publik. Deri në këtë moment, procedura nuk ka vazhduar më tutje pasi që prokurori publik ka deklaruar se do të ankohet ndaj vendimit të trupit gjykues. Në bazë të prokurorit publik Gjykata Supreme e Kosovës ka aprovuar ankesën e tij. Përkundër dy vlerësimeve psikiatrike të bëra nga Spitali i Prishtinës, prokurori ndërkombëtarë ka urdhëruar një vlerësim të ri të shëndetit mendor. Gjykimi vazhdon.

Ankesat kundër vendimeve mbi paraburgimin, dukshëm janë duke shtyer hetimet e rasteve duke krijuar një dëshprim nxitës për individët që të mos ankohen kundër vendimeve të tilla. Në Gjilan, **lëndët origjinale** janë dërguar në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë për shqyrtimin e ankesave të vendimeve për paraburgim të lëshuara nga kolegji i gjykatave të qarkut. Si rezultat i kësaj, nuk mund të punohet në lëndë deri sa të kthehen ato. Në rastin e një të mituri, mbrojtësi i tij është ankuar kundër vendimit për caktimin e paraburgimit në fund të nëntorit 2000. Lënda e tij nuk është kthyer në gjykatën e qarkut deri me 7 janar 2001. Personat e burgosur kanë pranuar para SMSJ, se mbrojtësit e tyre i kanë këshilluar klientët e vet që të mos ankohen, pasi që ata do të kenë gjasa më të mëdha për t’u liruar më heret.

III. Paraburgimi i personave të sëmurë mentalisht

Ka të ngjarë se numri më i madh i personave që janë subjekt i burgosjes arbitrare, në fakt janë ata të dyshuar se janë të smurë mentalisht, shumica prej tyre që bijnë jashtë sistemit penal. Më tepër se 280 persona gjinden të burgosur në Institucionin Special të Shtimes, dhe së paku 20 personave u është ndaluar dalja nga Institucioni i Shtëpisë së Pleqëve në Prishtinë. Këto dy institucione janë nën përgjegjësinë e Departamentit të KB, për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Në të gjitha rastet edhe pse pacientët janë të burgosur, gjykata nuk ka shqyrtuar lëndët e tyre dhe ata mbeten të burgosur në bazë të vendimit të vetë institucionit. Megjithatë, Instituti i Shtimjes tani është duke ndërmarrur masa për

¹ neni 33 (1) LPP i RFJ

paraqitjen para gjykatës për rishqyrtim të të gjitha rasteve të paraburgimit, dhe i ka dorëzuar katër raste në gjykatën e Ferizajit për këto qëllime. Këto raste janë refuzuar nga gjykata, e cila kishte pohuar se nuk kanë ingerenca për këto raste. DD, dhe OSBE, kanë punuar aktivisht për adresimin e këtyre çështjeve dhe për sigurimin se numri i madh i lëndëve të tilla të procedohet përmes sistemit gjyqësor. Për këto raste do të ishte e domosdoshme të sigurohet prania e përfaqësimit ligjor për të gjithë të paraburgosurit.

Burgosja e personave të sëmurë mentalisht mbetet si problem serioz në kuadër të sitemit të drejtësisë penale, posaçërisht për shkak se nuk ka ndonjë objekt të duhur për burgosjen dhe trajtimin e tyre si në fazën paraprake ashtu edhe në atë përfundimtare. Parimi 20 i *Parimeve të KB për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore*, thot se personat të cilat vuajnë denimin me burg për veprë penale, të cilët përndryshe janë burgosur në vijë të procedurës penale apo hetimeve “ ka të drejtë në kujdesin më mirë të mundshëm të shëndetit mental”. Personat e tillë “do të trajtohen me humanitet dhe respekt për dinjitetin e qenies njerëzore”. Autoritetet kanë për obligim të implementojnë sistemin përmes të cilit mundësisht do të identifikohen personat e sëmurë mentalisht, posaçërisht ata në burgje në mënyrë që të sigurohet një trajtim dhe gjykim i drejtë.

Janë katër çështje që kanë të bëjnë me personat e sëmurë mentalisht në procedurën penale. Çështja e parë ka të bëjë me çështjen nëse personi ka aftësi për të përballuar gjykimin p.sh. aftësi për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në gjykimin kundër tij. LPP i FRJ, nuk e trajton këtë çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë por mundëson pushimin apo suspendimin e procedurës penale në rastet e sëmundjeve mentale.¹ Në rastet e të pandehurve të sëmurë mentalisht, SMSJ, ka vërejtur se rastet nuk përjashtohen në fazën e hershme edhe nëse i pandehuri mund të mos kuptojë procedurën, por ata vazhdojnë procedurën prej hetimeve deri të gjykimi. Kjo pjesë e ligjit vendor kërkon reformim.

Pyetja e dytë është ajo se nëse personi në kohën e kryerjes së veprës së pohuar, ka pasur *mens rea* të nevojshme, gjendjen psiçike, në atë se a ka qenë i aftë për të kuptuar pasojat e veprimit të tij. Ligji vendor parasheh këtë mundësi.² Të pandehurit të cilët nuk janë penalisht të përgjegjshëm duhet të lirohen për kryerjen e veprës penale, neni 350 (2) LPP i RFJ.

Çështja e tretë është ajo për rastet kur personit mund t’i ngarkohet përgjegjësia penale por ai ka sëmundje të caktuar mendore e cila e zvogëlon fajsinë e tij dhe kështu mund të ndikoj në caktimin e sanksionit. Ligji vendor gjithashtu edhe këtë çështje e shqyrton duke mundësuar dënim të zbutur për rastet e zotësisë së kufizuar.³ Personat penalisht të

¹ Lexo nenin 143, neni 169 (1), (4) neni 170 (1) (2) LPP i RFJ.

² Neni 12 (1) i LP të FRJ thekson “nuk konsiderohet i përgjegjshëm personi i cili ka kryer veprën penale dhe i cili në në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprës së vet apo nuk ka mundur të kontrolloj veprimet e veta për shkak të sëmundjes psiçike të përkohshme apo permanente, të çrregullimit të përkohshëm psiçik apo retardimit mental”.

³ Neni 12 (2) i LP të FRJ thekson se nëse për shkak të sëmundjes mentale të përkohshme apo permanente apo retardimit mental, “ zotësia e të pandehurit për të kuptuar rëndësinë e veprës së vet, apo aftësia e tij të kontrolloj veprimet e veta është reduktuar në mënyrë të dukshme, gjykata mund të caktoj dënim më të reduktuar”.

përgjegjshëm për veprimet e tyre, por të sëmurë mentalisht kanë të drejtën e mjekimit në burg.

Dhe së fundi çështja e katërt është ajo nëse personi i përmbushë këto kritere, p.sh. ai nuk është penalisht i përgjegjshëm për veprimet e veta, apo ka përgjegjësi të zvogluar, por është i rrezikshëm për veten dhe të tjerët, në këto raste ekziston nevoja për burgosjen e personit për qëllim mjekimi. Në rastet e tilla, gjykatat kanë të drejtën për të shqiptuar “masat e sigurimit” në bazë të LP të RFJ të cilat përfshijnë “ mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje e personit në institucionin shëndetësor” dhe “mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri”.¹ Procedura për zbatimin e masave të sigurimit është e rregulluar me nenet 493 – 498 të LPP të RFJ.

(a) Përdorimi i “masave të sigurisë”

Ligji vendor i cili rregullon zbatimin e masave të sigurimit nuk është konform standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në atë se gjykata mund të caktoj mbylljen e personit të sëmurë psiçikisht për kohë të pacaktuar.² Në bazë të KEDNJ, personat e burgosur për shkak të sëmundjeve të tyre psiçike, p.sh. ata paraqesin kërcënim për veten apo të tjerët, mbajtja e tyre në burg duhet të jetë subjekt i rishqyrtimit në intervale të rregullta kohore dhe i burgosuri duhet të ketë të drejtën e inicimit të rishqyrtimit të tillë.

Momentalisht ligji vendor nuk përputhet me këto standarde në atë se nuk parasheh ndonjë rishqyrtim të masës së sigurimit por jepë theks të veçantë rëndësisë së institucionit shëndetësor për informimin e gjykatës kur personi përfundon shërimin. Sidoçoftë, gjykata ka për detyrë monitorimin e zbatimit të këtyre masave. Momentalisht nuk ekziston ndonjë institucion shëndetësor ashtu si i paraparë me ligj dhe i cili do të mund të ofroj mjekim të duhur dhe të prezentoj gjykatës ecurinë e mjekimit.³ Burgu i Lypjanit është i paraparë për vendosjen e të miturve, grave dhe personave të sëmurë psiçikisht.⁴ Një bllok i tërë i këtij objekti është renovuar për personat e sëmurë psiçikisht. Momentalisht, shtatë persona të sëmurë psiçikisht, përfshirë tri raste të personave të cilëve u janë shqiptuar masat e sigurimit janë vendosur në Lypjan. Të gjithë personat që u janë shqiptuar masat e sigurimit apo të burgosur në Lypjan apo burgje të rregullta, në bazë të standardeve për të drejtat e njeriut, megjithatë kanë të drejtë qasjeje së paku në mjekim të rregullt.

Zenel Berisha është akuzuar për vrasjen e një djaloshi tetë vjeçar. Si duket incidenti kishte qenë si rezultat një grupi të djelmoshash të rinjë të cilët kanë ngacmuar të pandehurin. Që nga 21 korriku 1999, *Berisha* është mbajtur në burgun e KFOR-it

¹ Neni 63 & 64 i LP të RFJ.

² Edhe pse shfrytëzimi i gjyqit për të vendosur lidhur me burgosjen e personave të sëmurë psiçikisht paraqet një konfuzitet lidhur me bazën e burgosjes – çoftë ajo si denim për veprën penale të kryer apo si masë mbrojtëse apo për mjekim të personave të sëmurë psiçikisht, kjo nuk është domosdoshmërisht shkelje e standardeve të drejtave të njeriut.

³ Një grup punues momentalisht është duke punuar në hartimin e rregullores për reformimin e ligjit lidhur me vendosjen dhe rishqyrtimin e masave të sigurimit.

⁴ Administrimi Penal i KB ka theksuar se ky tani nuk është objekt adekvat për personat që i nënshtrohen masave të sigurimit.

Amerikan dhe diagnostifikuar nga ana e një psikologu klinik të KFOR-it Amerikan me diagnozën shizofrenik. Sidoçoftë, mjeku ka vlerësuar se *Berisha* nuk ka mundur të kuptojë natyrën e krimin të tij e as që ka qenë në gjendje të dallojë të keqen prej të mirës. Në bazë të kërkesës së prokurorit publik gjatë gjykimit, është vendosur që *Berisha* të vlerësohet nga klinika neuropsikiatrike në Prishtinë. Raporti i klinikës neuropsikiatrike ka konstatuar se *Berisha* në momentin e kryerjes së veprës “nuk ka kuptuar rëndësinë e veprimit të vet dhe nuk ka mundur të kontrollojë sjelljet e veta”. Raporti në vazhdim ka konkluduar se ai paraqet kërcënim për shoqërinë dhe duhet të institucionalizohet. Gjykata ka shqiptuar *Berishës* masën e sigurimit për “mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor”. Mëpastaj *Berisha* është transferuar prej Burgut të KFOR-it Amerikan në atë të Lypjanit.

Florim Domaci ishte akuzuar për shkakim të rrezikut të përgjithshëm dhe vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme gjatë vuarjes së zjarrit dy shtëpive, përfshirë edhe ato të anëtarëve të familjes së tij. Gjatë gjykimit *Domaci* kishte dëshmuar por deklarata e tij nuk ishte koherente dhe ishte konfuze. Mjeku nga klinika neuropsikiatrike kishte dëshmuar në bazë të ekzaminimit të *Domacit* dhe shënimeve të tij mjekësore nga klinika psikiatrike e Nishit kur ai më heret ishte mbajtur i mbyllur, duke konkluduar se *Domaci* vuan prej paranojës shizofrenike dhe ai paraqet rrezik për veten dhe për të tjerët. Ai rekomandoi që *Domaci* të burgoset në një institucion psikiatrik të tipit të mbyllur, për shkak se ai ishte arratisur nga institucionet tjera. *Domacit* i është shqiptuar masa e sigurimit për mjekim të detyrueshëm në institucionin shëndetësor. Ai momentalisht është i burgosur në Lypjan.

Vojislav Stevic ishte akuzuar për hudhje të granatës së dorës në dhomë ku gruaja e tij, gruaja e djalit dhe nëna e saj ishin plagosur rëndë. Mjeku nga KFOR-i Amerikan ka dëshmuar se sipas mendimit të tij *Stevici* ishte psiçikisht i sëmurë dhe se ai nuk ka kuptuar veprimet e veta në atë moment. Kur *Stevici* është pyetur nëse dëshiron të dëshmojë apo të heshtë, ai ishte përgjigjur se nuk dinte nëse po apo jo. Ai dukej se mezi kuptonte pyetjet e drejtuara ndaj tij dhe deklarimet e tija ishin konfuze. Në një moment ai ka deklaruar se ka dashur të vrasë veten me hudhjen e granatës por edhe se ai nuk i besonte të resë së vet se ajo nuk do t’ia helmojë ushqimin. Gjykata i ka shqiptuar *Stevicit* mjekim të detyrueshëm psikiatrik në një program jasht-pacientor dhe e ka liruar. Është e paqartë nëse ekziston një program i tillë.

Zeqir Basha ishte akuzuar për vrasjen e gruas së tij. Kur është thirrur në gjykim për të dëshmuar, ai u pajtua me mbrojtësin e tij për të mos dhënë deklaratën, por pastaj ka vazhduar duke thënë “për momentin, vetëdija më kishte humbur. Ka mundur të ndodhë një katastrofë edhe më e madhe, vetëm zemra (shpirti) ime e din këtë”. Vlerësimi i bërë për *Bashën*, nga ana e klinikës neuro psikiatrike theksonte se i pandehur në momentin e kryerjes së krimin, kishte shprehur një “kaos emocional dhe se zotësia e tij për kontrollimin e veprimeve të veta ishte zvogluar esencialisht”. Ata kanë konkluduar se *Basha* ishte i rrezikshëm për veten dhe të tjerët dhe për atë shkak ai duhej institucionalizuar. Gjykata i ka shqiptuar *Bashës* masën e mjekimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin shëndetësor. Kryetari i kolegjit dhe ekspertët gjatë gjykimit kanë deklaruar se nuk ekziston një objekt(institucion) i duhur për të pandehurin.

Për shkak se nuk ka objekt(institucion) të duhur, personat e sëmurë psiçikisht mund të lirohen. Në një rast, *Mirsad Kurteshi* ishte gjykuar për sulm kundër policëve dhe në bazë të raportit të ekspertit të neuropsikiatrisë atij i është shqiptuar masa e sigurimit. Në raport thuhej se *Kurteshi* kishte një lloj të karakterit agresiv dhe impulsiv, dhe se ai kishte sjellje anti shoqërore për të cilën ai nuk ishte përgjegjës. Përkundër masës së shqiptuar për mjekim të detyrueshëm në institucionin shëndetësor, *Kurteshi* ishte liruar për t'u mbrojtur në liri. Tani ai akuzohet për vrasje dhe tentim vrasje, të kryer pas lirimit të tij dhe nuk është burgosur.

(b) E drejta për trajtim në paraburgim

Sikur në disa prej rasteve të përmendura më heret, zyrtarët në kuadër të qendrave të rregullta të burgjeve identifikojnë se personat që gjinden në paraburgim mundën me qenë të sëmurë psiçikisht. *Rregullat dhe standardet minimale të KB për trajtimin e të burgosurve*, parashohin se në secilin institucion duhet ketë së paku një mjek me një njohuri të caktuar të psikiatrisë. Duhet të ekzistoj shërbimi psikiatrik për diagnostifikim dhe aty ku nevojitet edhe trajtimi i “abnormalitetit”. Dhënësi i shërbimit mjekësor në burg duhet t'i raportoj Drejtorit të institucionit “çdo herë kur ai konsideron se shëndeti mental i të burgosurit është dëmtuar apo do të dëmtohet si rezultat i vazhdimit të mbajtjes së tij në burg apo në ndonjë rrethanë tjetër të burgosjes”. Për këtë qëllim Administrimi Penal i KB, ka angazhuar, në bashkëpunim me repartin shëndetësor, psikiatra dhe motra medicinale që të vizitojnë burgjet e Prishtinës, Lypjanit dhe Prizrenit. Kjo qasje kohën e fundit është zgjeruar edhe në qendrat për paraburgim të Gjilanit dhe Pejës. Në Mitrovicë një psikiatër i KFOR-it Franqez viziton objektin e tyre në baza të rregullta.

Nuk ka ndonjë mekanizëm të vendosur për qendrat e burgimit për t'ju komunikuar gjykatave vlerësimet mbi gjendjen mendore të personave të burgosur, në mënyrë që të sigurohet një trajtim i duhur dhe në mënyrë që gjykata të njoftohet mbi çështjet e shëndetësisë psiçike që ndikojnë në të pandehurin. Mungesa e institucioneve të duhuara për të pandehurit e sëmurë psiçikisht është një problem parësor. Në të gjitha rastet e përshkruara në këtë pjesë, të pandehurit e sëmurë psiçikisht, janë mbajtur në burgjet e rregullta për pritje të gjykimit. Në shumicën e rasteve prokurori publik në fund të gjykimit ka argumentuar se të pandehurit janë të papërgjegjshëm penalisht, por që i nënshtrohen masës së sigurimit. Kuptohet se objektet e rregullta të burgjeve nuk kanë pasur mundësi të ofrojnë llojin e kujdesit të nevojshëm për të pandehurit e sëmurë psiçikisht.

Dragan Milosevic, ishte akuzuar për vrasje, për vrasjen e dy Serbëve të Kosovës në një kafene, pas rrahjes. Gjatë hetimeve, *Milosevic* ka pranuar se ai ka shprehinë e pirjes së marihuanës dhe se të njëjtën e ka bërë atë natë. Ai ka deklaruar se atij nuk i kujtohet se çfarë ka ndodhur pasi që është larguar nga kafeneja dhe është kthyer në shtëpi për të marrë pushkën automatike. Derisa ishte në burgun e Prishtinës, ai kishte shfaqur sjellje problematike dhe ishte kontrolluar nga mjeku. Sipas të dhënave nga burgju, mjeku e kishte diagnostifikuar *Milosevic* si person me “çrregullime psiçike”. Edhe pse zyrtarët e burgut kanë pranuar se gjendja e tij ishte përkeqësuar gjatë qëndrimit të tij në burg, zyrtarët e burgut nuk kishin informuar gjykatën apo prokurorin publik për gjendjen e tij

në burg. Në asnjë moment gjatë procesit të gjyimit, nuk është ngritur çështja e shëndetit psiçik, përjashtimisht në fjalimin përmbyllës të mbrojtësit të tij. Ai kishte argumentuar se *Milosevic* ka mundur të vuaj nga çmenduria e përkohshme pasi që ai kishte konsumuar sasi të mëdha të alkoholit dhe drogës në natën e incidentit. Edhe pse alkoholi dhe droga sipas ligjit nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale gjakata mund të shqiptoj trajtim adekuat në rastet e tilla. *Milosevic* është shpalluar fajtor dhe është denuar me 14 vite burgim.

Ismail Avdyli është akuzuar për vrasjen e babait të vet duke e qëlluar atë me çelës anglez në kokë. Vëllezërit e tij kanë dëshmuar se pas incidentit *Ismaili* ishte në një gjendje të shokuar dhe nuk ishte i vetëdijshëm për rrethanat. Në raportin policor indikohet se i akuzuari ka pasur një sëmundje serioze të zemrës dhe se kishte nevojë për ndërrimin e pejsmejkerit (aparati i cili ndihmon zemrën). Edhe pse ishte urdhëruar vlerësimi psikiatrik, duket se nuk është realizuar fare. Në fund të gjyimit, prokurori publik kishte zbutur aktakuzën prej asaj për vrasje në “vrasje nga momenti”. Edhe pse aktakuza kishte përmendur dëshminë e vëllezërve, nuk kishte referencë për vlerësim psikiatrik. Pas gjyimit gjykatësi i ka delaruar SMSJ-së se ka pasur raport psikiatrik i cili ka vlerësuar *Ismailin* si kompetent (me zotësi), por ky raport i pohuar nuk gjindet në lëndë dhe asnjëherë nuk ka hyrë procesverbal gjyqësor.

Adem Namliqi ishte arrestuar për zjarrvënje në shtëpinë e tij me ç’rast kishte lënduar antarët e familjes së vet. Edhe pse policia ishte orvatur që lëndën t’ia dorëzoj prokurorit publik të gjykatës komunale, ai kishte refuzuar këtë duke deklaruar se rasti ishte çështje për qendrën sociale e jo për gjykatën penale. *Namliqi* ishte burgosur në Spitalin e Prizrenit në repartin psikiatrik dhe i ruajtur nga dy policë. Nuk kishte pasur ndonjë vendim për paraburgim apo për fillimin e procedurës për burgosjen e tij në baza të sëmundjes psiçike të tij. Mjeku në repartin psikiatrik të spitalit ka informuar SMSJ-në, se ai mund të burgos *Namliqin* pa ndonjë proces gjyqësor në baza të sëmundjes psiçike. Ekspertiza e bërë ndaj *Namliqit* pohonte se ai ishte i sëmurë psiçikisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë. Prokurori publik më pastaj e muar rastin dhe e transferoi *Namliqin* në Spitalin e Prishtinës.

Kadri Krasniqi ishte nën dyshimin e gjykatës komunale të Kamenicës për sulme serioze kundër anëtarëve të familjes së tij. Ai ishte dërguar në burgun e Gjilanit. SMSJ, ishte përpjekur të intervistoj Krasniqin, sidoqoftë për shkak të gjendjes së tij psiçike ishte i pamundur komunikimi me të. Dhoma e burgut që ishte i vendosur Zot. Krasniqi dhe ai vetë, kutërbonin në feces të tij. Gjykata shqiptoi masën e sigurimit për Krasniqin për ta vendosur në institucionin shëndetësor psikiatrik.

II. Të miturit në paraburgim

Në raportin e kaluar, SMSJ, ka nënvizuar çështjet që kanë të bëjnë me të miturit e burgosur të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashohin se të miturit që janë në kundërshtim me ligjin duhet të trajtohen në mënyrë të dryshme prej madhorëve, në atë se të gjitha aktivitetet e autoriteteve duhet të merren për ineteresin më të mirë të të miturit. Krahas kësaj, burgimi i të miturve duhet të përdoret si masë e fundit. DD i KB, si rezultat i punës së Ekipit të

përbashkët për legjislacionin e të miturve, ka lëshuar tri qarkore mbi këto çështje dhe çështje të lidhura me to, me ç'rast ajo më e fundit ka informuar gjykatësit se periudha e mbajtjes së të miturve në paraburgim duhet të llogaritet me rastin e rishqyrtimit të masave edukuese.

Edhe pse është arritur përparim për t'u siguruar se kohëzgjatja e paraburgimit për të mitur - të përputhet me kufizimin ligjor prej tre muajsh, shqetësimet lidhur me të miturit e burgosur vazhdojnë të jenë prezente pasi që ata shpeshherë paraqiten para gjykatave. Gjatë dymbëdhjetë muajve të kaluar, 180 të mitur janë paditur nga gjykata e qarkut për delikte serioze. 63 lëndë të rënda ku janë përfshirë të miturit kanë përfunduar. Në këtë periudhë 414 të pandehur janë gjykuar, ndërsa 272 lëndë kanë përfunduar, të miturit përfaqësohen në 23% të të gjitha lëndëve. Të miturit janë të prirur për të kryer kundërvajtje, edhe pse nuk ka statistika për gjykatat e ulëta, është më se e arsyeshme që të supozojmë se delikuenca e të miturve paraqet problem të konsiderueshëm.

Policia e UNMIK-ut, në vazhdimësi dështon të sigurojë që të miturit të merren në pyetje në prezencën prindërve të tyre dhe përfaqësuesit të tyre ligjor. Prej 36 të miturve të intervistuar nga SMSJ, 34 kanë deklaruar se prindërit e tyre nuk kanë qenë prezent gjatë marrjes në pyetje. Këta të mitur janë ankuar se as policia e as gjykatësi hetues nuk i ka njoftuar ata se kanë të drejtë të mbrohen në heshtje. Një i mitur është ankuar se gjykatësi hetues i kishte bërë atij kur ai nuk dëshironte të jepte deklaratë.

Gjatë marrjes në pyetje nga policia, shtatë të mitur i janë ankuar SMSJ-së se ata kanë qenë objekt i abuzimeve, siç janë të rënat, goditja me shuplakë apo lidhja për karrige me pranga nga ana e policëve të SHPK-së. Shumica e këtyre raportimeve vijnë nga regjioni i Gjilanit dhe ky problem është shtruar para Komanduesit Regjional. Në disa raste policët ndërkombëtarë kanë intervenuar, ndërsa në të tjerat policët ndërkombëtarë nuk kanë qenë prezent.

Krahas burgosjes së të miturve mi baza të dyshimit për kryerjen e veprave penale, të miturit gjithashtu burgosen edhe nga ana e KFOR-it Amerikan nën dyshimin se ata janë anëtarë të grupeve kryengritëse. Këta të mitur janë objekt potencial i paraburgimit të pacaktuar pa ndonjë mekanizëm të rishqyrtimit gjyqësor të burgosjes së tyre. Përafërsisht kanë qenë 16 të mitur të moshave në mes 15 dhe 18 vjet të burgosur në këtë mënyrë kah mesi i dhjetorit 2000 dhe fundi i shkurtit 2001. Në dy raste të miturit kanë qenë objekt i *urdhërësës për përjashtim të Rregullores 62*, pa prezencën e prindërve të tyre apo përfaqësuesve të tyre. KFOR-i Amerikan konsideron se këta të mitur janë në rrezik dhe se një program social civil që do të merrej me ta do të ishte më i përshtatshëm. Program i tillë nuk ekziston pasi që institucionet përgjegjëse për çështje të fëmijëve, Qendrat Sociale nuk janë duke funksionuar në këtë drejtim.

Ashtu si është potencuar në raportin e kaluar lidhur me një delikuent të supozuar dhe i mitur i akuzuar për gjenocid, publikimi i identitetit të të miturit të përfshirë në procedurë penale paraqet shkelje të ligjit vendor dhe atij ndërkombëtar. Problemet e tilla kanë vazhduar edhe gjatë gjashtë muajve të kaluar. Një gazetë vendore ka mund të hyj në burgun e Lypjanit dhe ka publikuar emrat dhe fotografitë e të miturve që gjindeshin në

burg.¹ Krahas kësaj, ky medium ka publikuar në mënyrë të përsëritur identitetin e të riut i cili është paditur për vrasjen e ushtarit të KFOR-it Rus, e poashtu edhe për vepra tjera penale.²

Burgosja, e posaçërisht paraburgimi i të miturve për një periudhë të caktuar duket së është normë e jo përjashtim. Paraburgimi akoma përdoret kur të miturit dyshohen për vepra të lehta siç është vjedhja e vogël. Momentalisht nuk ekziston ndonjë masë alternative në shoqëri karshi burgosjes për të mitur të cilët kanë nevojë për mbrojtje apo largim nga ambienti i shtëpisë së tyre.³ Shfrytëzimi i shumë metodave tjera alternative kundrejt burgosjes dhe masave tjera të caktuara me ligj është akoma tepër i rrallë.⁴

Ligji i zbatueshëm parasheh se burgu për të miturin e denuar si ndëshkim është përjashtim dhe duhet të caktohet së paku për një vit kur bëhet fjalë për të miturit e rritur, p.sh. ata të moshës 16 deri 18 vjeçare në momentin e kryerjes së veprës penale.⁵ Gjykata për kundërvajtje në Viti në dy raste ka burgosur të miturit për disa ditë apo javë si dënim për shkak se ata nuk kanë paguar gjobën e caktuar. Në rastet e tilla gjykatësit duhet të marrin parasyshë ligjet speciale për të mitur, të cilat shfrytëzimin e sanksionit të tillë (burgosjes) e vendosin në rend të dytë dhe janë alternativë kundrejt burgosjes, siç janë: punësimi dhe pjesëmarrja në grupet e të rinjëve, që do të ishin më adekuate.

Ngurrimi i gjykatësve në përdorimin e alternativave kundrejt burgimit të paraparë me ligj, mund të rrjedhë së paku pjesërisht nga mosfunksionimi i duhur i Qendrave Sociale (në kudadër të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale). Ky institucion social ishte dashur të luaj rol in kryesor në procedurën penale ku përfshihen të miturit dhe të mbikqyrë të miturit gjatë përdorimit të alternativave kundrejt burgimit. Përgjithësisht është e njohur se të miturit të cilët janë të inkuadruar në shoqëri për t'u socializuar dhe në programe integruese, ata kanë më pak gjasa për të përsëritur sjellje kriminale. Sidoqoftë QS vuan prej deficitit të mjeteve, personelit, kuadrove profesionale dhe nganjëherë edhe të zotimit për t'u dalur zot obligimeve të tyre sa i përket fëmijëve të cilët hyjnë në konflikt me ligjin. Pa një reformë substanciale dhe zhvillim të këtij institucioni, mundësitë për një progres janë të vogla për arritjen e standardeve ndërkombëtare për delikuentët e mitur apo për parandalimin e delikuencës së të miturve.

¹ Administrimi Penal i KB ka deklaruar se ata do të sigurojnë se në të ardhmen mos të lejojnë hyrjen e mediave te të miturit e burgosur.

² Në procedurën penale kundër të miturit “aktakuza” quhet “propozimi për masa edukuese” *lexo* nenin 74 të LP të RFJ

³ *Lexo* nenin 473 të LPP të RFJ

⁴ Masat alternative karshi masave edukuese janë ato nën mbikqyrjen e shtuar të prindërve, familja tjetër apo organi i kujdestarisë i QPS i paraparë në nenin 17 të LPK.

⁵ *Lexo* nenin 77 dhe nenin 78 të LP të RFJ

PJESA 4: GJYKATAT

I. ÇËSHJET ORGANIZATIVE

Hyrje

Në gjashtë muajt e kaluar gjykatat e qarkut kanë vazhduar punën e tyre në një numër të konsiderueshëm gjykimesh penale.¹ Shumica e lëndëve penale janë zgjidhur në një mënyrë të drejtë, që d.m.th. se aktgjykimet liruese dhe ato denuese kanë qenë të bazuara në dëshmi të mjaftueshme. Megjithatë çështjet e definuara në raportin e kaluar vazhdojnë të jenë prezente në tërë Kosovën dhe ato janë komplekse. Ato përfshijnë parregullësitë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, pranueshmëria e dëshmimeve irrelevante dhe të papranueshme, mungesa e saktësisë gjatë hetimeve dhe në procesverbalet gjyqësore, dhe nevoja për arsyetimin (sqarimin) gjyqësor gjatë vërtetimit të gjendjes faktike.

Si pasojë e përjashtimit diskriminues të një numri të konsiderueshëm të gjyqësisë vendore për një periudhë më tepër se dhjetë vejeqare, gati të gjithë gjykatësit dhe prokurorët e tanishëm nuk kanë pasur mundësinë e ushtrimit të shkathtësive të tyre ligjore apo për të vazhduar me edukim të mëtutjeshëm ligjor. Për të shtuar këtu se ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në kornizën ligjore të vendit kanë qenë inekzistente deri në ardhjen e Administratës së përkohshme të UNMIK-ut. Më pas, deri në këtë moment, gjyqësia vendore nuk ka pasur qasje ndaj këtyre ligjeve e as ligjeve dhe procedurave moderne të Evropës. Në tetor 2000, SMSJ, ishte informuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, se standardet e tilla nuk janë pjesë e ligjit të zbatueshëm dhe se të njëjtat nuk do të zbatohen nga gjykatësit e tij.

I. Qasjet ndaj Arsyetimit ligjor

(a) Gjykatësit hetues dhe gjykatësit gjykues kanë nevojë për stërvitje mbi shkathtësitë ligjore në marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Mungesa e shkathtësive të zhvilluara për marrjen në pyetje rezultojnë në prezentimin e dëshmimeve irrelevante dhe rezultojnë në dështimin e shqyrtimit të qështjës kryesore të lëndës. Dëshmitarëve shpeshherë u parashtrihen pyetje sipërfaqësore për ngjarjet kyçe. Ky dështim në fazën e hetimeve më pastaj ndikon në fazën e gjykimimit sepse shumica e kolegjeve pyesin dëshmitarët nëse mbështesin apo nuk mbështesin deklaratën e dhënë para gjykatësit hetues. Shumica e dëshmitarëve mbështesin këtë (dekl. para Gjyk. Hetues), si rezultat i dështimit të kolegjit në hetimin, apo zhvillimin e mëtutjeshëm të dëshmimeve. P.sh. në Prishtinë, njëri prej gjykatësve ndërkombëtarë shpeshherë lexon në procesverbal deklaratën e dhënë më heret, me pak apo fare pyetje plotësuese.

¹ Në periudhën gjashtë javëshe mes dhjetorit 2000 dhe janarit 2001, gjykata e qarkut në Prishtinë ka mbajtur 17 gjykime për vrasje.

Shaban dhe Hasan Selimi ishin paditur në lidhje me incidentin në një kafene me ç'rast një njeri lëndohet ndërsa tjetri kërcënohet. Kryetari i kolegjit njohtoi të pranishmit se pasi që gjykatësi ndërkombëtarë shkante në pushim gjykimi duhej përfunduar për një ditë.

Lënda ishte kundër dy burrave të përfshirë në një fjalosje në kafene, dhe e cila rezultoi që njëri prej të pandehurve të supozohet se kishte tentuar të vrasë njërin prej viktimave. Një numër çështjesh dolën për t'u shqyrtuar në gjykim, në mes tjerash, kush ishte përgjegjës për cilat lëndime, natyra e lëndimeve të vërtetuara dhe nëse të pandehurit kishin vepruar në vetmbrojtje të ligjshme (të pandehurit kishin ngritur këtë argument mbrojtës para gjykatësit hetues). Por gjatë gjykimit, nuk është bërë ndonjë përpjekje për arritjen e një pasqyre të qartë se çka kishte ndodhur gjatë rrahjes. Më pastaj, dëshmitarëve u ishin parashtruar pyetje të përgjithshme lidhur me aspektet kyçe të ngjarjes e cila ka rezultuar në incident. Nuk ishte bërë ndonjë përpjekje për ndriqimin e teorisë së prokurorit se i pandehuri kishte tentuar të vras viktimën. E as që kishte pasur ndonjë përpjekje për ndriqimin e teorisë së të pandehurit se ata kishin vepruar në vetmbrojtje të ligjshme. Nuk ishte parashtruar gjithashtu asnjë pyetje lidhur me shkaktimin e lëndimeve ndaj viktimës. Një shqyrtim i tillë do të sqaronte nëse aktakuza për tentim vrasje ishte akuzë më e drejtë se ajo për lëndime trupore. Nuk kishte pasur dëshmi nëse lëndimet e vërtetuara ishin të rrezikshme për jetë. Në nxitimin e tij të dukshëm për përfundimin e gjykimit për një ditë, kryetari i kolegjit kishte refuzuar shumë pyetje të parashtruara nga prokurori publik dhe nga mbrojtësi. Gjykatësi ndërkombëtarë nuk ka parashtruar asnjë pyetje gjatë tërë procesit të gjykimit.

Në gjykimin e tre të miturve për tentim dhunimi seksual, ka pasur një dallim të konsiderueshëm në mes të deklaratave të tyre të dhëna para gjykatësit hetues dhe deklaratave të dhëna gjatë gjykimit. Kryetari i kolegjit kishte pyetur se cilën deklaratë e mbështesin ata. Nuk kishte pasur pyetje plotësuese për të sqaruar dallimin në fjalë.

Në gjykimin për vrasje kundër *Refki Bytyqit*, i pandehuri ka pranuar se ka qëlluar për vdekje dikënd që ai e njihte. Dëshmitarët e vrasjes nuk kanë mundur të spjegojnë se çfarë ka mundur të jetë motivi për këtë. Raporti psikiatrik theksonte se i pandehuri vuante nga “një shkallë e lehtë e retardimit psikik... (dhe kishte) tendenca të reagimit impulsiv... dhe zotësi të pakësuar të njohjes dhe kuptimit të rrezikut të sjelljeve të tija”. Në gjykim, eksperti deklaroi se përgjegjësia e të akuzuarit ishte vetëm “lehtë e pakësuar”. Kolegji përfshirë këtu edhe gjykatësin ndërkombëtar, dështoi të ndriqoj më detalisht çështjen kryesore të përgjegjësisë penale. Në fakt, gjykatësi ndërkombëtar nuk kishte parashtruar asnjë pyetje.

Shqetësimi tjetër lidhur me këtë rast ishte se procedura ishte zhvilluar në gjuhën të cilën i pandehuri nuk e kuptonte. Kryetari i kolegjit ishte Boshnjak. Si rezultat, fillimisht gjykimi u mbajt në gjuhën boshnjake pamarrë parasysh faktin se i pandehuri kishte informuar gjykatën se ai nuk din të flasë gjuhën boshnjake (apo serbo-kroate) (prokurori dhe mbrojtësi flisnin boshnjakisht). Dëshmia e të pandehurit dhe e dëshmitarëve Shqipëtar ishte përkthyer në gjuhën boshnjake dhe pastaj në gjuhën angleze për gjykatësin ndërkombëtar. Pjesët tjera të gjykimit nuk ishin përkthyer në gjuhën shqipe.

(b) Dëshmitë irrelevante dhe të papranueshme

LPP i FRJ bën të qartë atë se “*kryetari i kolegjit ka për detyrë që të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm të lëndës, zbulimin e së vërtetës dhe mënjanimin e çdo gjëje që zvarrit procedurën e nuk shërben për sqarimin e çështjes*”.¹ LPP i RFJ parasheh përjashtimin e pyetjeve dhe përgjegjëjeve të cilat janë irrelevante dhe të papranueshme.² Pranueshmëria e dëshmimeve është çështje e rregullimit të ligjit vendor dhe si rregull i përgjithshëm për gjykatat vendore të vlersohen dëshmitë para tyre. Pamarrë parasysh këto, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë analizës nëse procedura ka qenë e drejtë, vështrojnë procedurën si tërësi, përfshirë këtu edhe mënyrën në të cilën është marrë dëshmia (prova).

Një numër i konsiderueshëm i kolegjeve gjyqësore shpeshherë lejojnë prokurorit publik prezentimin e deklaratave që nuk kanë ndonjë vlerë substanciale, por irrelevante dhe prejudikuese. Kjo rezulton në shtyerje të gjykimeve dhe padrejtësi për të pandehurin.

Shembulli më flagrant ka ndodhur në rastin *Momcilo Trajkovic* kur kolegji gjykues (përfshirë këtu edhe një ndërkombëtarë) ka lejuar prokurorin publik që të paraqes dëshmitë e veprimeve të mëhershme të torturimit të pohuara se janë kryer nga i pandehuri në ngjarjet mes vitit 1982 – 1984, përfshirë këtu pohimin se ai ka gjuajtur një njeri prej dritares. Janë paraqitur gjithashtu dëshmi që i biri i të pandehurit së bashku me policinë ka rrahur persona në autobus në vitin 1998. Aktakuza i referohet vetëm pohimeve të kriminit të kryer në vitin 1999. I pandehuri nuk është paralajmëruar se do të paraqiten këto dëshmi dhe në asnjë fazë të gjykimit prokurori publik nuk ka tentuar të ndryshoj aktakuzën. *Trajkovic* është shpallur fajtor dhe është dënuar me njëzet vjet burgim.

Në rastin *Bajrush Berisha*, kolegji gjykues (përfshirë edhe gj. ndërkombëtarë) ka lejuar mbrojtjes që të njohtojë mbi peticionin e fshatit ku ka ndodhur vrasja. Mbrojtësi ka njohtuar gjykatën se “*i tërë regjioni është kundër familjes (së viktimës) dhe se nuk dëshiron që ata të jetojnë aty për shkak të bashkëpunimit të tyre me forcat Serbe në v. 1998 dhe 1999*”. Peticioni i nënshkruar nga 156 fshatarë, theksonte se viktimat dhe familja ishin bashkëpunëtor të Serbëve. SMSJ, nuk është e sigurtë mbi rëndësinë e këtij dokumenti. Sipas gjykatësit ndërkombëtar, kolegji nuk kishte të drejtë të refuzoj pranueshmërinë e dëshmimeve që kishin të bënin me familjen e viktimës. SMSJ, supozon se gjykatësi ka menduar se ishte e pranueshme për shkak se nuk prejudikonte të pandehurin p.sh nuk shkonte në dëm të mbrojtjes së tij.

Në gjykimin e *Shefqet Rrahmanit*, për vrasje, kolegji kishte lejuar për dëshmi dy letra të cilat përkrahnin të pandehurin. Njëra letër, që vinte nga fshati i të pandehurit, ishte në formë të peticionit që theksonte sjelljet e mira të pandehurit. Letra e dytë vinte nga bashkëluftëtarët e të pandehurit në UÇK. Aty thuhej se “*dy viktimat ishin bashkëpunëtor të regjimit Jugosllav dhe se ata kishin i shkaktuar shumë dëme të pandehurit, pasi që ata e kishin paraqitur në policinë Serbe. I pandehuri ishte rrahur dhe ishte kanosur nga*

¹ Neni 292 (2) LPP i FRJ (lexo gjithashtu nenin 322)

² lexo nenin 219,318,327 të LPP të FRJ

policia Serbe, por në vend që të bashkëpunoj me regjimin e Milosevicit, ai ka zgjedhur ...t'i bashkangjitet UÇK-së...UÇK-ja vetë ka hetuar rrethanat e vrasjes në atë kohë, dhe ka shpallur të pafajshëm të pandehurin”.

Në gjykimin e *Nebojsa Djukic* dhe *Lazar Vukovic*, për posedim të armatimit të rëndë, kryetari i kolegjit ka filluar të marrë në pyetje njërin prej të pandehurve lidhur me faktet që kishin të bënin me akuzat që ishin hudhur, përkatësisht për Pregaditje për Akte Terroriste. Mbrojtësi kishte kundërshtuar këtë ndërsa gjykatësi ishte tërënjekur.

(c) Sqarimi i qasjes së zbulimit të së vërtetës

Aktakuzat, posaqërisht në rastet e rënda penale, dështojnë të artikulojnë në një mënyrë efikase dhe koherente çështjen penale të ndjekjes. Prokurorët publik, si rregull nuk caktojnë veqoritë e veprës penale të pohuar. Aktakuzat në përgjithsi ri-numrojnë incidentet, pohojnë pjesmarrjen e të pandehurit dhe pastaj dështojnë të shpjegojnë se çka ka bërë saktësisht i pandehuri. Ky dështim vendosë palën mbrojtëse në një pozitë të disfavorshme për shkak se i pandehuri ka të drejtë të dij, paraprakisht dhe detalisht për lëndën në mënyrë që ai të përgjigjet.¹

Edhe pse barra është në palën ndjekëse dhe se i pandehuri prezumohet i pafajshëm, LPP i RFJ, obligon që i pandehuri të merret i pari në pyetje.² I pandehuri rrëfen të kaluarën e tij, pastaj ai pyetet nëse e pranon veprën dhe, me supozimin se ai nuk pranon fajsinë ai merret në pyetje, jo gjithherë, për çështjet konkrete. Në rastet më komplekse kjo qasje humbë kuptimin e rendit apo koherencës.

Në rastin *Sava Matic*, për krime lufte, i pandehuri ishte pyetur për ndodhjen e tij dhe sjelljet e tija gjatë dy periudhave kohore të ndara, korrik 1998 dhe prej marsit 1999 deri në qershor 1999. Kryetari i kolegjit (ndërkombëtar) pyetet e tij nuk i kishte vuar në kontekst dhe pasi që dëshmitarët e prokurorit ende kishin për të dëshmuar, *Matic* kishte dhënë përgjigje të përgjithshme dhe asgjë konkrete. Në rastet ku përfshihen një numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve dhe incidenteve (p.sh. *Trajkovic dhe Kolasinac*, deri në 90 dëshmitarë ishin paraparë) është gati e pamundur të arrihet një kuptim i bazuar se kush është duke pohuar diçka, kur dhe ku. Ashtu si është përmendur më heret, ky problem përkeqësohet kur kolegji gjykues vetëm pyet të pandehurin nëse pranon apo hudhë dëshminë e dëshmitarëve. Kur ndodh kjo, të pandehurit nuk i jipet mundësia që të zgjeroj hudhjen e tij apo refuzimin e tij apo të kundërshtoj në ndonjë mënyrë kuptimplote konstatimet e dëshmitarëve.

LPP i RFJ lejon kolegjin që të devijojë nga “*procedura e zakonshme e shqyrtimit për shkak të rrethanave të posaçme, e sidomos për shkak të numrit të të akuzuarve, numrit të veprave penale dhe vëllimit të materialit të provave*”. (potencimi është shtuar) Një qasje më koherente do të ishte që prokurori publik të paraqesë të gjitha deklaratat relevante në fillim të gjykimin. Kjo ofron mundësinë për të pandehurin jo vetëm për të dëgjuar dhe kuptuar pohimet kundër tij por gjithashtu të vendos nëse dëshiron të dëshmojë dhe të

¹ neni 73(1)LPP RFJ, neni 14(3) (b) PNDPC, Parimi 21 i Parimeve themelore të Rolit të avokatëve.

² Neni 316 LPP FRJ

argumentoj kundërshtimin e tij ndaj të gjitha dëshmime të prokurorit. Gjithsesi, gjatë dëgjimit në procedurën hetimore, të pandehurve me supozimin se janë të pranishëm, njoftohen lidhur me akuzat e prokurorit. Por praktika tregon se të pandehurit nuk janë rregullisht të pranishëm dhe se nuk është e pazakonshme për lëndën e prokurorisë që të zhvillohet në mënyrë të konsiderueshme pas ngritjes së aktakuzës.

(d) Arsyetimi ligjor nga gjykatësit

Arsyetimi i tillë është bazë për zhvillimin koherent dhe paraqitjen e cilësdo lëndë penale dhe manifestohet, në mes tjerash, me marrjen në konsideratë të çështjeve lidhur me burgimin, dëgjimin e dëshmitarëve, ekzaminimin e provave dhe caktimin e dënimit.

P.sh. vendimet për paraburgim sipas LPP të RFJ, duhet të jenë aktvendime të shkruara të cilat duhet të përmbajnë dhe “arsyetimin e shkurtër, me kusht që baza për caktimin e paraburgimit do të arsyetohet veçanërisht”.¹ DD KB, ka përpiluar një Qarkore të Drejtësisë /2000/27, të datës 19 dhjetor 2000, e cila përkujton gjykatësit se të gjitha vendimet mbi paraburgim duhet të bëhen në baza të një aktvendimi të arsyetuar plotësisht dhe të shkruar. Qarkorja vetvetiu nuk është e mjaftueshme në mungesë të stërvitjes efektive dhe gjykatat akoma dështojnë të paraqesin në mënyrë të plotë arsyet për paraburgim. Vendimet për paraburgim vazhdojnë të pasqyrojnë dispozitivin e bazës për burgosje sipas LPP të RFJ, pa paraqitje të fakteve apo arsyeve të cilat mbështesin vendimin për heqjen e lirisë kundër personave.

Aktgjykimet e shkruara gjithashtu kanë dështuar që të artikulojnë, në ndonjë mënyrë të kutpueshme, elementet e veprës penale. SMSJ, ka vërejtur se shumica i paraqesin faktet e veprës penale, mbrojtjen e prezentuar, nëse ka, dhe deklaratën që i pandehur ka kryer apo nuk ka kryer veprën penale. Nuk ka ndonjë analizë të **elementeve** të veprës penale.

Dragan Nikolic ishte paditur për bashkëpjesmarrje në veprën penale të vrasjes së “rëndë”.² Në aktakuzë thuhej se me 5 prill 2000 persona të armatosur të RFJ-së dhe civilë në uniforma ushtarake dhe policore, kanë hyrë në fshat duke kërkuar armë dhe para e gjithashtu edhe kanë urdhëruar banorët që të largohen nga ajo hapësirë. Në një moment ky grup njerëzish ka hyrë në shtëpinë e Ademit dhe ka detyruar familjen të largohen. Duke u larguar familja atyre u është urdhëruar që të drejtojnë fytyrat kah muri gjersa njëri prej anëtarëve ishte marrur dhe ishte vvarë. Askush nuk kishte qenë dëshmitarë i vrasjes. Familja e kishte njoftur *Nikolicin* si dentist të tyre.

Neni 22 i LP të RFJ përkufizon bashkëpjesmarrjen. Ai thekson se “nëse më shumë persona bashkarisht kryejnë veprën penale me pjesmarrje gjatë aktit të kryerjes apo në një mënyrë tjetër, secili nga ta do të denohet me dënimin e parashikuar për këtë veprë”. Pas leximit të deklaratës gjyqësore, aktgjykimi i shkruar thjeshtë thekson se *Nikolic* ishte

¹ neni 192 (2) i LPP të RFJ “Paraburgu caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përmban: emrin dhe mbiemrin e personit i cili privohet lirie, veprën penale për të cilën ai ngarkohet me faj, bazën ligjore për paraburg, udhëzimin për të drejtën e ankimit, arsyetimin e shkurtër, me kusht që baza për caktimin e paraburgut do të arsyetohet veçanërisht, vulën zyretare dhe nënshkrimin e gjykatësit i cili ka caktuar paraburgun”.

² Neni 30 (2) LPK në ndërlidhje me nenin 22 të LPK.

shpallur fajtor për shkak se “ai ishte në grupin prej 7 personave të organizuar, ata kanë vendosur dhe kanë vepruar bashkarisht” në kryerjen e veprës. Pamarrë parasysh alibinë e paraqitur nga *Nikolic*, kishte dëshmi të mjaftueshme se *Nikolic* ishte i armatosur dhe ishte në grupin e njerëzve prezent në vendin e ngjarjes.

Aktgjykimi i shkruar ka dështuar të shpjegoj në detaje se si ishte implikuar *Nikolic*, përmes pjesmarrjes apo “në një mënyrë tjetër” si bashkpjesmarrës në krim. P.sh. në aktgjykimin e shkruar nuk qëndron se si saktësisht ky grup i armatosur i njerëzve kishte “vendosur bashkarisht” për kryerjen e vrasjes. Gjatë gjyqimit kishte dëshmi për sjellje të organizuara të grupit, në atë se kishte dekalorata nga një numër i fshatarëve që thonin se ky grup i njerëzve të armatosur kishte spastruar fshatin duke detyruar me dhunë familjet që të largohen nga shtëpitë e tyre duke vlarë njerëzit. Kjo mund të konsiderohet si dëshmi për marrëveshjen në mes të pandehurit dhe të tjerëve që të ndjekin kursin e veprimeve ku përfshiheshin vrasjet dhe për këtë arsye kjo ka mundur të bëhet pjesë e aktgjyqimit të shkruar.

(e) Roli i gjykatësve porot

Rastet e monitoruara nga SMSJ, tregojnë se gjykatësit porot nuk shfaqin interesim në procedurë dhe se kanë përgjegjësi nominale në marrjen e vendimeve. SMSJ, ka vërejtur se shpeshherë gjykatësit profesionist nuk i konsultojnë ata gjatë marrjes së vendimeve. Krahas kësaj, në një numër gjykimesh, gjykatësit porot ose arrijnë më vonë apo largohen gjatë procedurës. Në rastin për gjenocid të *Igor Simic*, një gjykatës porot nuk kishte vuar pajisjen për përkthim edhe pse gjykimi mbahej në gjuhën angleze. Më pas ishte konfirmuar se gjykatësi porot nuk e kuptonte gjuhën angleze. Në rastin *Veselin Besovic*, njëri prej gjykatësve porot filloi bisedën me prokurorin publik gjatë fjalimit përfundimtar të mbrojtësit. Gjykimi i *Latif Zymit* për vrasje, ishte mbajtur në gjuhën shqipe. Një gjykatës portot – boshnjak, ka informuar SMSJ-në, se ai fliste pak gjuhën shqipe dhe se nuk mund ta kuptonte procesin gjyqësor i udhëhequr nga gjykatësi ndërkombëtar.

II. Problemet procedurale

(a) Largimi i të bashkakuzuarve nga gjykatorja

Edhe pse e përmendur në raportin e fundit, SMSJ, vazhdon të vërej se kolegjet gjyqëse akoma vazhdojnë të kërkojnë që të bashkakuzuarit të largohen nga gjykatorja gjatë dëshmimit gjyqësor të pandehurit tjetër. Kjo lejohet me LPP të RFJ, mirëpo me një detyrim plotësues për kryetarin e kolegjit që ai të “njoftojë” të pandehurin me dëshminë e të bashkakuzuarit.¹ Në të gjitha rastet e monitoruara nga SMSJ, megjithatë kryetari i kolegjit nuk i ka rrëfyer të pandehurit dëshminë e tillë. Kjo dispozitë në LPP të RFJ cenon të drejtën e të pandehurit “për t’u gjykuar në prani të tij”.²

¹ Neni 319 i LPP të RFJ

² neni 14 (3) (d) i PNDPCP

(b) Mungesa e procesverbalit *verbatim* (fjalë për fjalë)

SMSJ, vazhdon të monitoroj një numër të madh të rasteve në të cilat kryetari i kolegjit më parë lexon *përmbledhjen* e thënieve të dëshmitarëve/të pandehurve në procesverbal në vend të procesverbalit *verbatim* (fjalë për fjalë). Shumica e ligjeve civilo-juridike përfshirë këtu edhe LPP të RFJ parashikojnë *përmbledhjen* e dëshmive.¹ Praktika e tanishme në Kosovë, megjithatë rezulton në *përmbledhje* dhe në përkthime të pasakta të proceverbaleve hetimore dhe atyre gjyqësore. Kjo është posaçërisht brengosëse për rastet ku përfshihen tri gjuhë. Procesverbalet e pasakta lejojnë që procesi gjyqësor të jetë i hapur për manipulime dhe privojnë të pandehurin nga mjetet e rëndësishme për pregaditjen e çfardo ankese.

Në bazë të iniciativës së DD KB, një projekt provues ishte nisur në Gjykatën e Qarkut në Gjilan për përpilimin e procesverbaleve *verbatim* të procesit gjyqësor. Projekti ka të bëjë vetëm për proceset gjyqësore të udhëhequra nga gjykatësi ndërkombëtar dhe ka të bëjë me inqizimin simultan të procesverbalit në kompjuter. Momentalisht nuk ka plane për zgjerimin e këtij projekti në regjionet tjera.

Afrim Xheladini ishte paditur në lidhje me një sulm me granatë në një shitore të një Serbi të Kosovës në Viti. Ushtarët e KFOR-it kanë dëshmuar se ata ishin dëshmitarë se i pandehuri kishte hudhur granatën dhe pastaj kishte ikur me ç'rast ata e kishin arrestuar atë menjëherë. SMSJ, ka shfaqur brengën lidhur me rrethanat e *përmbledhjes* së kryetarit të kolegjit mbi dëshminë, në atë se *përmbledhja* dukej se ishte më pak inkrimuese në krahasim me thëniet e dëshmitarëve të KFOR-it. *Përmbledhja* e dëshmisë së prezentuar nga kryetari i kolegjit nuk ishte përkthyer për dëshmitarët e KFOR-it. Kryetari i kolegjit së bashku me numrin e dëshmitarëve të KFOR-it, thjeshtë kishte lexuar për t'u shënuar në procesverbal që "*dëshmitarët kishin dëshmuar si në procesverbalin e gjykatësit hetues të kësaj gjykate*". Kjo qasje në vërtetimin e fakteve mund të ketë ndikim negativ në fazat e mëvonshme të ankimit, pasi që gjykata e apelacionit (shkallës së dytë) mund të mos dijë nëse dëshmitarët gjatë gjykimit kanë zgjeruar dëshminë e dhënë para gjykatësit hetues. Një dëshmi e tillë gjyqësore mund të jetë e rëndësishme edhe nëse ndryshimet janë të vogla.

Në rastin *Sava Matic*, për krime lufte, gjykatësi ndërkombëtar kishte parafrazuar gabimisht thëniet e dëshmitarëve në procesverbal dhe në një rast kishte dëshmuar në emër të një dëshmitari. Prokurori publik kishte pyetur dëshmitarin pse ai kishte pasur nevojë për leje nga autoritetet Serbe për të dalë jashtë në fushë. Gjykatësi ndërkombëtar ishte përgjigjur se kjo ishte për shkak të "rregullores". Gjykatësi ndërkombëtar pastaj kishte futur në procesverbal "*lidhur me pyetjen tjetër të prokurorit, dëshmitari u përgjigj: kjo kështu për shkak të rregullores*". Prokurori publik më pastaj kishte pyetur dëshmitarin pse fshatarët kishin frikë për të lëshuar shtëpitë e tyre. Gjykatësi ndërkombëtar u përgjigj duke thënë se "*dëshmitari posa u përgjigj që kjo ishte për shkak të rregullores*". Dëshmitari pastaj ndërhyri duke thënë se ata kishin mbetur mbrenda për shkak se ishin tepër të frikësuar prej paramilitarëve. Kjo ishte futur në procesverbal.

¹ neni 222 i LPP të RFJ

Në gjykimin e *Latif Zymit* për vrasje përmbledhja e dëshmive të futura në procesverbal nuk ishte e përkthyer në gjuhën angleze për gjykatësin ndërkombëtar. Në gjykimin e tre të miturve për tentim dhunimi seksual, pa ndonjë vërejtje nga kolegji gjykues, prokurori publik kishte lexuar pjesë të thënieve të pandehurve nga procesverbali dhe pastaj kishte lexuar fjalën e tij prëfundimtare.

(b) Thëniet e lexuara në procesverbal

Vazhdon praktika e bashkangjities së deklaratave në procesverbal pa u lexuar deklaratat apo pa u njoftuar i pandehuri për përmbajtjen e tyre. Kjo gjithashtu përfshinë praktikën e ftuarjes së dëshmitarëve që të *“japin dëshminë e njëjtë ashtu si e kanë dhënë para gjykatësit hetues”*, pa lexuar thëniet në gjykimin e hapur për të pandehurin apo gjykatësit porot. Thënia e dëshmitarit pastaj i bashkangjitet procesverbalit. Këto praktika mund të cenojnë të drejtën e të pandehurit për proces gjyqësor të drejtë dhe publik.

Në Prizren p.sh. në procesin gjyqësor kundër dy të miturve, edhe pse dëshmitari kishte marrë pjesë në seancën e dëgjimit ai ishte pyetur vetëm se a kishte diçka për të shtuar lidhur me dëshminë e dhënë para gjykatësit hetues. Ai ishte përgjigjur jo. Kryetari i kolegjit pastaj kishte diktuar për procesverbal se deklarata e dëshmitarit para gjykatësit hetues ishte lexuar edhe pse nuk ishte lexuar. Një incident i ngjajshëm kishte ndodhur në gjykimin e një të mituri tjetër kur prokurori publik kishte propozuar leximin e deklaratës së dëshmitarëve të cilët nuk kishin qenë të pranishëm në gjykatë. Mbrojtësi kishte kundërshtuar. Kryetari i kolegjit, pa u konsultuar me gjykatësit porot, kishte diktuar për procesverbal se deklarata e dëshmitarit ishte lexuar, edhe pse nuk ishin.

III. E drejta në përfaqësim ligjor efektiv

(a) Ligji i zbatueshëm

Mbrojtësit janë të obliguar të mbrojnë të drejtat e klientëve të tyre. Ata duhet të ndërmarrin veprime të nevojshme për mbrojtjen e klientëve të tyre dhe interesave të tyre, dhe të ndihmojnë klientët e tyre para gjykatës. Obligimi i tyre përfshinë edhe respektimin e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut të pranuar nga ligji vendor dhe ai ndërkombëtar. Në Kosovë, standardet relevante janë të mbrojtura me LPP të FRJ, Rregulloreve të UNMIK-ut dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

(b) Veprimet e mbrojtësit dhe efektiviteti

Mbrojtësit akoma vazhdojnë të reflektojnë rolin e mbrojtësit nga sistemi i kaluar juridik, në atë se shpeshherë ata janë pasiv. Mbrojtësit shpeshherë nuk ndërmarrin hapa për rishqyrtimin (ankimin kundër) e zgjatjes së paraburgimit për klientët e tyre. Në shumë raste nuk ka përpjekje për të hetuar në mënyrë efektive argumentet e akuzës apo mbrojtjes. Duket se kjo rrejedhë si pasojë e shkallës së ulët të pagesës pasi që një numër i konsiderueshëm i mbrojtësve ka informuar SMSJ-në, se mbrojtësit e caktuar sipas detyrës zyrtare kërkojnë të hollat para vazhdimin të punës në rastet e tyre.

(c) Rastet e monitoruara

Prej gjashtëdhjetë e një rasteve të monitoruara, shembujt e joefektivitetit të zbuluar në raportin gjashtëmujor vazhdojnë të jenë prezent në tërë Kosovën. Mbrojtësit vazhdojnë të:

- i. dështojnë në kërkimin e analizave mjeko-ligjore
- ii. dështojnë të hetojnë në mënyrë të duhur, para gjykimit, akuzat dhe argumentet mbrojtëse
- iii. dështojnë të marrin në pyetje në mënyrë të duhur dëshmitarët
- iv. dështojnë të paraqesin dëshmi mbështetëse në seancë; dhe
- v. dështojnë të kundërshtojnë kundër dëshmive të papranueshme.

Prishtinë

Në rastin e *Igor Stanimirovic*, gjatë pushimit në seancën e dëgjimit me 31 tetor 2000, mbrojtësi kishte pyetur klientin e tij që t'ia përkujtoj faktet lidhur me rastin dhe aktakuzën. Në rastin *Sekulic*, mbrojtësi e ka vizituar klientin e tij katër herë për një vit, me një takim, dhe sipas të pandehurit që ka zgjatur vetëm tre minuta. Në rastin *Milosevic*, mbrojtësi ka kërkuar pagesë edhe pse ai ishte emëruar nga gjykata.

Në rastin *Zeqiri*, në gjykimin për tentim dhunimi seksual, prokurori publik e gjithashtu edhe mbrojtësi kanë lëshuar gjykatoren edhe pse në kohëra të ndryshme. Mbrojtësi kishte lëshuar gjykimin gjatë deklaratës së pandehurit. Kolegji gjykues nuk kishte ndërprerë procesin gjyqësor gjatë këtyre incidenteve.

Në rastin *Besart Muriqi*, i pandehuri ishte paditur për veprime të jo natyrshme seksuale me fëmijun pesë vjeçar. Në seancë, i pandehuri nuk kishte pranuar veprën edhe pse këtë e kishte pranuar në polici. Edhe pse kishte pasur prova mjekësore për viktimën, nuk ishte kërkuar ndonjë raport psikiatrik për të pandehurin. Gjatë gjykimit, mbrojtësi kishte heshtur. Në fjalimin e tij përfundimtar, mbrojtësi kishte kërkuar përjashtimin e përgjegjësisë penale pa thënë diçka tjetër.

Florim Domaqi, i sëmurë psiçikisht, ishte burgosur me 6 shtator 1999, dhe u gjykua me 3 nëntor 2000, lidhur me ndezjen e pasurisë së xhaxhait të tij. Pasi që mbrojtësi i emëruar nga gjykata mungonte, kryetari i kolegjit kishte pyetur personelin e gjykatës të gjejnë një avokat tjetër me zyre afër gjykatës. Gjykata kishte pritur deri sa kjo u realizua. Mbrojtësi tjetër arriti dhe procesi gjyqësor filloi. Mbrojtësi i posaçemruar nuk kishte lexuar lëndën dhe nuk dinte asgjë lidhur me rastin. Deklarata e të pandehurit nuk ishte fare koherente. Raporti psikiatrik kishte përshkruar të pandehurin si shizofrenik dhe kishte halucinacione. Gjatë procesit gjyqësor mbrojtësi i mëhershëm i emruar nga gjykata kishte arritur por ishte laraguar prap pasi ishte thënë nuk kishte nevojë më për shërbime të tija.

Prizren

Gjykatësi ndërkombëtar kishte informuar SMSJ-në, se prokurorët publik marrin pjesë rregullisht në marrjen e vendimeve. Në gjykimin e *Halit Guri*, për vrasje, kolegji gjykues ishte tërhjekur për të marrë vendimin nëse gjenë zbatim *Rregullorja 2000/17*. Disa minuta më vonë prokurori publik ishte larguar nga gjykatorja duke u kthyer pas 45 minutave së bashku me kolegjin. SMSJ, vlerëson këtë se ka mundur të jetë koincidence, por megjithatë kjo i jepë një dukje të papërshtatshme.

Në rastin *Sava Matic*, prokurori publik kishte kërkuar leximin e dy deklaratave në procesverbal, njëra prej të cilave implikonte të pandehurin për vjedhje dhe “malltretim” të popullatës vendore. Edhe pse këta dëshmitarë kishin dhënë deklaratën para gjykatësit hetues, as i pandehuri e as mbrojtësi i tij nuk kishin qenë prezent. Pamarrë parasysh faktin se mbrojtja nuk ishte e paralajmëruar për dëshmitë e tyre e as për mundësinë e pyetjes së tyre në procesin gjyqësor, ata nuk kishin kundërshtuar pranimin e këtyre deklaratimeve prejudikuese.

Në rastin *Sojan Jovanovic dhe Bogoljub Misic*, të përmendur më heret, mbrojtësi nuk kishte ndërmarrë asgjë në kundërshtimin e ligjshmërisë së burgosjes së tyre deri më vonë pas një jave.

Gjatë dëgjimit të X dh Y, gjerësa dëshmitarët ishin duke marrë në pyetje, mbrojtësi ishte larguar duke thënë se “kishte një gjykim tjetër”. Në gjykimin e *Refki Bytyqi*, gjatë procesit gjyqësor kishte përdorur telefonin mobil katër herë. Kryetari i kolegjit nuk kishte paraqitur asnjë vërejtje lidhur me këtë.

Pejë

Në rastin *Viktor Prepepaj*, i paditur për tentim rrëmbimi dhe për vepra tjera të rënda penale, i pandehuri i cili ishte i paraburgosur, nuk kishte mundur të sigurojë avokat. I pandehuri më heret kishte bërë të ditur gjykatës se ai do të angazhojë avokat. Gjatë gjykimit gjykata kishte caktuar mbrojtësin sipas detyrës zyrtare dhe pas një shtyerje të shkurtër filloi procesi gjyqësor. I pandehuri u ankua se ishte takuar me mbrojtësin e ri vetëm pesë minuta. Gjykata kishte marrë qëndrim se mbrojtësi kishte lexuar lëndën dhe se ai ishte i pregaditur për të vazhduar. Gjatë procesit gjyqësor mbrojtësi në mënyrë të përsëritur ishte përgjigjur në telefonin e tij mobil.

Gjilan

Gjatë dëgjimit në procedurën hetimore, të pjestarëve të supozuar të UÇPMB-së kinse për posedim të armëve, numri i plotë prej trembëdhjetë të pandehurve është sjell para gjykatës. Tre mbrojtës ishin emëruar për përfaqësimin e tyre. Asnjëri prej këtyre mbrojtësve nuk kishte biseduar me klientët e tyre para dëgjimit në procedurën hetimore. Gjatë marrjes në pyetje të pandehurve, mbrojtësi në mënyrë të përsëritur largohej nga gjykatorja duke u kthyer pas 10-15 minutash.

IV. Trajnimi (stërvitja)

OSBE, ka themeluar Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) për zhvillimin dhe mundësimin e stërvitjes për gjykatës, prokurorë publik dhe personelin tjetër relevant ligjor. Seminare stërvitëse janë organizuar për gjykatësit dhe prokurorët publik në nëntor 1999.¹ Në maj të vitit 2000, janë stërvitur praktikantët në një seminar të organizuar nga Këshilli e Evropës/OSBE, lidhur me nenet 5&6 të KEDNj. Stërvitje të ngjashme janë organizuar edhe në shtator 2000, ndërsa stërvitje informative për gjykatës dhe prokurorë të rinjë janë organizuar në nëntor të v. 2000. Këta seminarët e fundit kanë shfrytëzuar modelin e punës në grupe punuese dhe kanë pasur më tepër formë interaktive. Në mars të v. 2001, IGJK, ka organizuar stërvitje mbi LPP të FRJ-së, për të gjithë judikaturën vendore dhe atë ndërkombëtare. SMSJ, përshëndetë në veçanti programet stërvitëse për gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë.²

Sa i përket odës së avokatëve, në shtator 2000, OSBE-ja në bashkëpunim me ABA CEEL-in dhe Këshillin e Evropës, kishte organizuar një seminar pilot-projekt për mbrojtës i quajtur *“Përfaqësimi efektiv i mbrojtësve penal në gjykatat e Kosovës”*. Ky projekt ishte zgjeruar edhe në Pejë dhe Prizren ndërsa në muajt e ardhshëm do të mbahet edhe në Gjilan dhe Mitrovicë.

Spektori i OSBE-së për Përkrahjen e Komunitetit Ligjor gjithashtu ka përpiluar një *“Doracak të procedurës penale për mbrojtësit e Kosovës”*, i përshkruar si një mjet këshillimor për gjykimet. Në të kombinohen ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare dhe është i shoqëruar me komente të shkurta të mendimtarëve juridik të Evropës.

Përkundër këtyre angazhimeve, ekziston nevoja e vazhdueshme për stërvitje intenzive. Megjithatë, stërvitjet me këtë qasje momentale nuk janë aq të efekshme. Duke pasur parasysh problemet e potencuara në këtë raport, kjo qasje duhet ri-strukturuar. Një konsideratë duhet t’i shtrohet qasjes *“kthim në baza”*, që përfshinë stërvitjen lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe arsyetimin ligjor, përfshirë këtu edhe vlerësimin (peshimin) e provave. Stërvitja gjithashtu do të duhej të ishte obligative. SMSJ, do të rekomandoj edhe shfrytëzimin e gjykimeve hipotetike.

¹ seminarët dhe puntoritë për gjykatës dhe prokurorë të posa emruar janë organizuar në mars, korrik dhe gusht 2000. Të gjithë pjesëmarrësit janë furnizuar me tekstet elementare të KEDNj dhe materiale të rasteve ligjore (tekste të Konventës, Udhëzime të Konventës, Përmbledhje të rasteve dhe Ekstrakte kryesore, të gjitha në gjuhën shqipe).

² Në rastin *Hysen Qerimaj* kryetari i kolegjit, një ndërkombëtarë, para marrjes në pyetje të dëshmitarit, kishte deklaruar se në vendin e tij dëshmitari ka të drejtë të heshtë por se për këtë nuk ka ditur se si është procedura në Kosovë.

PJESA 5: GJYKATAT

II. ADMINISTRIMI I DREJTËSISË

Hyrje

Kjo pjesë diskuton shqetësimet lidhur me administrimin e drejtësisë nëpër gjykata dhe në veçanti, përqëndrohet në faktin se gjykatat nuk janë pajisur me mjete me të cilat do të administrojn derjtësinë në mënyrë efektive dhe korrekte. Mungesa e kapaciteteve mjekoligjore, ka penguar mundësitë për gjykatat që të hulumtojnë rastet në mënyrë gjithpërfshirëse. Më tutje, sistemi i shërbimit të thirrjes së dëshmitarëve ka rezultuar në mos paraqitjen e dëshmitarëve në gjykim, në fazën e hetimeve dhe në fazën e procesit gjyqësor. Duhet shtuar se ekzistojnë shqetësimet se gjykatësit dhe prokurorët janë objekt i frikësimeve (kanosjeve).

Ekziston një vakum në sigurimin e përgjegjësisë për akterët gjyqësor në rast të sjelljeve të tyre joprofesionale, deri më sot, nuk është shqiptuar asnjë sanksion në këtë drejtim. Që nga raporti i kaluar, megjithatë, Njësi Inspektues Gjyqësor i KB është themeluar dhe momentalisht është duke hetuar pohimet e shpërdorimit gjyqësor.

I. Mjetet hetimore, Kapacitetet mjeko-ligjore dhe Thirrja e dëshmitarëve

(a) Hetimet policore, mbledhja dhe vlerësimi i provave (dëshmive)

Njëra prej pengesave më të mëdha në ndjekjen efektive të krimeve ka qenë cilësia e hetimeve të bëra nga policia. Puna policore bazohet në shkathtësitë e hetuesve policor dhe në ekzistencën dhe cilësinë e vlerësimit (analizës) shkencore të provave (dëshmive). Policia e UNMIK-ut, akoma duhet të zhvilloj një metodë të sofistikuar dhe moderne të hetimeve dhe mbledhjes së provave (dëshmive), metodë e cila do të përfshinte mundësitë e mbikqyrjes policore dhe shfrytëzimi i informatorëve dhe agentëve sekret të policisë.

Hetimet efektive policore dhe procedurat gjyqësore të cilat ndjellin besimin në sistemin gjyqësor mështeten në masë të madhe në mbledhjen dhe vlerësimin e provave materiale. Në këtë moment, nuk ka kapacitet për këto çështje ndërsa gjykatësit hetues janë duke bërë shumë pak, ndoshta fare, në rolin e tyre të hetimeve paraprake të rasteve.¹ Deri më sot, nuk ka njësit të “vendit të ngjarjes” i cili në mënyrë sistematike do të mbledhë provat mjeko-ligjore dhe provat tjera materiale. Për shkak të kufizimeve financiare dhe logjistike, ekziston një ngurrim bile edhe refuzim nga ana e ekspertëve mjeko-ligjor të Kosovës për dhënjen e shërbimeve, siç janë pjesmarrja në vendin e ngjarjes së kriminit dhe dhënja e dëshmisë në procesin gjyqësor. Kjo ka penguar funksionimin e gjykatave.

Njëri prej stacioneve regjionale të policisë së UNMIK-ut ka njoftuar SMSJ-në, lidhur me problemet sa i përket mbledhjes së provave mjeko-ligjore dhe provave tjera. Shpeshherë

¹ SMSJ, është informuar se një laborator i kriminalistikës nën ombrellën e policisë së UNMIK-ut, në fund të këtij viti do të filloj punën.

nuk ka përgjigje nga Bullgaria lidhur me dëshmitë mjeko-ligjore të dërguara atje për analizë. Kjo është konfirmuar edhe në shumicën e proceseve gjyqësore të monitoruara nga SMSJ. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, policia shumë rrallë merr mostrat e gjakut dhe të frymës. Ata nuk posedojnë më komplete barnash për terren. Edhe pse pajisjet daktiloskopike (për marrjen e gjurmëve të gishtërinjëve) janë të pranishme, ngjyra përkatëse është në mungesë. Në këtë stacion policor, ata kanë dy kamera (foto-kamera), megjithatë njëra është e prishur dhe ata nuk janë pajisur me film dhe me bateri të litiumit.

(b) Rastet

Besim Hasani ishte burgosur me 13 Tetor 1999 dhe ishte paditur me 3 Mars 2000, për vrasjen e një Serbeje të moshuar të Kosovës. Dita e parë e gjyqimit ishte me 13 Dhjetor 2000 në gjykatën e qarkut në Mitrovicë. Gjykimi ishte shtyer për shkak të analizave mjeko-ligjore të cilat akoma nuk ishin kompletuar lidhur me provën kryesore të gjakut dhe për shkak se mbrojtja kishte pasur vërejtje në përfaqësuesin e palës së dëmtuar. Analiza mjeko-ligjore ishte e domosdoshme pasi që ishte gjetur gjak në automjetin e të pandehurit pas arrestimit të tij. Pas shtyerjes së gjyqimit, doli se mjeku i cili kishte kryer autopsinë në Tetor të vitit 1999, nuk kishte ruajtur mostrat e gjakut të viktimës. Deri sa ishte marrur në pyetje nga policia në mungesë të mbrojtësit, i pandehuri kishte pranuar vrasjen. Ai gjithashtu në prezencë të mbrojtësit para gjykatësit hetues kishte pranuar. Gjatë gjyqimit, ai kishte pohuar se pranimi ishte bërë nën shtrëngim dhe se dikush tjetër kishte vrarë viktimën.

Në gjykatën e qarkut në Gjilan, *Shaban Beqiri* dhe *Xhemal Sejdu*, ishin gjykuar për vrasjen e dy Serbëve të Kosovës. Pas vrasjes, dy dëshmitarë okular kishin informuar KFOR-in se *Beqiri* dhe *Sejdiu* ishin fajtor. Ata gjithashtu kishin përshkruar rrobat dhe një letër të dërguar më heret nga *Beqiri* në të cilën shkruante “*ultimatum... UÇK-ja ua tërhjek vërejtjen [t'i] dorëzoni armët në ora 20.00... [përndryshe] do të përdoret dhuna kundër jush*”. Në bazë të raportit të KFOR-it, tetë deri në dhjetë orë më vonë, KFOR-i kishte burgosur *Beqirin*. Ai kishte të veshura rroba të ngjajshme me ato të përshkurara nga dëshmitarët okular, përfshirë aty edhe një fanellë të verdhë apo ngjyrë të arit. *Beqiri* kishte pranuar se ai kishte qenë në UÇK.

Në lëndën gjyqësore, gjindej raporti i KFOR-it në gjuhën angleze ku përmendeshin rrobat. Gjatë gjyqimit prokurori publik nuk ishte referuar rrobave e as letrës. Kolegji, (përfshirë aty edhe gjykatësin ndërkombëtarë) nuk kishin parashtruar asnjë pyetje lidhur me rrobat apo letrën.

Në rastin *Momcilo Trajkovic*, i pandehuri ishte akuzuar që kishte qëlluar me armë të zjarrit dy burra Shqipëtarë të Kosovës, në Kamenicë. I pandehuri kishte refuzuar çdo përfshirje të tij në atë rast. Një ditë pas incidentit të pohuar, KFOR-i kishte zbuluar gëzhoja të plumbave në vendin e ngjarjes. Më shumë se dy muaj më vonë KFOR-i kishte arrestuar të pandehurin dhe kishte zbuluar armë dhe municion në shtëpinë e tij. KFOR-i kishte informuar gjykatën se ata nuk janë në posedim të gjërave të zbuluara dhe për atë

nuk mund të bëhet ndonjë analizë mjeko-ligjore. Është praktikë e zakonshme për KFOR-in Amerikan që të shkatrojnë armatimin dhe municionin të cilin ata e zbulojnë.

Në rastin *Myrtez Starabanja*, i pandehuri ishte paditur për vrasje. Viktima ishte vvarë në shtëpinë e tij gjersa dikush qëndronte jashtë shtëpisë. I pandehuri kishte refuzuar çdo përfshirje në këtë rast. Në mes të palëve kishte pasur konflikt lidhur me pasurinë. Gëzhojat e plumbave ishin gjetur afër vendit të ngjarjes por nuk ishte gjetur asnjë armë. I pandehuri ishte arrestuar pas një kohe të shkurtër. Pas gati *një muaji* më vonë, është bërë dorëza e parafinës në duart e të pandehurit në mënyrë që të detektohet prania e barutit. Sipas ekspertit policor i cili kishte dëshmuar në gjykim, testi i bërë nuk kishte ndonjë vlerë pasi që dorëza e parafinës duhet të merret brenda *tri orësh* pas zbrazjes së armës.

Muhamet Kqiku ishte paditur në lidhje me dy sulme me granatë në pronën e një Serbi të Kosovës. Në incidentin e parë, policia e UNMIK-ut kishte nxjerrur (inqizuar)gjurmën e këmbës. Pas incidentit të dytë, i pandehur ishte arrestuar afër vendit të ngjarjes. Sipas policisë së UNMIK-ut, gjurma e këmbës përputhej me këpucën e të pandehurit. Ky raport, i cili gjindej në lëndën gjyqësore, si duket nuk ishte përkthyer. Kjo provë nuk ishte prezentuar nga prokurori publik gjatë gjyqimit.

Veselin Besovic, një Serb i Kosovës, ishte denuar për plaçkitje dhe për posedim të armës përfshirë këtu edhe posedim të mjeteve shpërthyesë. Para këtij gjykimi në media flitej shumë për të se ishte kriminel lufte. Hetimi i bërë nga policia e UNMIK-ut nuk kishte zbuluar dëshmi për këtë. Rasti kundër *Besovic* sillej rreth një konteksti mbi pohimet lidhur me prerjen ilegale të drunjëve. Viktima kishte pohuar se gjersa ishin duke prerë drunjë në tokën e cila ishte e ngjitur me tokën e të pandehurit, *Besovic* dhe një njeri tjetër kishin ardhur të armatosur me armë dhe me një granatë dore. Sipas këtyre dëshmitarëve, i pandehuri i kishte urdhëruar ata që të hypnin në traktor dhe i kishte detyruar me forcë që ta përcjellin. Me një rast ata kishin ikur por i pandehuri i kishte gjuajtur në drejtim të tyre me pushkë automatike. Më pas i pandehuri kishte vjedhur traktorët e tyre, rimorkiot dhe motorin për prerje të drunjëve.

I pandehuri kishte pohuar se ai kishte nxënë dy njerëz duke prerë drunjë në tokën e tij, dhe se kishte tentuar që t'i dorëzojë ata në KFOR, kur ata kishin ikur. Ai kishte refuzuar të pranoj se kishte qenë në posedim të armës së zjarrit. Ai kishte pohuar se njërin prej traktorëve e kishte pruar në punktun kontrollues të KFOR-it në fshatin e afërt, ndërsa rimorkiot dhe traktori tjetër kishin mbetur në vendin e incidentit. Traktori dhe të dy rimorkiot ishin zbuluar nga policia e UNMIK-ut dhe u ishin kthyer pronarëve të vet. Të dyja palët kishin pohuar se kishin kontaktuar policinë e UNMIK-ut. Policia e UNMIK-ut kishte kundërshtuar se *Besovic* i kishte kontaktuar ata. I pandehuri gjithashtu kishte pohuar se kishte kontaktuar KFOR-in për paraqitjen e rastit. Gjykata nuk kishte siguruar asnjë dëshmitarë nga ana e policisë së UNMIK-ut e as nga KFOR-i, e as që ka ndërmarrë hapa për të verifikuar nëse i pandehuri kishte marrë në fshat traktorin dhe dy rimorkiot. Asnjë dëshmitarë nuk kishte deklaruar nëse ishte gjetur ndonjë pushkë apo granatë e dorës në objektet e *Besovic*. Kërkesa e mbrojtësit për inspektimin e vendit të incidentit ishte refuzuar.

Në rastin *Bahtije Beqiri*, në gjykimin e saj për vrasjen e bashkëshortit të vet, kryetari i kolegjit kishte futur në procesverbal raportin ballistik nga Bullgaria. Nuk ishte pranuar vërejtja e mbrojtësit lidhur me parregullësitë e këtij raporti. Meqenëse nuk kishte mundësi për mbrojtësin për të siguruar ndonjë analizë alternative, nuk kishte mundësi as të kundërshtimit të provave kryesore. Mbrojtësi kishte informuar SMSJ, se ai do të kishte preferuar ekspertin e vet, duke shtuar se nuk ka ndonjë objekt (institut) të mjekësisë ligjore në Kosovës.

(c) Dëshmitë në rastet e dhunës seksuale

Rastet e dhunës seksuale sjellin vështirësi të posaçme për gjykatat, pjesërisht për shkak se zakonisht nuk ka dëshmitarë tjerë të ngjarjes pos të pandehurit dhe viktimës dhe për shkak se këto raste lidhen me çështjet e kulturës dhe zakoneve. Si rezultat i kësaj, komponentë kryesore për konstatimin e së vërtetës materiale është ekzistimi i provës materiale mjeko-ligjore dhe, njëkohësisht cilësore. Momentalisht nuk ka ndonjë objekt të dedikuar për ekzaminimin e viktimave të dhunës seksuale, ndërsa aranzhimet e tanishme mund të karakterizohen si degraduese. Krahas kësaj, raportet e tanishme mjekësore në lidhje me dhunën familjare janë jashtëzakonisht të shkurta dhe ju mungojnë detalet. Shumë rrallë thirret në gjykim ndonjë ekspert për të elaboruar konstatimet dhe rëndësinë e tyre. Në disa raste nuk ka pasur fare raporte mjekësore.

Në rastin e caktuar për gjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, katër të pandehur janë paditur secili për dhunimin e një viktime. Viktima supozohet se është kanosur me armë në automjet nga njëri prej të pandehurve i cili pastaj e kishte marrë me vete në një kafeteri, dhe kishte thirrur edhe tre të pandehurit tjerë. Pastaj në shtëpinë e dy të pandehurve, viktima ishte dhunuar me radhë seksualisht nga të katër të pandehurit. Viktima ishte lejuar të largohet në ora 3:00 pas mesnatës. Ditën tjetër, viktima e kishte paraqitur incidentin në polici. Të pandehurit nuk kishin kundërshtuar marrëdhënjen seksuale me viktimën dhe kishin pranuar se kishin qenë të dehur por kishin pohuar se atyre u kujtohet se viktima ishte pajtuar. Në ditën tjetër pas incidentit, oficeri i policisë së UNMIK-ut kishte përpiluar raportin, “Ekzaminimi vizuel i viktimës”. Në raport thuhej, “viktima kishte zhveshur rrobat dhe (oficeri) ka kërkuar shenja të dukshme në trupin e saj. Pas ekzaminimit vizuel të viktimës, nuk është vërejtur asnjë shenjë”. Përpos këtij “ekzaminimi”, nuk është bërë ndonjë raport tjetër mjekësor në viktimën. Përkundër natyrës kryesore të një dëshmie mjekësore për raste të tilla, gjykatësi hetues asnjëherë nuk ka urdhëruar ekzaminim mjekësor.

Shumë prej rasteve të delikteve seksuale paraqiten një kohë pas incidentit të pohuar duke rritur vështirësitë e rasteve të kësaj natyre për zbulimin e gjendjes faktike. Në raste të tilla, provat mjekësore dhe mjeko-ligjore kanë përdorim të kufizuar gjë që u lejon gjykatësve të bazojnë vendimet e tyre vetëm në vlerësime të besueshmërisë. Për të sqaruar rrethanat dhe për të vlerësuar besueshmërinë e palëve, ekziston nevoja e posaçme për dëgjimin e të gjithë dëshmitarëve të cilët mund të kenë deklarata relevante. SMSJ, ka monitoruar shumë raste kur dëshmitarët potencialisht relevant nuk ishin dëgjuar nga gjykata. P.sh. në njërin prej rasteve viktima ka pohuar se i pandehuri e ka marrë atë në një hotel-restaurant, duke e kanosur atë me armë dhe e ka dhunuar seksualisht. Viktima

kishte deklaruar se e kishte detyruar me forcë të ngjitej shkallëve dhe e kishte futur në dhomë. Në raportin policor, udhëheqësi i hotel-restaurantit kishte deklaruar se qifiti në njëfarë mënyre ishte fjalosur në mes vete. Ky dëshmitar nuk është thirrur për të dëshmuar në gjykim. Krahas kësaj, viktima kishte raportuar se pas incidentit ajo ishte me miq dhe i pandehuri kishte ardhur dhe e kishte detyruar me forcë të hyj në automjet. Ky incident nuk është përcjellur nga gjykata. Për më tepër, nuk janë bërë përpjekje për të konfirmuar nëse i pandehuri kishte qenë në posedim të armës.

Në rastin e gjykimit të *Hasim Demirit* për dhunim seksual, i pandehuri kishte pohuar se kishte pasur një lidhje seksuale të pajtueshme me viktimën, me ç'rast ndërli dhej një motel lokal. Viktima kishte kundërshtuar dhe pohuar se ajo kishte qenë e virgjër para dhunimit seksual. Kryetari i kolegjit kishte bërë kërkesë me shkrim drejtuar motelit me ç'rast kishte kërkuar konfirmimin e motelit se dy personat kishin qëndruar aty. Moteli ishte përgjigjur se qifiti me të vërtetë kishte qëndruar aty një natë dhe se ky fakt ishte shënuar në regjistrin e motelit. Një kopje e këtij regjistri ishte prezentuar gjykatës. Viktima në mënyrë të fuqishme kishte kundërshtuar këtë dokument duke deklaruar se në të nuk qëndron nënshkrimi. Edhe pse i pandehuri më heret kishte dëshmuar se shokët e tij punonin në atë motel, gjykata dhe prokurori publik pranuan këtë dokument kyq, pa ndonjë hulumtim të mëtutjeshëm. Prokurori publik ishte tërënjekur nga aktakuza dhe i pandehuri ishte liruar.

(d) Thirrja e dëshmitarëve

Një numër i konsiderueshëm i gjykimeve në gjykatat e qarkut është shtyer apo hetimet gjyqësore janë penguar për shkak të thirrjes së dëshmitarëve e cila ose është realizuar dobët apo nuk është realizuar fare. Mungesa e udhëzimeve të qarta për procedurën e thirrjes së dëshmitarëve apo ko-ordinimin e dobët në mes gjykatave dhe policisë shumë shpesh ka rezultuar në pamundësinë e realizimit të thirrjes apo realizimin e thirrjes në adresë të gabuar. Ky është një problem i shprehur dhe paraqitet në shumë raste. Në rastet ku përfshihen Serbët e Kosovës, ekzistojnë probleme të konsiderueshme logjistike në lajmërimin e dëshmitarëve, sepse shumica janë larguar nga kompetenca territoriale ndërsa ata të cilët gjinden refuzojnë të marrin pjesë në gjykatë pa garancione të sigurisë së tyre. Në disa raste gjykatat kanë kërkuar edhe nga SMSJ, për dorëzimin e thirrjeve.

Në rastin *Trajkovic*, për krime lufte, dëshmitarët e mbrojtjes të cilët jetojnë në Serbi kishin refuzuar të marrin pjesë në gjykimin në Gjilan për shkak se gjykata nuk kishte mundur të garantojë se ata nuk do të arrestoheshin. Kryetari i kolegjit (ndërkombëtar) kishte votuar për mundësinë e marrjes së deklaratave të tyre në një kompetencë tjetër territoriale (Vranjë), gjë që lejohet me LPP të RFJ.¹ Për shkak se prokurori publik nuk kishte pranuar udhëtimin për në Serbi, kjo ide ishte hudhur por, kishte rezultuar në shtyerje tjera të gjykimit.

Mihrije Gashi, ishte brugosur me 5 Tetor 1999, dhe ishte paditur për vrasje një muaj më vonë. Në mes të 5 Majit 2000 dhe 18 Shtatorit 2000, në tri raste ishte shtyer gjykimi për shkak se dëshmitarët dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar nuk kishin marrë pjesë.

¹ Neni 330 (1) LPP i RFJ

Në rastin *F.H.* i pandehuri ishte paditur në lidhje me dhunimin seksual të njëres vajzë dhe për tentim dhunimi të vajzës tjetër dhe për vrasjen e dy foshnjeve të lindura si rezultat i dhunimit seksual. Vetëm njëra prej vajzave të tij është gjetur dhe ishte e gatshme të dëshmoj. Thirrja e parë i është dorëzuar në adresën e saj të punës, e cila ishte një organizatë jo-qeveritare e quajtur ADRA. Sipas lëndës gjyqësore, thirrja nuk është dorëzuar, por ajo ishte kontaktuar me telefon. Me 31 Mars 2000, thirrja ishte dorëzuar në adresën e punës së saj re, në Zyren e SHBA-ve në Prishtinë. Ajo kishte marrë pjesë në dëgjimin hetimor dhe kishte dëshmuar. Viktima e pohuar kishte dhënë edhe një deklaratë me 14 Prill 2000.

Seanca e parë e gjykimit kishte filluar me 26 Qershor 2000. Thirrja për dëshmitarin ishte dorëzuar në ADRA. Ajo kishte dështuar të merr pjesë. I pandehuri dhe dëshmitari i mbrojtjes kishin dëshmuar. Thirrja për seancën e dytë ishte dërguar në ADRA me 16 Korrik 2000, duke njoftuar dëshmitarin se seanca e ardhshme do të mbahet me 24 Korrik 2000. Viktima kishte ardhur në gjykatë por vetëm sa të zbulojë se do të bëhet edhe një shtyerje tjetër pasi që kryetari i kolegjit dhe i pandehuri mungonin. Kryetari i kolegjit më vonë kishte informuar SMSJ, se ai ishte informuar se dëshmitari nuk është gjetur andaj ka shkuar në një dasmë. Mbrojtësi kishte ardhur, dhe në një moment ai i ishte afruar viktimës jashtë gjykatores. Ajo kishte informuar viktimën se zgjatja e paraburgimit për të pandehurin do të dëmtonte shëndetin e tij, se familja ishte e shqetësuar lidhur me pohimet e viktimës dhe se vëllau i saj kishte deklaruar se babai ishte i pafajshëm. Seanca e tretë gjyqësore ishte caktuar për 8 dhjetor 2000. Me 29 nëntor 2000, thirrja ishte dorëzuar në adresën e të pandehurit në Lipjan. Viktima nuk kishte marrë pjesë në gjykim. Seanca ishte shtyer deri me 19 dhjetor 2000 dhe thirrja ishte dorëzuar në ADRA. Me 19 dhjetor 2000, policia kishte informuar gjykatën se dëshmitari nuk kishte gjetur në ADRA dhe kishin *“kërkuar më shumë të dhëna”*. Në këtë datë, prokurori i ri publik kishte marrë përsipër lëndën. I pandehuri dhe dëshmitari i mbrojtjes kishin dëshmuar për të dytën herë, siç duket për shkak të vonesës së lëndës. Prokurori publik ishte tërhequr nga aktakuza. Në aktgjykimin e shkruar, e vetmja referencë lidhur me vend ndodhjen e dëshmitarit ishte pohimi i familjes se vajza e tyre ishte në *“Prishtinë duke punuar për ...ADRA.”*

Me 17 Prill 2000, një shkëmbim zjarri në mes të Prishtinës, kishte rezultuar në vdekjen e një Komandanti të mirënjohur të TMK-së dhe në plagosjen vdekjeprurëse të një njeriu tjetër, H.M. Incidenti supozohet të ishte si rezultat i një konflikt pronësor në mes të H.M. dhe Komandantit të TMK-së.

Me 22 Maj 2000, i pandehuri B ishte thirrur në gjykim dhe kishte marrë pjesë në dëgjimin e parë hetimor. Krahas katër dëshmitarëve kryesor të përfshirë në konflikt para shkëmbimit të zjarrit, policia kishte intervistuar së paku njëzet dëshmitarë të tjerë me deklaratata potencialisht relevante. Gjykatës i'u ishin dhënë vetëm disa detaje për dëshmitarët. Pastaj doli në pah se policia e UNMIK-ut kishte dështuar të sigurojë për gjykatësin hetues, emrat e të gjithë dëshmitarëve relevant. Ky gabim ishte përmirësuar në Korrik 2000. Në tetor 2000, gjyqi kishte dëgjuar dy dëshmitarë tjerë. Me 7 Nëntor 2000, policia e UNMIK-ut kishte shkruar një memorandum gjykatës duke nënvizuar informatat

kontaktuese të cilat i kishin siguruar duke përfshirë edhe numrat e telefonit të dëshmitarëve. Me 11 nëntor 2000, katër nga tetë dëshmitarët kishin dëshmuar.

II. Frikësimi i Gjyqësisë

Pejë

Bajrush Berisha, ish anëtar i UÇK-së, ishte liruar për vrasje por ishte dënuar për plaçkitje dhe i'u ishte shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 vjetëve. Gjykimi ishte mbajtur në Nëntor 2000 dhe ishte shumë i tensionuar. Në muajt para gjykimit, mbrojtësi kishte informuar SMSJ, se i pandehuri kishte kërcënuar kryetarin e gjykatës së qarkut dhe gjykatësit tjerë. Gjithashtu edhe viktimat ishin sulmuar dhe ishin larguar në Mal të Zi për t'u strehuar. Si rezultat i kësaj gjykimi ishte shtyer deri në caktimin e gjykatësit ndërkombëtarë në kolegji.

Gjykimi u mbajt me masa sigurie të shtuara, dhe udhëhiqej nga kryetari ndërkombëtar i kolegjit. Vendi i mbajtjes së gjykimit në ditën e dytë ishte bartur në selinë e Policisë Regionale të UNMIK-ut për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve të prokurorit publik. Njëri prej dëshmitarëve i cili kishte implikuar të pandehurin, pas dhënjes së dëshmisë ishte rrahur keq. Ai kishte refuzuar të identifikoj sulmuesin.

Ashtu si u përmend më heret në këtë raport, kolegji gjykues kishte lejuar që mbrojtja të prezentoj peticionin e fshatit të viktimës, në të cilin thuhej se familja e viktimës kishte bashkëpunuar me forcat Serbe në v.1998 dhe 1999.

Në gjykim, dy dëshmitarë kishin dëshmuar se e kishin parë të pandehurin duke shtënë dhe vrarë viktimën. Një dëshmitarë tjetër me dëgjimin e të shtënave, kishte arritur në vendin e ngjarjes dhe kishte parë një automjet që largohej nga rajoni. Dëshmitarët tjerë kishin deklaruar se me arritjen në vendin e ngjarjes, ata ishin informuar nga dëshmitarët okular se i pandehuri kishte kryer krimin.

Aktgjykimi i shkruar nuk i referohet peticionit të prezentuar nga i pandehuri. E dyta, i referohet thënieve të ndryshme kontradiktore të dëshmisë të cilat kishin ndikuar në shqiptimin e lirit. Dëshmitari Bashkim, i moshës 13 vjeqare, kishte pohuar gjatë gjykimit se motra e tij, Lulja, e moshës 19 vjeqare, kishte qenë dëshmitare e të shtënave së bashku me të. Motra e tij kishte dhënë të njëjtën dëshmi. Sipas aktgjykimit të shkruar, Bashkimi kishte deklaruar para gjykatësit hetues se vetëm ai kishte qenë dëshmitarë i të shtënave në viktimën dhe se motra e tij dhe të tjerët kishin arritur pas një kohe të shkurtër. Në deklaratën para gjykatësit hetues, Bashkimi kishte deklaruar: *“unë isha i vetmi i cili isha duke shikuar ngjarjen kritike...nëna dhe motrat kanë ardhur pas ngjarjes”*. Por më pas deklaroi: *“momentin e vrasjes...është e mundur që (Lulja) ka mundur ta shoh prej asaj distance”*. Përmbajtja e aktgjykimit të shkruar indikon se këto thënie kontradiktore ishin të rëndësishme për kolegjin gjykues, megjithatë kolegji nuk kishte marrë në pyetje dëshmitarin lidhur me këto thënie kontradiktore.

Aktgjykimi i shkruar gjithashtu i referohet faktit se në gjykim Lulja kishte deklaruar se i pandehuri kishte *“zbrazur dy karikatorë të plumbave”*. Sipas vëllaut të saj dhe policit të UNMIK-ut i cili kishte arritur në vendin e ngjarjes, ishin gjetur vetëm nëntë gëzhoja të plumbave. Ky gabim i dukshëm, sipas aktgjykimit të shkruar, *“vën në pyetje prezencën (e saj) si dëshmitare okulare në vendin e ngjarjes”*. Lidhur me çështjen kryesore të faktit nëse ajo kishte parë të pandehurin duke shtënë në viktimën, deklarata e saj përputhej me deklaratën e dhënë para gjykatësit hetues: ajo kishte qenë dëshmitare e vrasjes (kishte parë vrasjen). Kolegji gjykues nuk i kishte parashtruar dëshmitarit asnjë pyetje lidhur me çështjen e gëzhojave të plumbave, përkundër rëndësisë së dhënë kësaj çështje në aktgjykimin e shkruar.

Pas vrasjes viktima ishte vendosur në një automjet për t’u dërguar në spitalin e Pejës. Në rrugë e sipër ishin takuar në një kolonë të automjeteve të ndalura nga KFOR-i. Në atë kolonë ata kishin parë të pandehurin. Dëshmitarët kishin theksuar se nuk e kishin informuar KFOR-in për shkak se nuk flisnin italisht. Sipas aktgjykimit të shkruar, *“ata kanë qenë të obliguar ta paraqesin rastin”* dhe pasi që nuk e kanë bërë këtë, gjykata ka përfunduar se i pandehuri nuk kishte vararë. Përfundimisht, aktgjykimi i shkruar thekson se me rastin e arritjes së policisë në vendin e ngjarjes, dëshmitarët që kishin qenë prezent nuk kishin përmendur emrin e të pandehurit. Por, kolegji gjykues kishte dështuar të marrë në pyetje policin e UNMIK-ut nëse ai kishte pyetur dëshmitarët se kush ishte kryrësi apo nëse diçka është biseduar fare. Dëshmitari kishte deklaruar se Lulja, e cila kishte qenë prezente, kishte qenë në gjendje të shok-ut.

Ky rast ngritë shqetësimet nëse çështjet e sigurisë kan ndikuar në aktgjykim.

Prizren

Me 2 Tetor 2000, prona e viktimës ishte shkatërruar me mjet shpërthyes. Para sulmit, i pandehuri, X, një kryesues i një partie politike, së bashku me të tjerët, supozohet se kishte kërcënuar viktimën, duke pohuar se prona ishte e tij. Njëri prej personave të pranishëm dhe që pohohet se kishte bërë kërcënimin ishte një Komandues i TMK-së. Në këtë incident kishte qenë dëshmitarë edhe vëllau i viktimës. Punëtorët në shtëpi gjithashtu kishin qenë të kërcënuar. Më vonë, personat përfshirë aty edhe pjestarë tjerë të TMK-së ishin kthyer në ato objekte dhe kishin kërcënuar viktimën. Pas arrestimit të personit X, policia kishte gjetur detonatorë në banesën e tij dhe një *“skicë të planit të ndërtimit”* në automjetin e shokut të tij dhe i cili ishte parkuar në pronën e tij, qelësat e automjetit ishin gjetur në shtëpinë e tij. Policia e UNMIK-ut kishte konfirmuar se për këtë rast nuk është bërë ndonjë analizë mjeko-ligjore.

Komanduesi i TMK-së ishte thirrur në gjykim por nuk ishte gjetur në adresën të cilën e kishte dhënë në polici (ky Komandues i TMK-së, tani është nën hetime të policisë së UNMIK-ut për rrëmbimin e dy personave të cilët kishin bërë shantazh kundër dy Shqipëtarëve të Kosovës). Djali i viktimës, i cili supozohet se ka qenë dëshmitarë kur i pandehuri dhe një tjetër person kishin vendosur objekte në shtëpi dy ditë para shpërthimit, nuk ishte thirrur në gjykim. Fillimisht, gjykatësi ndërkombëtar kishte informuar SMSJ, se dëshmia e tij nuk ishte relevante, edhe pse më vonë ai kishte

deklaruar se nuk i kujtohej kjo pjesë e deklaratës. Gjykatësi ndërkombëtarë gjithashtu kishte informuar se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim hetimor sa i përket gjëseneve të gjetura në shtëpinë e personit X. Sa i përket punëtorëve të cilët zupozohet se ishin kërcënuar, gjykatësi ndërkombëtar kishte thënë se viktima nuk kishte mundur të siguroj emrat dhe adresat e këtyre personave. Hetimet ishin ndërprerë. Prokurori publik kishte informuar SMSJ, se kërcënimet kundër viktimës duhet të rishqyrtohen nga prokurori i ri publik ndërkombëtar.

Pas një hetimi policor lidhur me një dhunim seksual të supozuar të dy viktimave, të moshës 16 dhe 19, nga pjestarë të PU të UÇK-së (Policisë Ushtarake të UÇK-së), me 16 Nëntor 2000, prokurori ndërkombëtar kishte kërkuar fillimin e hetimeve dhe paraburgimin e të pandehurve për shkak të rrezikut të arratisjes së tyre, se mund të përsërisin veprën dhe mund të ndikojnë në dëshmitarë. Të dyshuarit supozohet se me forcë i kanë dërguar viktimat në “ndërtesën e policisë” së UÇK-së dhe pastaj i kanë sulmuar seksualisht ato. Kryetari i gjykatës së qarkut thekson se lënda menjëherë i ishte dorëzuar gjykatësit ndërkombëtar dhe njëkohësisht kishte vërtetuar se kjo punë është bërë rreth mesit të Nëntorit 2000. Gjykatësi ndërkombëtar nuk kishte filluar hetimet. Në Shkurt 2001, ai e kishte rikthyer lëndën duke thënë se ishte tepër i nxënë në përpilimin e aktgjykimit të shkruar të rastit *Sava Matic*.

Sa i përket kërcënimeve dhe frikësimeve, një gjykatës vendor kishte informuar SMSJ, se “*ne duhet të jetojmë me këtë*”. Gjykatësi hetues për një lëndë të plaçkitjes, kishte raportuar KB, se ai ishte kërcënuar nga të pandehurit, të afërmit e tyre dhe nga thirrje anonime telefonike. Prokurori publik për një lëndë tjetër, ishte kërcënuar për vdekje nëse ai nuk e shpejton gjykimin dhe nuk e liron të pandehurin.

Prishtinë

Në Tetor 2000, prokurores publike i është afuar në zyrën e saj një ish i pandehur. Ai kishte qenë agresiv dhe kishte pohuar se ajo kishte qenë përgjegjëse për zgjatjen e paraburgimit për tetë muaj. Ai kishte kërkuar kompenzim. Policët e gjykatës ishin informuar dhe pastaj ai njeri ishte larguar nga ndërtesa. Një prokuror tjetër kishte informuar SMSJ-në, se ai kishte pranuar përmes telefonit në mënyrë të përsëritur kërcënime të vdekjes, që ndërlidheshin me arrestimin e pesë ish-pjestarëve të UÇK-së. Ai kishte pohuar se edhe personeli i tij ishte kërcënuar. Një prokuror publik kishte dhënë dorëheqje për shkak të kërcënimeve.

III. Gjqësia

(a) Parregullësitë procedurale

Prizren

Në një rast për të mitur, gjykatësi porot kishte lënë gjykimin në kohëzgjatje prej pesë minutash. Në një rast tjetër për të mitur, ku përfshiheshin tre të pandehur lidhur me një

plaçkitje, njëri prej gjykatësve porot nuk kishte marrë pjesë në dëgjim. Procedura kishte vazhduar në mungesë të tij.

Në gjykimin e *Zeqir Bashës*, për vrasje, i pandehur i sëmure psikikisht, prokurori publik është parë duke lexuar gazetë gjatë gjykimit dhe në një rast kishte dalur nga gjykatorja për të pirë një cigare, edhe pse dëshmitari ishte duke dhënë dëshminë. Ai gjithashtu nuk kishte marrë pjesë gjatë shpalljes së aktgjyqimit.

Në këtë proces kishte pasur edhe shtyerje të cilat kishin sjellur ri-fillimin e gjyqimit. Kryetari i kolegjit pastaj kishte deklaruar për procesverbal se aktakuza, dëshmitë e dëshmitarëve dhe raporti psikiatrik ishin lexuar, gjë që përputhet me dispozitat relevante të LPP të RFJ. Por kjo nuk ishte e saktë sepse kryetari i kolegjit nuk e kishte lexuar këtë material për të hyrë në proceverbal.

Regjioni i Gjilanit

Në rastin e *Afrim Xheladinit*, gjykatësi porot kishte ardhur për një orë gjatë deklarimit të dëshmitarit. Ai kishte qenë i nxënë në një dëgjim tjetër në një pjesë të ndarë të ndërtesës së gjykatës. Në rastin e një të mituri, gjykatësi hetues kishte caktuar me vendim paraburgimin. Mbrojtësi kishte paraqitur ankesë në vendim, me ç'rast kolegji i të treve kishte hudhur ankesën. Gjykatësi hetues në shkelje të LPP të RFJ, kishte marrë pjesë në kolegjin i cili kishte vendosur lidhur me ankesë.¹ Në rastin për krime lufte të *Momcilo Trajkovic*, njëri prej gjykatësve porot ishte larguar nga kolegji dhe ishte zavendësuar me një tjetër, i cili duke përjashtuar datën 24 nëntor 2000, kishte qenë prezent në gjykim si kujdestar. Por gjykata në shkelje të LPP të RFJ, nuk kishte lexuar përsëri për gjyqtësin e ri porot – dëshminë e cila ishte dhënë me 24 nëntor 2000.²

Pejë

E drejta në heshtje gjatë hetimeve si dhe gjatë gjyqimit është e paraparë në dy të drejta të mbrojtura ndërkombtarisht: në të drejtën e prezumimit të pafajsisë dhe në të drejtën e mos detyrimit për të dëshmuar apo për të pranuar fajsinë. E drejta në heshtje gjithashtu është e paraparë në LPP të FRJ.³ Në rastin *Veselin Besovic*, gjykatësi hetues ka udhëzuar të pandehurin se “për të do të ishte më mirë të dëshmoj”. Në rastin *Nikqi*, i pandehuri është informuar se “është në interesin tënd më të mirë të dëshmosh”. Në rastin *Shemsi Rugova*, kryetari i kolegjit, ndërkombëtar, kishte informuar të pandehurin se edhe pse ai (i pandehuri) vendos nëse dëshiron të dëshmoj, dëshmia e tij do të ndihmonte gjyqin në atë mënyrë që do të “shpejtonte procesin gjyqësor”.

Në gjykimin për tentimvrasje të *Zef Bezhit et al*, prokurorja kishte lëshuar gjykatoren për pesëmbëdhjetë minuta për të marrë pjesë në gjykimin e *Vilson Doqit*, për tentim dhunimi seksual, me ç'rast kishte lexuar aktakuzën. Pas asaj ajo ishte kthyer në gjykimin e *Bezhit*, që kishte vazhduar në mungesë të saj.

¹ neni 39(5) i LPP të RFJ

² neni 305(1) i LPP të RFJ

³ neni 218(2) i LPP të FRJ

Në rastin e *Shaban dhe Hasan Selimit*, para dhënjes së dëshmisë, asnjëri prej të pandehurve nuk ishte informuar për të drejtën e tyre në heshtje. Në fakt, kryetari i kolegjit kishte informuar njërin prej të pandehurve që “*ju duhet të tregoni se çka ka ndodhur*” .

Prishtinë

Në rastin *Hilmi Ajeti*, i pandehuri ishte alivanosur në fillim të gjyqimit të tij. Pas një pushimi prej pesëmbëdhjetë minutash, mjeku kishte informuar gjykatën se i pandehuri vuante nga tensioni i ulët i gjakut dhe se duhet të dërgohet në spital. Kryetari i kolegjit kishte informuar mbrojtësin se gjykimi do të duhej të vazhdojë. Mbrojtësi ishte pajtuar, gjykimi kishte vazhduar dhe i pandehuri ishte denuar. Gjatë dëgjimit hetimor të dy të miturve, gjykatësi hetues kishte caktuar mbrojtësit mirëpo, më pas kishte vazhduar me marrjen e tyre në pyetje, edhe pse mbrojtësit nuk ishin prezent. Njëri prej të miturve nuk kishte as përfaqësuesin familjar.

Në rastin *Joksimovic*, në gjykimin e tij për tentim vrasje të një Shqipëtarit të Kosovës, gjykimi kishte filluar me 27 shtator 2000, dhe është dëgjuar një masë substanciale e provave. Gjykimi ishte shtyer për 17 tetor 2000. Mu në atë datë për shkak të obligimeve tjera, gjykatësi ndërkombëtar ishte molisur dhe ishte zavendësuar me një tjetër gjykatës ndërkombëtar. Sipas ligjit të zbatueshëm, gjykimi duhet të ri-filloj nëse anëtarësia e kolegjit ka ndryshuar apo kur zavëndësohet kryetari i kolegjit.¹ Gjykimi kishte vazhduar.

Në rastin e *Enver Berishës*, në gjykimin e tij për posedim të armatimit të rëndë kishte filluar dhe kishte përfunduar edhe pse të dy gjykatësit porot kishin munguar. Me të njëjtin shqetësim ishte edhe fakti se menjëherë pasi që prokurori publik kishte lexuar aktakuzën ai ishte larguar nga gjykatëria. Në mungesë të tij dhe në emër të tij (prokurorit), kryetari i kolegjit kishte bërë fjalimin përfundimtar dhe e kishte futur në procesverbal. Prokurori publik nuk ishte kthyer në gjykim.

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ka pasur momente të komunikimit *ex parte*. Një gjykim për dhunën seksuale i caktuar për 13 shkurt 2001 ishte shtyer edhe pse nuk ishte mbajtur seanca gjyqësore. Tre të pandehurit të cilët kishin marrë pjesë në gjykim ishin thirrur në zyrën e kryetarit të kolegjit dhe ishin larguar pasi ishin marrë vesh lidhur me datën e gjyqimit. Me 14 shkurt 2001, një ngjarje e ngjajshme kishte ndodhur me të njëjtin gjykatës në gjykimin e H.M. për dhunim seksual. Gjykimi ishte shtyer pas një takimi privat të viktimës dhe gjykatësit në zyrën e tij.

(b) Kompetenca e gjykatës

Në tetor 2000, SMSJ është informuar se tre gjykatës dhe një prokuror publik në regjionin e Gjilanit nuk kishin pasur kualifikime të nevojshme gjyqësore. Tre individët nuk kishin plotësuar minimumin e kualifikimeve për gjykatës në atë se ata nuk i kishin kaluar provimet relevante për kandidat në judikaturë ashtu si kërkohet me *Rregulloren 1999/7* (prej se është nënshtruar nga *Rregullorja 2000/57*). Njëri prej gjykatësve kishte

¹ neni 305(1) dhe (3) i LPP të RFJ

informuar SMSJ, se ai e kishte kaluar *një pjesë* të provimit të *jurisprudencës*, por nuk e kishte përfunduar në tërësi. Gjykatësi i dytë kishte informuar SMSJ, se ai e kishte dhënë provimin *profesional* me të cilin ai kishte të drejtë të punonte në gjykatën për kundërvajtje, edhe pse ai ishte ulur në gjykatën komunale. I treti kishte informuar SMSJ, se ai nuk kishte kaluar as provimin *profesional* e as atë të *jurisprudencës*. Edhe prokurori publik kishte mungesë të kualifikimeve të nevojshme për t'u emëruar.

DD i KB, ishte në njohuri të kësaj informate që nga tetori 2000. Pa marrë parasysh seriozitetin e kësaj çështjeje, nuk është ndërmarrë asnjë hap për adresimin e këtij problemi deri sa janë rishikuar kontratat e gjyqësisë në dhjetor të v.2000. Kur SMSJ, kishte informuar DD të KB, lidhur me problemin, ata ishin përgjigjur duke thënë se ata ende ishin duke bërë hetime, por se për çdo rast, pasi që individët në fjalë ishin betuar për funksionin e tyre, çdo “akt pasues gjyqësor” do të ishte ligjor. Me 22 dhjetor 2000, DD i KB, i kishte rekomanduar PSSP-së, që personat e përmendur më lartë, të mos rimërohen dhe emërimet e tyre nuk janë vazhduar pas 31 dhjetorit 2000. Tani doli në pah se gjithsejt trembëdhjetë zyrtarë gjyqësor ishin pa kualifikime.¹ SMSJ, ishte informuar nga gjykatat e përfshiëra se ato nuk mund të përcaktojnë numrin e lëndëve të ndikuara nga kjo.

Vendimet e marra nga një tribunal i cili nuk është i përbërë në pajtim me ligjin mund të rezultojnë në ndonjë lirim të mëvonshëm apo që ndonjë denim të anulohet. Sipas nenit 2 të LPP të RFJ, sanksionet penale mund të shqiptohen vetëm nga një “gjykatë kompetente” duke u përmbajtur procedurës së përcaktuar me ligjin e procedurës penale. LPP i RFJ kushtëzon që procedura të zhvillohet nga “personi i autorizuar” para kolegjit gjykues i përbërë në pajtim me nenin 23 të LPP të FRJ.²

Dispozita e LPP të FRJ, lidhur me përjashtimin e gjykatësve nuk përmend në mënyrë specifike mungesën e kualifikimeve të duhura. Përbërja jo e rregullt e gjykatës paraqet shkelje esenciale të procedurës penale dhe i shërben ankesës.³

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta (1978) është pjesë e ligjit të zbatueshëm i cili rregullon kriteret për emërimin e gjykatësve. Neni 69 thotë se gjyktësit duhet të jenë shtetas të Jugosllavisë të cilët e kanë të kryer fakultetin juridik. Për gjykatësit në nivelin e gjykatës Komunale dhe atë të Qarkut, ata gjithashtu duhet ta kenë të kryer edhe “provimin e jurisprudencës”. Në rast se konstatohet se gjykatësi nuk posedon kualifikimet relevante ai duhet të shkarkohet.⁴ Krahas kësaj, secili gjykatës që është nën hetime, duhet të suspendohet deri sa të vazhdojnë hetimet.⁵

Ligji mbi Prokurorinë Publike (1976) është pjesë e ligjit të zbatueshëm i cili rregullon emërimin dhe shkarkimin e prokurorëve publik. Sipas nenit 24 prokurorët publik në gjykatat komunale dhe në ato të qarkut duhet të jenë shtetas të Jugosllavisë të cilët kanë

¹ gjashtë zyrtarë gjyqësor nga gjykata komunale dhe shtatë nga gjykata kundërvajtëse

² neni 17 LPP i RFJ

³ neni 363(1) dhe 364(1) i LPP të RFJ.

⁴ Neni 78 (9) i LPP të FRJ

⁵ nenet 76 dhe 95 për sa i përket gjyktësve porot.

diplomuar në fakultetin juridik dhe që kanë përfunduar provimin e jurispodencës. Prokurori publik i cili nuk i plotëson kushte duhet të shkarkohet dhe gjithashtu ekziston dispozita për suspendimin e tyre gjatë hetimeve.¹

Kriteret për zgjedhjen e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë janë të nënvizuara me *Rregulloren 1999/7 të UNMIK-ut, Mbi Emërimin dhe Shkarkimin e Funksionit të Gjykatësve dhe Prokurorëve*. Neni 6 (i Rregullores) kërkon që gjykatësit dhe prokurorët duhet, në mes tjerash, të kenë diplomën univerzitare të fakultetit juridik dhe duhet të kenë të dhënë provimin e jurispodencës (ose për gjykatësit në gjykatat për kundërvajtje, të kenë të dhënë provimin profesional). Përmbushja e këtyre kriterëve është parakusht për dhënjen e betimit me rastin e pranimit të detyrës.

Neni 6 (1) i ENDNj dhe neni 14 (1) i PNDCP, kërkojnë që gjykimet në të cilat përfshihen paditë penale, duhet të mbahen para *tribunalit kompetent të krijuar me ligj*. Ekziston një jurisprudencë e vogël e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbi interpretimin e kuptimit të “krijuar me ligj”. Përbërja e gjykatave duhet, megjihatë, të bëhet në pajtim me ligjin vendor, dhe krahas kësaj, me kërkesat e ligjit ndërkombëtar mbi pavarësinë dhe paanshmërinë.² Parimi i 10 i *Parimeve Fundamentale të Pavarësisë Gjyqësore*, kërkon që personat e zgjedhur për funksionin e gjykatësit duhet të jenë individët “me stërvitje të duhur dhe kualifikime juridike”.³

¹ Nenet 33(9) dhe 42 të LPP të FRJ

² lexo *Belilos kundër Zvicrrës* (1988), Seria A Nr. 132 në para. 64.

³ Parimet Fundamentale të Pavarësisë Gjyqësore (1985), si e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 40/32, 29 Nëntor 1985 dhe 40/146, 13 Dhjetor 1985.

PJESA 6: VIKTIMAT E DHUNËS SEKSUALE

Hyrje

Standardet e zbatueshme ndërkombëtare, definojnë “viktimat” si “persona të cilët...kanë pësuar vuajtje, përfshirë lëndimet psiçike apo mentale, vuajtje emocionale, humbje ekonomike apo cenime të rënda të të drejtave fundamentale të tyre, për mes veprimeve apo mosveprimeve që paraqesin shkelje të ligjeve penale”.¹ Viktimat e tilla kanë të drejtë qasjeje në mekanizmat e drejtësisë dhe kanë të drejtë në një kompenzim të menjëhershëm të pësimeve të vuajtura. Qasja në drejtësi dhe trajtim të drejtë për viktimat ka të bëjë me sigurimin se ata janë të vetëdijshëm për rolin dhe fushëveprimin e tyre në procedurë dhe se vështrimet dhe shqetësimet e tyre janë shfaqur dhe janë marrë në konsideratë.² LPP i RFJ, gjatë tërë procedurës penale, parashikon të drejta të caktuara për palët e dëmtuara. Këto të drejta përfshijnë “gjatë dëgjimit të vëjnë në dukje të gjitha faktet dhe të propozojnë prova” sa i përket veprës penale dhe vërtetimin e kërkesave të tyre pasurore-juridike dhe që gjatë gjykimit të “propozojnë provat, t’i bëjnë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të paraqesin vërejtje dhe shpjegime lidhur me thëniet e tyre dhe gjithashtu të japin deklarata tjera dhe të bëjnë propozime tjera”.³ Në rastet kur fëmijët janë viktima, LPP i RFJ, parashikon që ata duhet të kenë ndihmë prej përfaqësuesve të tyre ligjor gjatë tërë procedurës penale.

Raporti i kaluar ka potencuar nevojën për përfaqësimin e viktimave, ndihmën dhe mbrojtjen e tyre në kontekst të delikteve seksuale dhe njëkohësisht ka identifikuar probleme të konsiderueshme lidhur me sjelljen ndaj këtyre rasteve. Raporti kishte diskutuar në veçanti, sjelljen e personelit gjyqësor e cila mund të implikoj diskriminim kundër viktimave të pohuara të delikteve seksuale dhe mungesën e përfaqësimit për viktimat nëpër gjykatore. Krahas kësaj, këto raste kanë qitur në dritë mungesën e shërbimeve të mbrojtjes dhe përkrahjes për viktimat e pohuara, problemin e përjashtimit të publikut dhe anëtarëve të familjes dhe dështimi i personelit gjyqësor të shpjegoj në gjykim, pohimet mbi kërcënimet ndaj viktimave dhe/apo arsytet për tërëhjekjen e viktimave nga deklaratat e tyre. Raporti kishte potencuar se krijimi i organeve për përfaqësimin e viktimave, të përbëra prej personelit me stërvitje të duhur, për të ofruar mbrojtje për viktimat e ndieshme gjatë tërë procedurës penale, do të ndihmonte sigurimin e deklaratave të baraspeshuara dhe esenciale nga viktimat, së bashku me mbrojtjen e drejtave të tyre, përfshirë këtu edhe jetën private.

Në disa raste, viktimat dhe dëshmitarët kërkojnë mbrojtje në mënyrë që të përmbushin të drejtën dhe obligimin e tyre për të marrë pjesë në procedurën penale. Në raste të tilla, nga autoritetet kërkohet që të ndërmarrin “masa të pakësimit të gjendjes së pavolitshme për viktimat, të mbrojnë jetën private të tyre dhe nëse shfaqet nevoja të mbrojnë sigurinë personale të tyre, e gjithashtu edhe të familjes së tyre dhe dëshmitarëve prej kërcënimeve

¹ *Deklarata e Pramieve Fundamentale të Drejtësisë për Viktima të Veprave Penale dhe Shpërdorimit të Pushtetit*, Rezoluta e Asamblesë Gjenerale (29 nëntor 1985).

² E ngjajshme me futnotën Nr. 1.

³ Neni 59 (1)&(2) i LPP të RFJ.

dhe hakmarrjes”.¹ Edhe pse e drejta e të pandehurit për dëgjimin e dëshmitarëve kundër tij/saj është njëra prej të drejtave kryesore që përfshihet në gjykim të drejtë, Gjykata Evropiane ka vërtetuar se në disa raste të caktuar, është e domosdoshme për autoritetet që të ndërmarrin hapa për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.²

Në rastet e rënda të dhunës seksuale dhe dhunës familjare e gjithashtu edhe në rastet ku përfshihen fëmijët, ekziston nevoja për mbrojtjen e viktimave, siç janë video-lidhjet, ekranet apo shqyrtimet *in-camera* (në dhomë të posaçme pa prezencën e të pandehurit). Poasçerisht senzitive janë rastet e aktivitetit të krimit të organizuar, për këto raste janë të domosdoshme mekanizma substancial për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, siç janë dispozitat për imunitet dhe mbrojtje afatgjate të dëshmitarëve kryesor (përfshirë këtu p.sh. programin për ndërrimin e vendqëndrimit). Deri më tani, UNMIK-u nuk ka përpiluar ndonjë udhëzim për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve nëpër gjykatore, e as që ka krijuar mekanizma apo programe për mbrojtje substanciale të dëshmitarëve. Nga policia e UNMIK-ut janë formuar dhe udhëhiqen grupe punuese për adresimin e këtyre çështjeve.

I. Viktimat e Veprave Penale që kanë të bëjnë me Trafikimin

Në Kosovë, shumica e delikteve të trafikimit me njerëz kanë të bëjnë me lëvizjen dhe shitjen e grave të huaja për qëllim të detyrimit të tyre në prostitucion.³ Shumica prej sjelljeve kriminale në të cilat hyn trafikimi përfshinë një grup apo një aktivitet të organizuar kriminal, i cili është i inkriminuar në aspekte të caktuara nga ana e ligjit vendor.⁴

Njëri prej rasteve të para të këtij lloji, që është gjykuar në gjykatën e qarkut kishte ndodhur në Gjilan, me ç’rast tre të pandehur ishin denuar për “ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit” duke u bazuar në thëniet e katër viktimave të huaja të Evropës Lindore të bëra para gjykatësit hetues. Edhe pse vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare është përqëndruar kryesisht në trafikimin e grave përtej kufinjëve, ekzistojnë gjykime në gjykatat e qarkut kundër personave për lëvizje të vajzave të reja brenda Kosovës për qëllim të detyrimit të tyre për t’u lëshuar në prostitucion. Që nga fillimi i administrimit të UNMIK-ut, duket së është bërë një ndryshim i kahjes së gjykatave – prej ndjekjes penale të viktimave për prostitucion, në drejtim të ndjekjes së kryësve të delikteve të trafikimit.⁵

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas (KEGjFDKG) obligon UNMIK-un, të “ndërmerr të gjitha masat e duhura, përfshirë këtu

¹ *Deklarata e Prave Fundamentale të Drejtësisë për Viktima të Veprave Penale dhe Shpërdorimit të Pushtetit*, para, 5(d).

² lexo *Dorson kundër Holandës*, (1996), 22 KEDNj 330.

³ Nen 74 i LPK-së, neni 38,39,46, i LPK-së, neni 251 dhe 155 i LP të FRJ, Deliktet tjera të trafikimit përfshijnë, “kalimi i palejueshëm i kufirit shtetëror” prej tjerave (neni 249(2) i LP të FRJ)dhe “ bën të mundur personit tjetër përdorimin e narkotikëve intoksikues” (neni 246 i LP të FRJ).

⁴ Nenet 197, 196 të LPK-së, nenet 22,24 të LP të RFJ.

⁵ *Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4*, mund të rregulloj këtë çështje pjesërisht, pasi që parashikon mundësinë për mbrojtje për viktimat kundër ndjekjes penale për prostitucion, në atë se thot “personi nuk është penalisht i përgjegjshëm për prostitucion apo hyrje të palejueshme, prani apo punësim në Kosovë nëse ai person ofron prova të cilat mbështesin besimin e arsyeshëm se ai pao ajo ka qenë viktimë e trafikimit”.

edhe ato legjislative, të zbrapsë të gjitha format e trafikimit të grave dhe eksploatimit të grave për prostitucion”. Në lidhje me këtë, UNMIK-u, ka shpallur *Rregulloren 2001/4 Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë*.

(a) Dështimi për të siguruar dhënjen e dëshmisë së viktimës në gjykatë

Në rastet e delikteve të trafikimit me njerëz, organizatat të cilat merren me ndihmën e viktimave kanë theksuar rëndësinë për t’u siguruar se gratë të cilat dëshirojnë të kthehen në shtetin e tyre, të riatdheshohen sa më shpejtë që është e mundur. Për shkak se nuk ka mekanizëm për mbrojtjen e viktimave, është e pasigurtë për viktimën të pres më gjatë se që është e nevojshme për riatdhësim. Megjithatë, praktika e riatdhësimi të shpejtë të viktimave të supozuara të trafikimit, në disa raste të shënuara, ka lënë në pamundësi gjykatën dhe të pandehurin për dëgjimin e deklaratës së viktimës. Në rastet kur viktimat e delikteve të trafikimit kanë dhënë deklaratën vetëm në polici pa prezencën e të pandehurit apo mbrojtësit, ndërsa deklaratat e tyre është dëshmia kryesore, apo e vetmja, për palën ndjekëse, paraqitja e këtyre deklaratave në seancë gjyqësore do të rezultoj në shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë për të pandehurin.

Rregullorja 2001/4 mund të rregulloj këtë problem pjesërisht për shkak se mundëson banim të përkohshëm dhe të sigurtë (për viktimat), masa për mbrojtje të dëshmitarëve, dhe ndihmesë tjetër për viktimat që do të mbështesin viktimat e delikteve të trafikimit, derisa ato qëndrojnë në Kosovë, dhe atë për qëllim të dhënjës së ndihmës për ndjekjen penale të kryrësve, apo të mbrojnë viktimat e trafikimit brenda Kosovës derisa zgjatë procesi gjyqësor. Megjithatë, akoma mbeten për t’u jetësuar aspektet e Rregullores lidhur me ndihmesën dhe mbrojtjen e viktimave, përkundër faktit se çështja e elementit të ndihmesës është diskutuar gjerësisht dhe për një kohëzgjatje të konsiderueshme.¹

Përkundër rëndësisë substanciale që i është dhënë mbrojtjes së viktimave në këto raste – kur kundër tyre kryhen krime të shumfishta – kjo rëndësi ka ndikuar në efektivitetin dhe integritetin e procedurës gjyqësore dhe ka rezultuar në pandëshkueshmëri për disa kryrës. Më pak kishte pasur përqëndrim në sigurimin e ekspedivititetit të procedurës gjyqësore për këto raste, që viktimave t’u sigurohet banimi dhe zhvillimin e masave adekuate në përgjithësi, të mbrojtjes së viktimave për të siguruar dhënjen e dëshmisë gjyqësore, e psaqërisht në seancë gjyqësore. Krahas kësaj, shumë pak vëmendje i është përkushtuar udhëzimeve për gjykatat dhe policinë në zhvillimin e hetimeve adekuate për këto lloje rastesh.² Tani përpjekjet duhet të përqendrohen në këtë aspekt.

¹ Për shembull, UNMIK-u akoma duhet të caktoj koordinatoren për ndihmesë të viktimave ashtu siç parashikohet në Rregullore.

² Policia ka krijuar Njësitë për hetimin e Trafikimit dhe Prostitucionit, në të gjitha pesë regjionet, për hetimin e rasteve të tilla.

H

Në Shtator 2000, dy femra, motra binjake nga Moldavia, kishin pohuar në polici se ato I ishin shitur një njeriu të quajtur "N", i cili i kishte marrë pasaportat e tyre dhe i kishte detyruar ato të punojnë si prostituta në kabare-kafeterinë e tij, në Prishtinë. Derisa ishin duke punuar në kafeteri ato ishin takuar me një njeri tjetër, Ramadan, i cili u kishte ndihmuar atyre të iknin nga Prishtina për në Prizren. Me 24 Dhjetor 2000, ato ishin zbuluar nga tre persona, emrat e të cilëve i kishin të njohur dhe një person të panjohur i cili punonte me personin "N". Këta persona me forcë i kishin detyruar dy viktimat dhe Ramadanin të hyjnë në një banesë, pronë e të pandehurit. Viktimat kishin deklaruar në polici se këta katër persona kishin konsumuar drogë dhe i kishin dhunuar ato shumë herë. Në mëngjes i pandehuri *H* supozohet se kishte drejtuar revolen në drejtim të njëres vajzë dhe gjithashtu e kishte dhunuar.

Ramadani kishte treguar policisë se të nesërmen, nga ai kishin kërkuar pagesë prej 5,000 DM për dy viktimat dhe ia kishin marrë pasaportën, orën e tij dhe dy unaza si parapagesë. Ai ishte takuar në rrugë me katër personat dhe ata e kishin kërcënuar për vrasje. Ramadani pastaj kishte kontaktuar UNMIK-un. Vetëm i pandehuri ishte arrestuar me 1 tetor 2000, pasi që katër të dyshuarit tjerë ishin zhdukur. Me 4 tetor 2000, i pandehuri *H* ishte liruar nga paraburgimi.

Dosja policore e UNMIK-ut, ishte dorëzuar prokurorit publik të gjykatë së qarkut i cili refuzoi të merret me të pasi që dosja kishte të bënte me prostitucion. Gjithashtu gjykata kundërvajtëse refuzoi lëndën pasi kishte të bënte me veprat penale nën kompetencë të gjykatës së qarkut. Me 11 dhjetor 2000, *H* ishte dëgjuar nga gjykatësi hetues pas arrestimit të tij të dytë. Gjatë dëgjimit, ai bëri të ditur mbiemrin e njërit prej katër të dyshuarve dhe kishte deklaruar se i kishte lejuar të kalojnë natën në banesën e tij. *H* nuk kishte pranuar se kishte qenë në banesë. Nuk ishte bërë asnjë ekzaminim mjekësor apo mjeko-ligjor ndaj viktimave.

Gjatë kësaj kohe, dy viktimat ishin riatdhesuar vullnetarisht në Moldavi. Si rezultat i kësaj ato nuk kishin bërë asnjë deklaratë gjyqësore. Gjykata kishte bërë përpjekje për ta thirrur Ramadanin në gjykim, por pasi që policia e kishte gjetur vend ndodhjen e tij, nuk është bërë ndonjë përpjekje tjetër për ta pruar të njëjtin për të dëshmuar. Edhe pse gjykata kishte kërkuar nga policia të hetoj katër të dyshuarit tjerë nga Prishtina, policia ishte përgjigjur se nuk kishin të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e tyre, ndërsa gjykata nuk kishte informuar policinë se i pandehuri kishte dhënë emrin e plotë të njërit person të dyshuar. Aktakuza kundër të pandehurit për dhunim seksual është ngritur me 10 janar 2001, me propozimin që gjykata të lexoj deklaratat policore të dy viktimave dhe Ramadanit.

Y et al.

Me 16 tetor 2000, është ndalur një automjet i policisë së UNMIK-ut, në rrugën në mes të Fushë Kosovës dhe Prishtinës, nga ana e tri femrave të reja me ç'rast kishin kërkuar ndihmë. Këto femra të reja, të gjitha shtetase të Rumanisë së bashku me një shtetase të

Moldavisë, i kishin thënë policisë se secila nga to në raste të ndara, ishin shitur nga dy Serb të panjohur nga Beogradi, dy Serbëve tjerë. Këta dy Serb i kishin pruar ato në Mitrovicë dhe njëri nga ta, i pandehuri Y i kishte rrahur për t'i detyruar ato në marrëdhnje seksuale me "klientë". Ato kishin deklaruar se ishin pruar nga Y prej Mitrovicës në Fushë Kosovë, me një automjet të KB-së, i drejtuar nga një zyrtarë Rus i KB-së, dhe i kishin vendosur ato në Hotel Tejecki. Njëra prej tyre kishte lutur pronarin e hotelit që t'a punësoj atë si banakiere, por Y ishte sjellur keq me të (vajzën) dhe ishte kërcënuar se do ta vriste. Pronari i hotelit ishte arrestuar nga policia por ishte liruar pas deklaratës së tij se ai vetëm kishte tentuar t'i ndihmoj asaj duke e punësuar, dhe poashtu ai kishte vërtetuar se ai e kishte dëgjuar Y duke e kërcënuar vajzën.

Tri vajzat tjera i kishin treguar policisë se ato kanë qenë të detyruara me forcë nga ana e Y dhe gruas së tij, një shtetase e Moldavisë, të shkojnë te i dyshuari i tretë, pronar i një dyqani, NT (i cili nuk ishte paditur), ku Y do të dërgonte "klientët". Më pastaj ato janë dërguar në lokacione të ndryshme për të pasur marrëdhënje seksuale. Dy prej vajzave kishin deklaruar se ato kishin tentuar disa herë të iknin por, Y ua kishte marrë pasaportat. Pasaportat ishin gjetur nga policia në banesën e Y.

Tre të dyshuarit janë akuzuar për "ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit". Të tretë kishin refuzuar akuzat, bashkshortja e Y kishte pohuar se ajo kishte ardhë në Kosovë si prostitutë por ajo nuk ishte e përfshirë në ndërmjetësim të prostitucionit. Pronari i dyqanit kishte pohuar se ai e njifte Y dhe se i kishte parë vajzat disa herë në dyqanin e tij por se ai nuk dinte se çka ishte duke ndodhur. Dëshmitari i tretë, kamarieri i hotelit, kishte konstatuar se vajzat jetonin aty dhe se kishte parë Y duke ardhë dhe duke i marrë ato nga hoteli.

Me 4 dhjetor 2000, pas dëgjimit të personave të dyshuar, gjykatësi hetues kishte kërkuar të dëgjoj viktimat. Diku në mes të tetorit dhe dhjetorit, dy vajzat Rumune ishin riatdhesuar vullnetarisht, ndërsa vajza e tretë ishte humbur gjurmë. Gjykatësi hetues kishte dorëzuar lëndën prapa te prokurori pa dëshmitë e marra nga viktimat. Përkundër kësaj, prokurori publik kishte ngritur aktakuzën me 17 janar 2001.

(b) Çështja e mjaftueshmërisë së hetimeve në rastet e trafikimit

Edhe në rastet kur viktimat kanë dhënë deklaratën gjatë dëgjimit në procedurën hetimore para seancës gjyqësore, vazhdojnë problemet që kanë të bëjnë mjaftueshmërinë e hetimeve sa i përket delikteve të trafikimit. Në shumicën e rasteve, deklaratat e viktimës që është dhënë para gjykatësit hetues, lexohet në seancën gjyqësore. Gjatë dëgjimit hetimor, gjykatësit hetues rrumbullaksojnë dëshminë në procesverbal që pastaj përdoret në seancën gjyqësore.¹ Në dy raste, ky proces ka lejuar hapsirë potenciale për manipulime apo pasaktësi në procesverbal.

¹ SMSJ ka monitoruar rastet kur nuk ka pasur përkthyes gjyqësor për përkthimin nga gjuha ruse në gjuhën angleze (apo ruse në shqipe). Kjo ka shkaktuar vështirësi në hetimet gjyqësore në Pejë dhe kanë rezultuar në atë që Kryetari i gjykatës së qarku të indikojë se deklaratat e marra nga viktimat për këto arsye, mund të konsiderohen të papranueshme për gjykatën.

Krahas kësaj, si rezultat i këtij procesi, është ajo se, viktimat nuk janë të pranishme në senacë për të dëshmuar para kolegjit të gjykatësve të cilët përfundimisht vendosin për aktgjykim dhe për sanksion penal. Për shkak se deliktet e trafikimit zakonisht përfshijnë prostitucionin e detyrueshëm, ekzistojnë shqetësime se personeli gjyqësor mund të ketë ca prejudikime. Një numër i madh i ndjekjeve penale të femrave të huaja në Kosovë për prostitucion, duket se mbështesin këto shqetësime. Pa praninë e viktimave, për gjykatësit është më vështirë të vlerësojnë besueshmërinë e deklaratave apo të vlerësojnë ndikimin apo pasojën e deklitit në viktimën.

Hetimet gjyqësore për këto raste edhe më tutje dëmtohen për shkak të faktit se për gjykatat nuk ekziston ndonjë protokol i ekzaminimit mjekësor për viktimat e delikteve të trafikimit. Përkundër faktit se këto raste pretendojnë të përfshijnë keqpërdorim afatgjatë dhe jetë dhe kushte të punës degraduese, SMSJ, nuk din për ndonjë rast në të cilin këtyre femrave u është bërë ekzaminimi mjeko-ligjor për qëllime të hetimeve penale. Në rastin e përshkruar më lartë, nuk ishte bërë ekzaminimi mjekësor ndaj viktimave edhe pas pohimit se ato një ditë më parë janë dhunuar shumëherë.

Përveç kësaj, këto raste zakonisht përfshijnë grupe të personave që kontribuojnë në aktivitete të ndryshme të palejueshme në të cilat bën pjesë trafikimi. Edhe pse viktimat në këto raste identifikojnë kryrës të shumëfishtë, kjo ngjanë se për këto raste shpeshherë nuk ekziston ndonjë procedurë hetimore në vazhdimësi. Në Pejë, shumë të dyshuar të cilët janë arrestuar nga policia gjatë bastitjes së kafeterive, lëndët e tyre janë hudhur nga gjykata e qarkut sepse viktimat nuk i kishin implikuar ata në mënyrë direkte, për vepra penale individuale.

Demë Nikqi

Me 2 shkurt 2001, *Nikqi* ishte ngarkuar me veprën penale “ndërmjetësim në prostitucion” dhe tri vepra penale të dhunimit seksual dhe një për falsifikim të dokumenteve, dhe ishte shpallur fajtor. Rasti *Nikqi* ishte i bazuar në thëniet e dy femrave nga Moldavia gjatë hetimeve gjyqësore, të cilat kishin pohuar se ishin dërguar në Pejë pa asnjë dokument dhe ishin shitur *Nikqit* i cili i kishte detyruar ato të punojnë në restaurantin e tij si kamariere dhe të shiteshin si prostituta. Ato kishin thënë se edhe *Nikqi* i kishte dhunuar ato në raste të veçanta. Njëra prej femrave kishte deklaruar se pasi që kishte refuzuar të shitej për prostitucion, *Nikqi* e kishte rrahur dhe e kishte dhunuar për “për t’i treguar se çka do të ndodh nëse ajo nuk bën atë çka i thuhet”. Ajo femër kishte deklaruar se konsumuesit e kishin informuar atë se ata paguanin 100-150 DM për një orë apo 200-300 DM për një natë dhe se paratë i merrte *Nikqi*.¹

Gjatë dëgjimeve hetimore, përkundër rrethanave degraduese dhe brutale të përjetuara nga viktimat, gjë që inkuadronte edhe rrahje të shumëfishta, dhunim dhe detyrim për t’u shitur për prostitucion, gjykatësi hetues kishte urdhëruar që dy viktimat lidhur me

¹ Gjatë dëgjimit hetimor, një femër tjetër e huaj, kishte deklaruar se ajo ishte në dashuri me të pandehurin dhe se ai nuk e kishte lënduar apo detyruar në prostitucion. Megjithatë, ajo gjithashtu kishte deklaruar se ajo kishte parë të pandehurin duke rrahur njërin prej viktimave. Kjo dëshmi nuk është lexuar në seancën gjyqësore e as dëshmitari nuk është thirrur për të dëshmuar në gjykatë.

dëshmitë e tyre, ndaras të ballafaqohen me të pandehurin *Nikqin*. Ballafaqimi në mes të *Nikqit* dhe njëres prej viktimave u shëndrrua në duel të britmës, ndaj të cilit gjykatësi hetues nuk kishte intervenuar për ta ndalur dhe dukej se për të ky interakcion ishte zbavitës. Asnjëra prej dy viktimave nuk kishin ndryshuar thëniet e tyre përkundër ballafaqimit, edhe pse të dyjat dukeshin të traumatizuara prej asaj që kishin përjetuar. Në mes të periudhës kohore në mes të dëgjimit hetimor dhe seancës gjyqësore, dy viktimat nga Moldavia, vullnetarisht ishin riatdhesuar në shtetin e tyre. Deklaratat e tyre të dhëna para gjykatësit hetues ishin lexuar në gjykatë. Pas gjykimit, njëri prej gjykatësve gjykues kishte indikuar se për të është vështirë të vlerësoj besueshmërinë e viktimave dhe të kuptoj peshën e veprës për shkak se viktimat nuk kishin dëshmuar gjatë gjykimit. *Nikqi* ishte dënuar me tri vjet e gjashtë muaj vuajtje të denimit me burg për tri dhunime, ndërmjetësim dhe është liruar për t'u mbrojtur në liri.

P dhe Q

Me 3 nëntor 2000, *P* dhe *Q* ishin paditur për “ndërmjetësim në prostitucion” ndërsa *Qi*, për shitje të paautorizuar të narkotikëve dhe posedim ilegal të armës. Aktakuza pjesërisht bazohej në deklaratat e dhëna në gjykatë nga ana e shtatë femrave të huaj nga Moldavia dhe Ukraina. Gjatë dëgjimit hetimor, njëra prej viktimave kishte dëshmuar se si ajo së bashku me tri femra tjera, ishte sjellur përmes Serbisë në Gjakovë, nga dy Serb emrat e të cilëve ato i kishin të ditur.¹ Përkundër faktit se ato nuk flisnin Shqip, ato kishin nënshkruar kontrata në të cilat ato kishin kuptuar se do të paguheshin 1,000 DM për muaj, për vallëzim (toplles) gjysëm të zhveshur, se do të kenë qasje në kujdes mjekësor dhe kushte të mira të jetesës. Dëshmitarja kishte dëshmuar se asnjë nga këto kushte nuk ishin plotësuar dhe se ishin rrahur dhe se nuk ishin paguar më shumë se disa qindra DM, për të blerë ushqim dhe gjëra elementare. Kur këto femra kishin tentuar të iknin, ato ishin rrahur me rrip dhe kishin qenë të kërcënuara se nëse tentojnë të iknin prap ato do të vraheshin.

Këto femra kishin dëshmuar më tutje, se derisa kishin punuar në kafeterinë, “Marilyn Monroe”, ato kishin qenë të detyruara të shiteshin si prostituta me përafërsisht një deri në dy klientë për një ditë, ndërsa katër deri në pesë për një natë. Pagesa për këto shërbime ishte afër 200-300 DM për një orë dhe 500-600 DM për tërë natën. Ato kishin dëshmuar se *Q* i pranonte paratë ndërsa i pandehuri *P* bënte sigurimin. Viktimat e kishin dhënë emrin e një njeriu - *Edmond Canhasi* - si organizator i operacionit dhe që ai i mbante pasaportat e tyre. *Canhasi* ishte paditur ndaras me 13 shkurt 2001 nga gjykata e qarkut në Pejë.² Akuzat kundër pesë personave tjerë të arrestuar gjatë bastisjes në kafeteri ishin hudhur.

¹ SMSJ, kishte vërejtur se gjatë dëgjimit hetimor të viktimës nuk kishte qenë i pranishëm mbrojtësi. Nëse viktimat nuk paraqiten në seancë gjyqësore për të dëshmuar para gjykatës, atëherë kjo mund të ngjajë se e drejta e të pandehurit për të ekzaminuar dëshmitarët e kundërt, sipas nenit 6 të KEDNj dhe nenit 14 të PNDCP mund të cenohet. Lexo pjesën (a) për diskutimin e këtyre problemeve në këto raste.

² Rasti i *Canhasit* mund gjithashtu të ngritë shqetësime serioze në lidhje me të drejtat e të pandehurit pasi që në kohën kur viktimat kanë dhënë dëshminë para gjykatësit hetues, ai kishte qenë në paragjykim dhe nuk ishte i përfaqësuar nga mbrojtësi.

Dëgjimet hetimore të viktimave ishin përshpejtuar për shkak të faktit se në Pejë nuk kishte shtëpi të sigurtë dhe viktimat është dashur të transferohen në Prishtinë. Edhe pse nuk është konfirmuar, shumica e viktimave, ndoshta të gjitha, sipas të gjitha gjasave vullnetarisht janë riatdhesuar në shtetet e tyre apo i kanë humbur gjurmët. Gjykimi ende pritet për të filluar.

R et.al

Me 12 janar 2001, pesë persona janë paditur për vepra penale të shumfishta të lidhura me trafikim. Të gjithë ata janë paditur për “ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit” dhe për “falsifikim të dokumenteve”. Tre prej tyre janë paditur edhe për dhunim. Aktakuza mbështetet në deklaratat e katër femrave, dy nga Moldavia dhe dy nga Serbia, të cilat pohojnë se të pandehurit janë të përfshirë në blerjen e shumë vajzave përafërsisht me çmimin prej 2,000 DM, dhe i shesin ato përafërsisht me çmimin prej 4,000 DM. Grupi i vajzave të cilat kishin punuar për të pandehurit, njëra prej viktimave kishte vlerësuar përafërsisht 14 deri në 15 prej tyre, kishin qenë të detyruara për t’u shitur për prostitucion në Hotel Herzegovina. Përkundër kësaj dëshmie, të pandehurit nuk ishin hetuar për akuzat e blerjes dhe shitjes së personave, p.sh “krijimi i kushteve të skllavërisë (robërisë)”.

Gjatë dëgjimeve hetimore në gjykatën e qarkut në Prishtinë, viktimat kishin dhënë dëshmi të gjëra lidhur me atë se kishin qenë të dhunuara si mënyrë për ti detyruar ato të punojnë, gjithashtu për numrin e madh të klientëve, për pagesat dhe për atë se dy prej të pandehurve kishin qenë bosët e tyre dhe ata i kishin mbajtur paratë. Njëra prej viktimave kishte përshkruar gjithashtu transaksionet për prostitucion me ushtarët Rus të KFOR-it, përfshirë aty edhe bartjen e vajzave në kampin e tyre. Kjo viktimë gjithashtu kishte dëshmuar se ishte rrahur nga këta dy të pandehur. Dy nga viktimat kishin deklaruar se pasaportat e tyre dhe letrat e njoftimit ishin marrur nga njëri prej të pandehurve. Ajo më tutje kishte deklaruar se të pandehurit kishin përdorur drogën dhe se u kishin dhënë drogë shumë vajzave. Njëra prej viktimave në këtë rast kishte deklaruar se fillimisht ajo ishte shitur kur i kishte pasur 14 vjet. Shumë prej vajzave tjera të cilat ishin detyruar nga të pandehurit për t’u shitur për prostitucion, në deklaratat e tyre janë dhënë emrat e tyre.

Dy viktimat nga Moldavia, vullnetarisht janë riatdhesuar pas dhënjes së deklaratës në gjykatë. Njëra prej viktimave mendohet të jetë e sëmurë psikikisht. Njëra prej viktimave që ishte Serbe, me masa të shtuara sigurie, është paraqitur për të dëshmuar në gjykim. Ajo kishte dhënë një dëshmi koherente kundër të pandehurve. Fatkeqësisht, për shkak se për gjykatat nuk ka udhëzime për mbrojtje të dëshmitarëve, nga ajo ishte kërkuar që të jepë adresën dhe vendin e punës së saj (në pajtim me procedurën). Krahas kësaj, sipas procedurës, të pandehurve u është lejuar ta pyesin drejtpërdrejtë dëshmitaren. Gjykimi vazhdon.

II. Deliktet Seksuale

Që nga shtatori 2000, kanë përfunduar 19 gjykime të delikteve seksuale, (12% të të gjitha rasteve të përfunduara), me 29 të pandehur dhe 18 raste të ngritjes së aktakuzës, me 20 të

pandehur, të cilat deri me 28 shkurt 2001, nuk kanë përfunduar ende. Gjithsejt, 37 raste të delikteve seksuale kundër të cilavë *është ngritur aktakuza*, me 49 të pandehur, në gjykatat e qarkut gjatë 6 muajve të kaluar. Rastet e delikteve seksuale shpeshherë udhëhiqen në mënyrë sipërfaqësore nga ana e gjykatave duke shfaqur një mungesë të konsideratës për natyrën e seriozitetit të veprave të tilla për viktimën dhe të pandehurin. Shumica e problemeve të potencuara në raportin e kaluar mbi sjelljet në rastet e delikteve seksuale, vazhdojnë të mbeten prezente dhe këto shqetësime janë shtuar me faktin se në shumicën e këtyre rasteve vazhdojnë të përfshihen viktimat e mitur.

Për shkat të rasteve të shpeshta dhe natyrës komplekse të këtyre rasteve, për një qasje të përgjithshme të përmirësimit të procedurës gjyqësore nevojitet stërvitja e personelit gjyqësor e gjithashtu edhe zhvillimi i një përkrahjeje psiko-sociale, masave mbrojtëse dhe shërbimeve mjekësore/mjeko-ligjore të cilat do të ndihmonin gjykatat gjatë gjykimit të drejtë të këtyre rasteve. Nuk ka pasur ndonjë stërvitje praktike të personelit gjyqësor, policor apo shërbimeve sociale mbi çështjet e dhunës seksuale, përfshirë edhe shtimin e senzitivitetit ndaj viktimave të pohuara. Gjatë gjashtë muajve të kaluar mesatarja e dënimeve të shqiptuara për rastet e dhunës seksuale është zbritur prej tri vite në një vit. Këto sanksione, paraqesin porosi për shoqërinë, e në veçanti për viktimat lidhur me atë se me çfarë serioziteti merret në konsideratë dhuna seksuale nga ana e sistemit gjyqësor.

(a) Sjelljet të cilat implikojnë diskriminim gjyqësor kundër viktimave në raste e delikteve seksuale

Në disa raste, autoritetet gjyqësore kanë shfaqur qëndrime diskriminuuese kundrejt viktimave të supozuara të dhunës seksuale. Një anshmëri e tillë gjyqësore ishte ilustruar me vërejtje paragjyqëse të ushtruara nga gjykatësit para mbajtjes së seancës lidhur me vlefshmërinë e pohimeve të viktimave, me marrjen në pyetje, pa mëdyshje, në mënyrë joadekuate për viktimat, dhe me dështimin e mbrojtjes së viktimave nga komentet jorelevante dhe poshtëruese dhe pyetjeve nga dëshmitarët dhe avokatëve mbrojtës.

Një rast kishte të bënte me një pohim të një viktime se ajo ishte rrahur dhe dhunuar nga i pandehuri në dhomën e tij, me të cilin ajo ishte duke kaluar. Gjatë hetimeve, gjyaktësi hetues kishte marrë një deklaratë nga një dëshmitarë i cili kishte dëshmuar se ai kishte *dëgjuar* se viktima e supozuar “nuk kishte qenë aq e pastër pasi që ajo kishte dalur me shumë njerëz”. Kryetari i kolegjit që e gjykonte rastin, i kishte thënë SMSJ-së para fillimit të gjykimit se *shumica e rasteve të dhunimit janë të fabrikuara nga viktimat e supozuara, të cilat kërkojnë hakmarrje apo tentojnë të vëjnë trysni në të pandehurin që të nxjerrin propozim martesor. Ai shtoi se, në përgjithësi femrat duhet të jenë më të kujdesshme që mos të vendosin vehten në situata potencialisht të rrezikshme*. Gjatë gjykimit, kryetari i kolegjit nuk kishte intervenuar kur njëra prej dëshmitareve gojarisht kishte ngacmuar viktimën duke deklaruar në mënyrë direkte se ajo nuk është femër që e meriton të pandehurin dhe se ai kurrë nuk do të martohej me të. I pandehuri është shpallur fajtor për dhunim dhe është denuar me një vit vuajtje dënimi me burg.

Në një rast tjetër, një viktimë e mitur kishte pohuar se i pandehuri (i cili ishte i martuar) së bashku me shokë, e kishte marrë në një hotel-restaurant, e kishte kërcënuar me revole

dhe e kishte dhunuar. Gjatë gjykimit, kryetari i kolegjit e kishte pyetur viktimën nëse ajo e kishte ditur se pse e kishte dërguar atë në dhomë ku kinse është dhunuar. Ajo ishte përgjigjur se i pandehuri kishte dashur ta lëndoj atë. Kryetari i kolegjit ia kishte kthyer, “Jo, por për shkak se atij i kishte pëlqyer”. Në përgjigje viktimë kishte deklaruar se, “Kam dashur të hudhem nga dritarja”. Kryetari i kolegjit ia kishte kthyer duke folur për dritare, “asgjë nuk do të ndodhte ty, hoteli nuk është aq i lartë”. *Para gjykimit kryetari i kolegjit i kishte thënë SMSJ-së, se ai kishte menduar se viktimë ka mundur të fabrikoj rastin pasi që ai kishte besuar se ajo kishte pohuar dhunimin vetëm pasi kishte kuptuar se i pandehuri ishte i martuar* (përkundër faktit se ka pasur dëshmi në procesverbal të bëra nga palët dhe dëshmitarët e këtij rasti se viktimë kishte ditur se i pandehuri kishte qenë i martuar në momentin e ngjarjes). I pandehuri është shpallur fajtor dhe është denuar me tre vjet heqje lirie.

Në një rast, një viktimë e mitur kishte pohuar se ishte shtyer në marrëdhënje seksuale me dy të pandehur gjatë udhëtimit të tyre me automjet për në liqen. Ajo kishte deklaruar se njëri prej të pandehurve kishte pasur thikë. Dy mbrojtës kishin pyetur viktimën, njëri e kishte bërë me një ton të ngritur dhe autoritativ, qartazi duke frikësuar viktimën. Pa intervenim nga kolegji i gjykatësve, mbrojtësi tjetër kishte parashtruar pyetje thjeshtë poshtëruese ndaj viktimës, siç janë “në çfarë pozite ke bërë seks?” dhe pyetje të ngjajshme për të pandehurin, siç janë “a ka përjetuar viktimë orgazëm?” dhe “a i kishte pëlqyer asaj?”. Raporti mjekësor i ekzaminimit të viktimës i bërë një kohë të shkurtë pas ngjarjes theksonte se ka pasur perforim (shpuarje) të himenit, gjurmë të gjakut dhe ka indikuar në konstatime të cilat përputhen me marrëdhënje seksuale të dhunshme. Të pandehurit janë shpallur fajtor dhe secili prej tyre është denuar me pesë vjet heqje lirie.

Gjatë një gjykimi që përfshinte një viktimë e cila kishte pohuar se i fejuari i saj e kishte dhunuar, procedura ishte ndërprerë disa herë nga ana e kryetarit të kolegjit duke u përgjigjur në thirrje telefonike dhe nga ana e prokurorit i cili kërkonte datat e gjykimeve për lëndë tjera. Kjo sjellje është vazhduar gjatë dhënjes së dëshmisë së viktimës, e cila ishte martuar ndërkohë me të pandehurin. Viktimë kishte deklaruar në mënyrë të qartë se nuk dëshiron të ndiqet penalisht i pandehuri (bashkëshorti i saj). Në përfundim të dëgjimit, kryetari i kolegjit haptas kishte pyetur, si duket në mënyrë ironike, se a është e drejtë që ligji inkriminon vetëm marrëdhënjet seksuale të dhunshme kundër femrës, e jo edhe kundër burrave. I pandehuri është shpallur i pafajshëm pasi që viktimë ishte tërhjekur nga akuzat.

(b) Mbrojtësit e viktimave

Shqetësimet në lidhje me sjelljet e personelit gjyqësor dhe palëve tjera në këto raste kundrejt viktimave të supozuara të krimeve të tilla janë shtuar me faktin se, në shumicën e madhe të rasteve të monitoruara, viktimat e supozuara nuk kanë qenë të përfaqësuara nga mbrojtës të viktimave. Mungesa e mbrojtësve të viktimave është posaçërisht rënduese në rastet e të miturve si viktimë. Krahas kësaj, të miturit shpeshherë paraqiten para gjykatave pa kujdestar ligjor dhe pamarrë parasysh këtë, nga ata kërkohet të dëshmojnë. Në pak raste kur mbrojtësit e viktimave kanë qenë të pranishëm në procedurë,

ata kanë luajtur rol pasiv, gjë që shfaq nevojën për stërvitjen e përfaqësuesve të viktimave për këto raste.

LPP i FRJ, i jepë të drejtën palës së dëmtuar të ketë përfaqësues dhe të jetë e pranishme gjatë gjykimt, të merr pjesë dhe të bëjë pyetje të pandehurit.¹ Gjatë gjykimt megjithatë, praktika është që të përjashtohet viktimja gjatë dëgjimit të dëshmisë së të pandehurit. Me përjashtimin e viktimës gjatë dhënjes së dëshmisë nga i pandehuri kur ato nuk kanë përfaqësues ligjor, viktimave u refuzohet nga ana e gjykatës e drejta në pjesmarrje në këto raste. Në shumë raste, anëtarët e familjes së viktimës janë përjashtuar nga gjykatëria gjatë dhënjes së dëshmisë nga viktimja. Anëtarët e familjes mund të vullnetarisht të dëshmojnë për atë rast dhe për atë shkak përjashtohen. Përndryshe, për shkak se këto raste të dhunës seksuale paraqesin çështje të komplikueshme të kulturës, turpfit dhe imazhit familjar, anëtarët e familjes mund të kenë ndikim negativ në dëshminë e viktimës. Për këto arsye, gjykatësit mund vendosin të kërkojnë nga anëtarët e familjes të dalin nga gjykatëria gjatë dhënjes së dëshmisë së viktimës. Megjithatë, LPP i FRJ parashikon se përjashtimi i publikut nuk përfshinë edhe përfaqësuesin e viktimës. Në rastet kur i mituri është viktimë dhe ka vetëm përkrahjen familjare, përjashtimi i anëtarëve të familjes është në kundërshtim me dispozitën. Mrojtësit e viktimave, megjithatë nuk kanë rolin konfliktuoz në gjykatore dhe me atë rast mund të sigurojnë se janë mbrojtur interesat e viktimës gjatë tërë procedurës.

Në një rast, një viktimë pesëmbëdhjetë vjeçare kishte pohuar se në një banesë ishte detyruar nga një grup djelmoshash, me ç'rast tre prej tyre e kishin detyruar me forcë që të kryej ndaj secilit prej tyre *fellatio (seks oral)*. Fotografitë e viktimës pas incidentit tregonin maviosje në krahëror, si rezultat i një sasive të dhunës të ushtruar kundër saj gjatë incidentit. Përkundër aspekteve degraduese dhe pështëruese të rastit, viktimja nuk kishte pasur përfaqësues për të intervenuar, përpos babait të saj, i cili ishte përjashtuar nga gjykatëria gjatë dhënjes së dëshmisë nga viktimja. Gjatë dhënjes së dëshmisë dhe tërë kohës duke qarë, tre të pandehurit ishin ulur mjaft afër sa të ndërhyjnë gjatë dëshmimit duke e frikësuar gojarisht, dhe si rezultat u shkaktua një përlëshje në mes të djelmoshave dhe viktimës. Vetëm pas një kohe të kaosit total në gjykatore kolegji kishte qetësuar të pandehurit. Babai pastaj është kthyer për të dëshmuar se që nga incidenti viktimja ishte duke u mjekuar për probleme psikologjike. Tre të pandehurit ishin shpallur fajtor për tentim dhunimi të rëndë, dy prej të pandehurve ishin të mitur të rritur dhe ishin denuar me një vit heqje lirie ndërsa tjetrit i janë shqiptuar masat edukues.

(c) Përkrahja psiko-sociale për viktimat dhe mbrojtja e tyre

Këto raste gjithashtu shtojnë shqetësimet në lidhje me shërbimet e gatshme psiko-sociale dhe të mbrojtjes për viktimat e supozuara të dhunës seksuale. Krahas obligimit të autoriteteve për të garantuar se viktimja do të pranojë ndihmën e duhur mjekësore dhe psiko-sociale, gjendja psiçike e viktimës është e rëndësishme për procesin gjyqësor, për shkak se dëshmia e viktimës është pjesë kritike e dëshmive në këto raste. Procedura e tanishme kërkon që viktimja të jepë deklaratën në polici, para gjykatësit hetues dhe në seancë gjyqësore. Përkundër besueshmërisë së deklaratës së viktimës, ky proces mund të

¹ Neni 59 (1)&(2) i LPP të RFJ

rezultoj në traumatizim të përsëritur apo mund të ndikoj rëndë në reputacionin e viktimës në rrethin e saj. Shërbimet psiko-sociale, e poashtu masat mbrojtëse në raste të caktuara janë shumë të rëndësishme për viktimën e supozuar gjatë tërë procesit.

Në rastin e parë të përmendur më lart, pas dhunimit të pohuar viktimë kishte theksuar se ajo i kishte treguar nënës lidhur me dhunimin, se ishte munduar të bëjë vetëvrasje duke pirë deterxhent të lëngshëm dhe është dërguar më pas në spital. Gjatë dëgjimit hetimor, një dëshmitar kishte deklaruar se atij i është thënë se i ati i viktimës e kishte rrahur atë (viktimën) me shufër metalike dhe për atë shkak ajo kishte pirë atë lëng. As nga dëshmitari në fjalë e as nga i ati dhe e ëma nuk ishte kërkuar sqarim i këtyre rrethanave.

Në rastin tjetër të pohimeve të dhunimeve të shumfishta dhe një vrasje që përfshinte dy të pandehur, njëra prej viktimave të pohuara është një vajzë pesëmbëdhjetë vjeçare. Gjatë dëshmisë, viktimë e mitur filloi të shfaqë shenja të sëmundjes psiçike. Si rezultat i kësaj, dëshmia e viktimës kishte një shkallë të lartë të konfuzitetit dhe devijonte në mënyrë të konsiderueshme nga delarimet e mëhershme. Në një moment, viktimë kishte qeshur gjatë dhënjes së dëshmisë për dhunim nga njëri prej të pandehurve kur ajo kishte qenë në automjet me një shoqe të saj duke qeshur kurse tjetra duke qarë. Ajo gjithashtu kishte akuzuar nënën e viktimës së vrarë, shoqes së saj, për vrasjen e vajzës së vet e më pastaj deklaronte se ajo e kishte informuar nënën për vdekjen. Përkundër kësaj, dëgjimi i këtij dëshmitari kishte zgjatur më shumë se që është e nevojshme gjatë të cilit njëri prej gjykatësve profesional qeshte kur i parashtronte dëshmitarit pyetje jorelevante me ç'rast si duket ai zbavitej. Kjo viktimë e supozuar nuk ishte e shoqëruar në gjykatë as nga anëtarët e familjes së saj apo nga përfqësuesi ligjor.

Në rastin i cili potencialisht përfshinë çështje serioze të sigurisë, i përmendur më heret në këtë raport, gjashtë vajza (të moshave në mes pesëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë) kishin qenë të ngacmuara nga një grup i njerëzve të cilët kishin qenë anëtar të policisë ushtarake të UÇK-së (PU). Dy prej vajzave kishin pohuar se disa nga grupi kishin tentuar ti dhunojnë. Ata kishin thënë se nëse e paraqesin rastin, ato do të vriteshin. Edhe pse fillimisht, sipas policisë vajzat nuk kishin dëshirë të jepin deklaratat për shkak të sigurisë së tyre, më në fund ato kishin dhënë deklaratat. Përkundër faktit se prokurori ndërkombëtar kishte kërkuar arrestimin e menjëhershëm të dyshuarve me 16 nëntor 2000, prjesërisht për të mbrojtur vajzat, gjykatësi ndërkombëtar kishte dështuar të veprojë në këtë rast. Rrethat rënduese të këtij rasti frika e këtyre vajzave (viktimë dhe dëshmitare) për sigurinë e tyre duket se nuk ishte marrë në konsideratë nga ana e gjykatësit.¹

¹ Supozohet se ndërkohë disa prej vajzave kanë qenë të frikësuara.

PJESA 7: VIKTIMAT E DHUNËS FAMIJLARE

Hyrje

Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e viktimës së krimit, kërkojnë që shtetet duhet të sigurojnë një ndihmë të duhur viktimës gjatë procesit juridik. Një asistencë e tillë duhet të përmbajë një ndihmë materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale, përfshirë këtu edhe dhënjen e informatave viktimës, lidhur me sigurimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale dhe mundësimi i qasjes në to.¹ Që të garantohet kjo, policisë, drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimit social duhet ti ofrohet një “ trajnim që ti senzibilizoj ata përballë nevojave të viktimës, sikurse edhe udhëzime për të siguruar një ndihmë të shpejtë dhe adekuate.”² Këto standarde kërkojnë me tej që një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet kategorive të viktimave, përfshirë ato të cilat mund të jenë cak i diskriminimit për shkak të gjinisë, statusit familjar, moshës apo lindjes.

Më tepër, ekzistojnë standarde tjera të veçanta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që kanë të bëjnë me diskriminimin ndaj grave dhe të drejtave të fëmijëve, të cilat obligojnë UNMIK-un, të ndër marr masa më të gjëra kur personat brenda këtyre kategorive janë viktimë e veprimeve kriminale. Ato me tej obligojnë autoritetet që të ndër marrin të gjitha masat e përshtatshme që të sigurojnë që dhuna kundër grave të adresohet në mënyrë jo-diskriminuese dhe që fëmijët të mbrohen nga dhuna.

Meqenëse SMSJ, parimisht monitoron gjykatat e qarkut, ku vetëm disa raste brenda-familjare janë zgjedhur, incidentet e dhunës familiare në të gjitha gjykatat nuk janë shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Sidoqoftë, rastet e përmendura në këtë pjesë, si edhe rastet e tjera të monitoruara por jo të diskutuara, kanë ngritur shqetësime që kërkojnë kujdes.

Rezultati, nga rastet e monitoruara prej SMSJ-së, është që viktimat e dhunës brenda familjes, gratë dhe fëmijët, lihen pa mbrojtje apo shërim, në atë që veprimet kriminale kundër tyre mbeten ose plotësisht të pandëshkuara apo dënohen në mënyrë joadekuate. Rrjedhimisht, viktimat shpesh vendosen në pozitë kur është e domosdoshme të kthehen në shtëpitë në të cilat sjellja kriminale edhe me tej ushtrohet kundër tyre. Një përgjigje gjyqësore të këto raste kërkon një zhvillim urgjent të shërbimit social dhe mekanizma përkrahës që do të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe vendosjen e strukturave që do të mbështesin mirëqenien e grave në rastet e ndarjes së familjes. Duket se aktualisht një nga problemet më të rënda lidhur me këto raste është ai se organi shtetëror, i cili supozohet se duhet të ofroj ndihmë në rastet që përfshijnë dhunën brenda-familjare dhe mbrojtjen e fëmijëve, Qendra e Shërbimit Social, nën Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk funksionon si duhet në këtë drejtim.

¹ Deklarata e parimeve themelore e drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimi I pushtetit, në 14 dhe 15.

² Id. në par. 16

I. Dhuna ndaj grave në shtëpi

Standardet ndërkombëtare lidhur me diskriminimin gjinor, njohin që barazia *de jure* është e pamjaftueshme për mbrojtjen të drejtave të grave dhe kjo është e nevojshme të modifikoj praktikat sociale dhe paragjykimet shoqërore me qëllim të arritjes së barazisë së gruas me burrin. Rrjedhimisht, QSHMS obligon autoritetet të ndërmarrin masa të përshtashme “ të modifikojnë modelet kulturore dhe sociale të sjelljes së burrit dhe gruas, me qëllim të arritjes së eliminimit të paragjytimeve dhe zakoneve dhe të gjitha praktikave të cilat bazohen në idenë e inferioritetit apo superioritetit të njërit nga gjinitë apo të roleve stereotipe për burrin dhe gruan.” Sikur edhe me rastet e dhunimeve, rastet e dhunës brenda-familjare paraqesin vështirësi të veçantë për gjykatat sepse ato involvojnë çështje të koncepteve kulturore, zakonore dhe tradicionale të rolit të gjinive brenda familjes.

Në të gjitha komunitetet, praktikat zakonore dhe vlerat kulturore për gjykatat, policinë dhe institucionet e shërbimeve sociale, luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e pikpamjeve të tyre dhe trajtimin rasteve të dhunës brenda-familjare. Si rezultat, ngritja e vetëdijes dhe iniciativat trajnuese janë esenciale për adresimin e pikpamjeve zakonore dhe kulturore që ndikojnë në profesionistët që të konceptojnë dhunën kundër gruas në familje dhe, në veçanti abuzmin e fëmijut, si jo-penale.

(a) Ligji dhe ndjekjet

Ndryshe nga rastet e dhunës seksuale të përshkruara në seksionin e kaluar, këto raste përfshijnë sjelljen kriminale brenda familjes. Për shkak të kombinimit të kompletuar të shumë faktorëve, përfshirë edhe animin tradicional kundër gruas, dhuna në familje shpesh nuk shquhet si penale edhe pse aktet e njëjta në mes të panjohurve qartë do të shkaktonin vepër penale. Ekzistojnë tri manifestime të këtij problemi. Së pari, ligji mund të dështoj të inkriminoj veprimet mes anëtarve të familjes, për shembull ligji i zbatueshëm nuk sanksionon dhunimin brenda raporteve martesore. Së dyti, ligji mund të dështoj të sanksionoj veprimet e tilla në mënyrë adekuate. Së treti, policia, prokuroritë dhe gjykatat mund të dështojnë të akuzojnë aktet e tilla sipas ligjit apo mund ti trajtojnë ndryshe rastet për arsye se ato involvojnë dhunë brenda familjes.

Jo përshtatshmëria e ligjit vendor, si p.sh. mungesa e mekanizmave ligjor për mbrojtjen e viktimës nga dhuna, janë identifikuar dhe janë adresuar nga grupi punues për revidim legjislativ.³

³ Sidoqoftë, në shumicën e rasteve, kodi penal inkriminon veprimet e dhunës por në mënyrë joadekuate. Për shembull, akuza e “shkallës së parë” të lëndimit të lehtë trupor kërkon ndjekje private. Në raste të tilla kur kemi lëndim të lehtë trupor, disa të pandehur ndiqen për “ rrezikim e sigurisë” të LPK e cila është vepër nën jurisdikcionin e gjykatës komunale. Sidoqoftë, shumë raste të dhunës familjare gjykohen në gjykatën komunale për kundërvajtjeje cila nuk përfshin prokurorin publik, rol i cili mbron edhe me tej mbron interesin e viktimës, dhe parasheh dënime vetëm deri në 6 muaj burgim. Aspekti pozitiv i procedurës së kundërvajtjeve, në dritën e natyrës repetitive të dhunës familjare është se hetimet gjyqësore nuk kërkohen duke lejuar ndjekjen e menjëhershme.

Për shkak të faktit se ligji i zbatueshëm këtë çështje e adreson në mënyre jo adekuate, është vështirë të identifikohen rastet e akuzave të qëllimta të krimeve të tilla. Sidoqoftë, në një rast, në dhjetor 2000, burri pranoi para policisë se, derisa ishte në gjendje të dehur ai e kishte kapur për flokësh gruan e tij dhe e kishte larguar jashtë nga shtëpia, meç'rast e kishte therrur në bel, me thikë "flutur". Ai pranoi se kishte menduar se gruaja e tij mund të ishte e vdekur dhe ishte kthyer në shtëpi. Ditën e ardhshme ai shkoi vullentarisht në policinë e UNMIK-ut, të raportoj incidentin. Lënda ishte dorëzuar prej gjykatës së qarkut në gjykatën komunale, pasi që prokurori publik i qarkut refuzoi të akuzoj burrin për tentim vrasje. Prokurori publik komunal, kah fundi i shkurtit 2001, kërkoi hetime të mbështetura në akuzat e "shkaktimin e rrezikut". Kjo do të mund të duket, së paku, akuzë e "shkallës së dytë" lëndim i lehtë trupor me përdorim të armës, që kërkon ndjekje publike, apo "lëndim i rëndë trupor" që do të ishte më e përshtatshme në rastet të tillë.

Në rastet e monitoruara nga SMSJ, problemi parësor nuk është klasifikimi i veprës por që gjykatat dhe policia nuk janë në gjendje të zgjedhin aspektet komplekse të dhunës brenda-familjare. Mungesa e funksionimit të shërbimit social, ndikon seriozisht në aftësinë e gjykatave dhe të policisë që në mënyrë efektive dhe të duhur të hetojnë, ndjekin dhe dënojnë kryesisht e dhunës brenda-familjare.

(b) Rastet

Në rastet e dhunës familjare, gruaja përballet me një zgjedhje të vështirë ekstreme në mes prishjes së bashkësisë familjare klasike apo të vazhdimit të jetesës me dhunë. Për shkak të trysnisë familjare apo shoqërore sikurse edhe sigurisë, gratë mund të tërheqin deklaratat apo të kërkojnë që ndjekja të hudhet poshtë. Meqenëse nuk ka programe të posaçme të punës për këto gra dhe për shkak të mungesës së ndihmës sociale dhe asaj të strehimit, gratë të cilat dëshirojnë të braktisin burrat e tyre, është e kuptueshme se mund të hezitojnë. Ekzistojnë vetëm ca strehimore për gratë dhe fëmijët të cilët janë subjekt i dhunës familjare.

Si rezultat i mungesës së funksionimit të institucioneve të mirëqenies sociale, gjykatat dhe policia kanë luajtur një rol jo adekuat në këto raste. SHPK dhe policët ndërkombëtar sikurse edhe gjyqtarët kanë ndërmjetësuar rastet që kishin të bëjnë me dhunën familjare, qoftë përmes arritjes së pajtimit apo qortimit të burrit për shkak se gruaja tërheq deklaratën. Roli i gjyqtarve dhe i policisë në ballafaqimin me këto çështje duhet të definohet qartë. Në asnjërën nga rastet e monitoruara viktimat nuk kishin përfaqësues të mbrojnë interesat e tyre.

Gjykata për kundërvajtje

Gjykata komunale për kundërvajtje e Pejës kishte akuzuar burrin për kundërvajtje për shkak të rrahjes së gruas së tij. Në gjykim gruaja mezi ecte në dhomën e gjykimimit dhe duart dhe fytyra i ishin mavijosur rëndë si rezultat i incidentit. Incidenti kishte involvuar burrin i cili kishte ardhur në shtëpi herët në mëngjes i dehur, duke e rrahur gruan e tij dhe duke iu kërcënuar asaj me thikë me ç rast zgjoi nga gjumi katër fëmijët e tij (dy bineqë

dy vjeçar dhe njërin 6 dhe 9 vjeç). Burri i kishte rënë shuplakë vajzës nëntë vjeçare në gojë dhe e kishte dërguar atë në banjo dhe ajo ishte frikësuar aq shumë sa që ishte lagur në pantollonat e saj. Pas kësaj, ai e kishte dëbuar gruan nga shtëpia duke e kapur atë për flokësh. Burri e kishte vozitur atë me veturën e tij me një shpejtësi të madhe dhe pastaj e kishte gjuajtur atë jashtë nga vetura dhe iu kishte kërcënuar që do ta shkel me veturë. Gruaja kishte qëndruar jashtë tërë natën pa tesha derisa ajo u kthye në shtëpi në mëngjes.

Burri pranoi se e kishte rrahur gruan e tij por kishte mohuar se e kishte rrahur atë në veturë. Në mbrojtjen e tij, ai kishte pohuar se ajo ishte angazhuar në një aferë jashtëmartesore gjersa ata ishin duke jetuar në Gjermani.⁴ Gruaja deklaroi në një mori rastesh se ajo nuk mund të jetoj me burrin e saj dhe se kishin pasur “probleme” gjatë dhjetë vjetëve të kaluara. Gruaja kërkoi kujdestari për fëmijët e saj por ajo deklaroi se i duhet një vend të jetoj dhe pak asistencë që ta bëj këtë. Në kohën e gjyqimit, të katër fëmijët ishin duke jetuar me burrin. Gjyqtari e shpalli burrin fajtor dhe e dënoi atë me 30 ditë burgim dhe gjithashtu gjyqtari shprehu shqetësimin për mirëqenjen e fëmijëve me që ata ishin duke jetuar me babain. Nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejme për zgjedhjen e këtyre çështjeve. SMSJ, kishte vërejtur se polici i SHPK-së, i involvuar në këtë rast bënte përpjekje që të ndërmjetësoj pajtimin në mes gruas dhe burrit të saj. Mbi ankesën, gjykata e lartë për kundërvajtje e ndryshoi dënimin e mëparshëm në dënim me gjobë prej 400 DM (apo 13 ditë burgim në rast mosplotësimi) në bazë të asaj se i akuzuari, burri, ka jetuar me viktimën, gruan dhe kishin 4 fëmijë dhe se procesverbali pasqyrore se gruaja dhe burri me të vërtetë ishin pajtuar. Në ankesë, i akuzuari deklaroi se ishte bashkuar me gruan e tij dhe se nuk do ta përsëriste veprën. Deklarata e gruas e cila theksonte se nuk dëshiron të jetoj më tej me burrin e saj dhe ku shprehej brengosja e saj se ku do të jetonte ajo dhe fëmijët e saj, duket të mos ishin të njohura apo nuk ishin marrë parasysh nga ana e gjykatës së shkallës së dytë. Brenda dy muajve të këtij vendimi, gruaja përsëri raportoi para policisë, se burri i saj e kishte rrahur atë derisa ishte i dehur dhe e tëra kishte rezultuar me frakturën e krahut të saj. Raporti mjekësor vërtetoi lëndimet serioze të gruas. Burri përsëri u akuzua sipas ligjit për kundërvajtje dhe u dënua me 45 ditë burgim. Gruaja ka shprehur dëshirën e saj para policisë për shkurorëzim.

Gjykata komunale

Rasti në Prizren ka të bëjë me pohimet e gruas, se burri i saj e kishte maltretuar herë-pas here dhe se i kishte rrahur tre fëmijet e tyre (të moshës: tre, gjashtë dhe tetë) me rrip. Arrestimi i parë i burrit ndodhi më 11 Korrik 2000, katër ditë pas incidentit kur ai e grushtoi gruan e tij derisa ajo humbi vetëdijen dhe kishte rrahur fëmijët me rrip duke iu lënë shenja të lëndimeve në tërë trupin. Burri u akuzua për “lëndim të lehtë trupor” por akuzat u hodhën poshtë si rezultat i vërejtjes gjyqësore të dhënë nga gjyqtari. Si duket gruaja kishte kërkuar që burri i saj të lirohet.

Më 23 tetor 2000, gruaja deklaroi para policisë së UNMIK-ut, se në mesnatë burri i saj e kishte detyruar atë që e zhveshur të lëshoj shtëpinë duke e përduror thikën dhe e kishte kërcënuar ta vrasë. Ajo gjithashtu deklaroi se ky lloj i abuzimit kishte ndodhur për dhjetë vjet të martesës së saj. Burri u arrestuar përsëri për sulm ndaj gruas së tij. Më 31 tetor

⁴ Ka indikacione në këtë rast që burri i pandehur mund të ketë probleme psikologjike

2000, gruaja kishte shkuar në polici dhe kishte deklaruar se ajo e kishte falur burrin e saj dhe kishte kërkuar që ai të lirohet nga paraburgimi. Në ditën e njëjtë, burri ishte dëgjuar nga ana e gjykatësit hetues. Ai pranoi se e kishte rrahur gruan e tij dhe e kishte detyruar atë të braktis banesën. Ai shpjegoi më tej se e kishte ndëshkuar gruan e tij për shkak se ajo kishte folur me disa njerëz të tjerë në rrugë. Nuk kishte urdhër (vendim)për paraburgim.

Sipas policisë, gruaja ishte tërhjekur nga akuzat e saj për shkak të presionit të familjes së saj, përfshirë vëllaun e saj i cili i kishte thënë viktimës se ajo duhet ta dëgjoj burrin e vet dhe të mos largohet nga shtëpia, apo mos të flas me njerëz në rrugë. Siç raportohet babai i viktimës përkrahu pozitën se viktima duhet të tërheq akuzat dhe kinse kushëriri i burrit të saj i'u kishte kërcënuar asaj.

Më 1 dhjetor 2000, burri u shpall fajtor për “rrezikim të sigurisë” dhe u dënua nga gjykata komunale me tetë muaj burgim dhe i liruar me kusht. Aktgjykimi i gjykatës nuk përmend akuzat e mëhershme kundër burrit kur atij i'u kishte shqiptuar vërejtja gjyqësore.

Gjykata e qarkut

Rasti në gjykatën e qarkut në Pejë involvon vëllaun i akuzuar për tentim vrasje të motrës se vet, pas gjuajtjes me armë nga afërsia në fytyrë/supet e saj. Motivi i sulmit, sipas dëshmisë së vëllaut, ishte fakti se ajo nuk e kishte martuar të fejuarin e saj por ishte martuar me një djalë tjetër. Ai pohoi se veprimi i ndërrmarrë kundër motrës së saj ishte e drejtë e tij sipas zakonit.

Motra/viktima u informua se ajo nuk është e obliguar të dëshmoj sipas ligjit, por ajo u pajtua të dëshmoj. Sidoqoftë, ajo nuk mundi të flas dhe gjykatësi e lexoi deklaratën e saj dhënë para gjykatësit hetues. Ajo kishte deklaruar se nuk dëshironte që vëllaun i saj të dënohet nga gjykata. Raporti mjekësor i viktimës pohon se lëndimet e saj në supet janë permanente dhe se ajo nuk do të jetë në gjendje të përdorë krahun e saj.

Personi i vetëm tjetër të dëshmoj ishte bashkëshorti i viktimës, i cili kishte qenë viktimë në një rast të ngjashëm të gjykuar në të njëjtën gjykatë. Në këtë incident të ndarë, i fejuari i parë i vajzës dhe vëllezërit e tij u akuzuan për lëndim të rëndë trupor dhe posedim të paligjshëm të armëve, pasi që ata e kishin rrahur rëndë bashkëshortin e ri. Si rezultat i incidentit, burri kaloi rreth një muaj në spital. Gjatë asaj procedure, kryetari i kolegjit kishte kërkuar nga bashkëshorti që të pajtohet me të pandehurin në gjykimi e hapur. Si rezultat, të pandehurit u shpallën fajtor vetëm për lëndim të lehtë trupor dhe disa për posedim të paligjshëm të armëve por atyre u shqiptuan denime me kusht.

Vëllaun i cili e gjuajti motrën e tij në rastin, u shpall fajtor për lëndim të rëndë trupor dhe u dënua me 6 muaj burgim(përfshirë këtu edhe kohën e kaluar në paraburgim). Ai u lirua për tu mbrojtur në liri. SMSJ, u informua se kryetari i gjykatës kishte deklaruar se rasti u vendos në këtë mënyrë sepse ishte çështje familjare dhe se prokurori dhe mbrojtja ishin pajtuar lidhur me dënimin para seancës së gjykimit.

II. Nevoja për mbrojtjen e të miturve si viktimat të dhunës familjare

Shumica e rasteve të monitoruara të dhunës brenda-familjare, përfshin dhunën kundër fëmijëve. UNMIK-u ka obligim të ndërmarr të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës fizike dhe psikike, lëndim apo abuzim, braktisje, maltretim apo eksploatim, përfshirë abuzimin seksual.⁵ Autoritetet sikurse UNMIK-u kanë obligim të japin një prioritet të madh familjes dhe mirëqenjes së fëmijut.⁶ Në rastet e mungesës së ambientit familjar apo kur interesat e fëmijut tregojnë se fëmiju nuk duhet të mbetet në atë ambient, autoritetet duhet të sigurojnë përkujdesje alternative për fëmijët.

Sikurse në rastet e dhunës seksuale, vërehet qartë mungesa e mbrojtjesve për viktimat dhe mbrojtja e viktimave në rastet e dhunës brenda familjare të monitoruara nga SMSJ. Edhe pse LPP i RFJ, obligon pjesëmarrjen e Organit të kujdestarisë së QPS (nën Departamentin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale) në lëndët kundër të miturve, gjykatësit i kanë argumentuar SMSJ-së se në rastet e dhunës brenda-familjare ata nuk kanë nevojë të kyçin QPS. Kjo rrjedh nga fakti se, sipas *Ligjit për martesë dhe marrëdhënie familjare*, Organi i kujdestarisë është institucion përgjegjës për mbrojtjen e fëmijut (“që mbikqyrë të drejtën prindore”) dhe për rastet që kyçin mbikqyrjen e fëmijut. Duket se nuk ka ndonjë proces të rregullt me të cilin gjykatat apo prokurorët publik informojnë QPS për këto raste.

Zyrat e QPS të administruara nga KB, kanë mungesë të personelit, njohuri profesionale dhe resurse dhe ndonjëherë edhe gatishmëri për të përmbushur obligimet e tyre ligjore përkitazi me fëmijët. QPS, u është dhënë detyra e administrimit të programit për asistencë sociale, një rol të cilin këto qendra nuk e kanë pasur në sistemin e klauar. Edhe pse në fazën fillestare kjo ka ngarkuar disa QPS, udhëheqja e kësaj detyre tani ka filluar të stabilizohet. Në fushëveprim të këtyre qendrave është obligimi ligjor për të siguruarmbrojtjen e fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve profesionale sociale për të cilën ka nevojë për përmirësim dhe zhvillim përmbajtësor.⁷ Në rastet kur QPS është kyqur, ata kanë demonstruar një mungesë njohurie profesionale duke indikuar një nevojë substanciale për trajnim apo madje ndonjë reformë edhe më të rëndësishme. Mosefektiviteti i QPS dhe mungesa e agjensive për përkrahje viktimës, edhe më tej rëndon dështimet nga gjykatat dhe policia të trajtojnë këto raste në mënyrë më të duhur dhe me urgjencë të kërkuar. Është e qartë se rastet e abuzimeve të fëmijëve rrallëherë ndiqen penalisht. Tani, nuk ka alternativa të administruara për fëmijët të cilët janë pa familje apo të cilët janë objekt i abuzimit nga familjet e tyre.

⁵ Neni 36 I Konventës mbi të drejtat e fëmijëve

⁶ Neni 1 I *Deklaratës së parimeve ligjore dhe sociale lidhur me mbrojtjen dhe mirëqenjen e fëmijëve, me vështrim të veçantë tek zëvendësimi i ushqimisë dhe adoptimit kombëtar dhe ndërkombëtar, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/85(1986)*

⁷ Janë bërë përpjekje të rëndësishme në ndërtimin e kapaciteteve sa i përket stafit, pajisjeve dhe trajnimit të profesionistëve të QPS gjatë vitit të kaluar. Qasja momentale e Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është fokusuar në përmirësimin e trajnimit, mbikqyrjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikës së brendshme, procedurës dhe formulimin e protokolleve me organet tjera kyçe si policia, shkollat etj.

(a) Dështimi për të kyqur QPS në këto raste

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë dëgjoi rastin kundër një të pandehuri, nëntëmbëdhjetë vjeçarë, për marrëdhënje të paligjshme seksuale me një të mitur dhe tentim vrasje. Rasti kishte të bënte me një vajzë trembëdhjetë vjeqare e gjysmë, e cila raportoi se i pandehuri e ka detyruar, përmes kërcënimit se do t'i vriste vllazërit e saj, që të martohej me të. Edhe pse familjet e të dy palëve fillimisht nuk u pajtuan për këtë lidhje, ata ishin pajtuar dhe lidhja ishte pranuar si një martesë tradicionale përkundër faktit se vajza ishte nën vitet kur kërkohet pajtimi saj. Vajza jetoi një kohë me të pandehurin, por u kthye në shtëpinë e saj të mëhershme shumë herë.

Nëna e vajzës dëshmoi se ajo dhe anëtarët e tjerë të familjes e kishin rrahur vajzën për ta detyruar atë të kthehej tek i pandehuri pasiçë tani ishte “e martuar”. I pandehuri vërtetoi se ai kishte parë familjen e vajzës duke e rrahur atë dhe se ai kishte tentuar të intervenonte në mbrojtjen e saj. Nëna gjithashtu dëshmoi se vajza i kthehej familjes sepse i pandehuri e rrahte ate e nganjëherë edhe e mbyllte në shtëpi. Motra e të pandehurit dëshmoi, përkundër të drejtës që mos të bënte këtë, se njëherë e ka parë të pandehurin duke i rënë shuplakë vajzës kur ajo dual jashtë shtëpisë pa leje. Familja e vajzës më në fund vendosi që të mos e detyronte atë të kthehej tek i pandehuri. Konflikti midis dy familjeve rezultoi me therrjen disa herë të nënës së vajzës. I pandehuri deklaroi se vepra ishte në vetë-mbrojtje pasiçë nëna e kishte sulmuar atë me sopatë.

Gjykatës i ishte prezentuar një raport nga klinika neuropsikiatrike përkitazi me deklaratën e vajzës se ajo ishte në gjendje depresive. Përgjatë tërë procedurës, vajza nuk ishte përfaqësuar nga mbrojtësi i viktimës. Përkundër faktit se kishte prova, dëshmitë e nënës së saj, se kjo vajzë trembëdhjetë vjeqare ishte subjekt i abuzimit nga familja e saj (në pjesën e detyrimit të saj që t'i kthehet “bashkëshortit” të saj abuzues), gjykata nuk e kyqi QPS në këtë rast. Fakti se vajza dukej të jetë viktimë e abuzimit të vazhdueshëm dhe shtëpia e saj mund të mos ishte vendi më i përshtatshëm për të, nuk ishte marrë në konsiderim nga cilado palë, përfshirë gjykatën. I pandehuri ishte shpallur fajtor për të dy veprat dhe ishte dënuar me dy vite dhe nëntë muaj burgim.

(b) Obligimet ligjore të QPS dhe nevoja për trajnim dhe reformë

Rasti në Gjilan, ka të bëjë me veprat e shumëfishta të pohuara të incestit nga vllau më i vjetër njëzetë-e-tre vjeqar ndaj tri motrave të moshave trembëdhjetë, katërmëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë vjeqare. Që të tri motrat i raportuan policisë se ato ishin viktimat të veprës së incestit përfshirë përkëdheljet, seksin oral dhe marrëdhënje seksuale, më 12 tetor të v.2000. Vëllau i dyshuar ishte paraburgosur me 13 tetor 2000, për tetë ditë, kur u lirua nga paraburgimi dhe i'u lejua të kthehet në shtëpi, ku jetonin viktimat.

Gjatë dëgjimit të parë hetimor, dy motrat e reja ndryshuan deklaratat që i patën ofruar policisë. Dy vajzat i deklaruan gjykatësit hetues se paraprakisht vëllau ishte përpjekur t'i përkëdhelte ato, por jo për marrëdhënje seksuale. Ato më tej deklaruan se kan raportuar rrejshëm kundër tij, sepse ai i kishte rrahur andaj ato donin ta largonin atë nga shtëpia. Gjykatësi hetues nuk e sqaroi shkakun e papajtuësshmërisë me deklaratën e dhënë në

polici. Motra më e vjetër, e cila kinse kishte deklaruar në polici se ajo kishte qenë subjekt i veprës së incestit nga vllau i saj, nuk ishte ftuar të dëshmoj nga gjykatësi hetues në shkallë të parë. Ajo më vonë dha deklaratë të ngjashme si motrat e saj, para gjykatësit.

Më 19 tetor 2000, prokurori e ktheu lëndën tek gjykatësi hetues për hetime të mëtejme, posaqërisht, për dëgjimin e zyrtarëve të SHPK-së që kan intervistuar vajzat dhe vëllauin e tyre. Një zyrtar i SHPK-së deklaroi se tri vajzat i kan deklaruar asaj se ato ishin sulmuar seksualisht nga vllau i tyre, përfshirë edhe marrëdhënjet seksuale. Gjykatësi hetues nuk hetoi përkritazi me atë se pse tri vajzat ndryshuan deklaratat. Zyrtari tjetër i SHPK-së, i cili kishte marrë në pyetje të pandehurin, dëshmoi se vëllau ka pranuar se kishte abuzuar seksualisht të tri motrat.

Në deklaratën e vet dhënë gjykatësit hetues, vëllau mohoi se kishte patur marrëdhënie seksuale me ndonjërin prej motrave të tij, dhe raportoi se ato kishin fabrikuar tregimin sepse ai i kishte rrahur, pasi që ato dilnin jashtë për të kërkuar të holla. Sipas policisë, babai ishte nën hetime, në atë kohë, nga policia për vjedhje, shtrëngim ndaj tri vajzave që të vjedhin dhe kërkojnë të holla (“shkelje e obligimeve familjare”).

Përkundër këtyre rrethanave, gjykatësi hetues nuk e kyqi zyrtarisht Organin e kujdestarisë të QPS, e as që urdhëroi ndonjë vlerësim mjekësor apo psikologjik as të të pandehurit e as viktimave të pohuara.

QPS në Gjilan i raportoi SMSJ-së, se ishte kyqur në rast që nga 21 tetori. Ata deklaruan se jo-formalisht kanë monitoruar situatën në shtëpi, por ata kontestuan se atyre u duhej kërkesa formale e gjykatës apo e prokurorit për ndërmarrjen e veprimit zyrtar, përkundër mandatit sipas ligjit mbi familjen.

Më 21 shkurt 2001, gjykimi ishte caktuar dhe vëllau, i pandehuri, dhe vajza më e vjetër u paraqitën në gjykatë. Rasti ishte shtyrë për shkak se vajzat më të reja nuk u paraqitën. Dëgjimi ishte bërë në zyrën e vogël të gjykatësit. Edhe pse dukej se gjykatësi bënte hapa të veprimit senzitiv me rastin, ambienti dukej i vrazhdë ndaj vajzës më të vjetër e cila ishte ulur mu përballë vllaut të saj, i cili kinse e kishte abuzuar seksualisht.

Në atë kohë, u mbajt një diskutim për procesverbal. Babai u paraqit sikurse dhe përfaqësuesi i QPS. Babai deklaroi se nuk e dinte se ku ishin vajzat më të reja, pasi që ato ishin larguar nga shtëpia një natë më parë, dhe e pyeti gjykatësin se pse ishte ftuar për gjykim. Babai mbeti përfaqësuesi ligjor zyrtar i këtyre dy vajzave.

Pasiçë babai shkoi, përfaqësuesi i QPS, diskutoi rastin me gjykatësin duke deklaruar, efektivisht, se ajo nuk mendon se vajzat do të paraqiteshin në gjykatë përveq detyrohen nga babai i tyre, ose përmes rrahjes ose përmes kërcënimit se do të rrahen. Përfaqësuesi më tej i indikoi gjykatësit se ajo mendon se dy vajzat ishin të pasigurta dhe se ato “nuk kishin sjellje të mira”. Përfaqësuesi i QPS, paraprakisht ishte shprehur para SMSJ-së, se vajzat “nuk ishin të mira”.⁸

⁸ OSBE u informua që një konsultant ndërkombëtar së bashku me QPS dhe policinë ishin duke vizituar familjen rregullisht. Ata u informuan se me siguri vëllau kishte dalur nga shtëpia.

Gjykatësi pastaj e pyeti përfaqësuesin e QPS, për mendimin e saj lidhur me babain e vajzave. Ajo shkurtimisht deklaroi se babai ka insistuar që vajzat të paguajn vetë shpenzimet e tyre të jetës. Por ajo gjithashtu deklaroi se se babai ishte sjellur në mënyrë korrekte ndaj saj, si përfaqësuese. Dukej se përfaqësuesi kishte pak kuptim për rolin e saj apo obligimet ligjore. Nuk kishte indicje se përfaqësuesi ka marrë në konsiderim se modeli i sjelljeve të vajzave mund të ishte rezultat i mjedisit shtëpiak jo-adekuat.

Të tri vajzat nuk u paraqitën në gjykatë në datën tjetër të radhës për gjykim. Në dëgjimin e ardhshëm pasi që këto vajza kishin tërhequr deklaratat e tyre paraprake, ndjekja penale e këtij rasti është ndërprerë.

(c) Abuzimi i rëndomtë (si shprehi, ves) dhe koordinimi në mes policisë, gjykatave dhe QPS

Një rast ka të bëjë me një baba i cili është i dyshuar për abuzim të katër fëmijëve të tij (të moshës gjashtë, nëntë, njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë vjeçarë). Së voni, vajzat gjashtë dhe nëntë vjeqare, nga rruga janë marrë nga ana eKFOR-it, në ora 4:00 të mëngjesit. Nga vajzat është kërkuar të shetisin rrugës pasiçë babai I tyre refuzoi ti lente në shtëpi (më heret në ata mbrëmje). Lënda policore tregon se babai vijimisht i abuzonte fëmijët dhe ekzistonte mundësia për abuzim seksual të vajzës më të vjetër, dhe për atë ekziston raporti, që daton më 26 Dhjetor 1999.

Zyrtarët e SHPK-së, ishin prezent kur babai deklaroi se ka dashtë t'i prejë vajzat me sopatë dhe se ai nuk i dëshironte ato.⁹ Sipas raportit policor të UNMIK-ut, fëmijët janë marrë në rrugë 11 herë gjatë vitit të kaluar. Siç raportohet, të afërmit dhe fqinjët e babait ishin të frikësuar që t'i ofronin policisë informata apo që t'i mbajnë fëmijët. Si rezultat, sipas policisë, fëmijët kaluan shumicën e kohës nëpër rrugë pa kurfarë higjiene. Përkundër raporteve të ndryshme të policisë së UNMIK-ut për një abuzim për një periudhë të gjatë kohore të këtyre fëmijëve, policia e UNMIK-ut së voni ka përpiluar lëndën complete dhe i'a ka dorëzuar këto informata gjykatës.

Kryetari i Gjykatës Komunale i ka deklaruar SMSJ-së, se gjykata ka kontaktuar QPS, por se Qendra ka refuzuar të marrë rastin sepse të punësuarit kanë qenë të kërcënuar nga babai i dyshuar që të mos ndërmmarrin veprime përkitazi me kujdestarinë e fëmijëve. Është një shënim në dosje i cili pohon se drejtori i QPS, ka refuzuar të punoj në rastin sepse ai dhe kolegët e tij janë “ të frikësuar pasi që babai pengon punën e tyre e ne nuk jemi të mbrojtur nga policia”.

Më 14 shkurt 2001, babai nënshkroi një dokument në të cilin ai u pajtua të dorëzoj përgjegjësinë për fëmijët tek QPS. Meqenëse policia pohon se e kanë dërguar lëndën në gjykatën komunale-prokurorinë publike për procedime, përafërsisht një muaj më parë, prokurori publik thotë se nuk e ka pranuar lëndën. Procedimet penale nuk janë inicuar në

⁹ Ka indikacione se babai mund të vuaj prej sëmundjes mendore

këtë rast. Policia e UNMIK-ut aktualisht është duke zhvilluar hetime ndaj babait për vrasjen e nënës së fëmijëve, dy vite më parë gjatë shtatëzansisë së saj.

Policia e UNMIK-ut kohët e fundit kanë raportuar se janë duke gjetur një numër alarmues të foshnjave të vdekura. Në Mitrovicë, policia i deklaroi SMSJ-së se kishin gjetur tri foshnja të tilla brenda një periudhe dyjavore. Meqenëse është e pamundur të supozohen arësyet e këtij lloji të dukurisë, është e qartë se aktualisht në Kosovë nuk funksionon sistemi për mirëqenjen e familjes, përfshirë përkrahjen profesionale psiko-sociale si edhe politika sociale për punësimin adekuat/asistencës sociale të grave. Në veçanti, nuk ekzistojnë programe speciale për nënat e pamartuara, përfshirë akomodimet e përshtatshme si psh. shtëpitë. Me tutje, opcioni për vendosjen e fëmijëve për adoptim për nënat ekziston, por akoma nuk është rregulluar plotësisht apo përqaftuar nga komuniteti, ndërsa opcionet tjera si psh. kujdesi i fëmijës nga ndonjë familje(Foster) tjetër akoma nuk ekziston.¹ Kjo mungesë e shërbimeve vihet në kontekstin e shkallës së lartë të pohimeve të paraqitur para gjykatave lidhur me dhunën seksuale dhe dhunën tjetër të bazuar në gjini.

¹ Në Kosovë, shumë fëmijë janë adoptuar. Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i Misionit të Përkohshëm të KB, kanë lëshuar një Udhëzimi Administrativ mbi Adoptimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar 22/2000 i cili pjesërisht mundëson adoptimin ndërkombëtar si mjet i fundit. UNICEF dhe Departamenti i Shëndetësisë janë në proces të hartimit të një Udhëzimi të ri Administrativ në lidhje me adoptimin, e gjithashtu edhe në zhvillimin e një komisioni për rishikimin e procedurave të adoptimit. Departamenti i Shëndetësisë është duke konsideruar propozimin për realizimin e sistemit Foster të kujdesjes.

PJESA 8: KRIMET E LUFTËS DHE KRIMET ETNIKISHT TË MOTIVUARA PAANSHMËRIA E GJYKATAVE

Hyrje

Më 2 shtator 2000, 14 të burgosur kishin ikur nga burgu i Mitrovicës.¹ Të gjithë të burgosurit ishin serbë të Kosovës dhe ishin të akuzuar apo ishin nën hetime për krime lufte dhe për krime të motivuara etnikisht. Kjo pasoi para ikjes së shtatë të burgosurve, që të gjithë të akuzuar për krime lufte apo krime të motivuara etnikisht, për të cilat viktimat kanë qenë kryesisht Shqiptarët e Kosovës. Ikja e shtatorit sjelli një dënim publik, veçanërisht atë të bërë nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren i cili kërcënoi madje edhe se do të thërras grevë. Pesë nga të ikurit kishin qenë të akuzuar për krime lufte nga Gjykata e Qarkut në Prizren – përderisa dy prej tyre mbesin në paraburgim në pritje të gjykimit. Kryetari i Gjykatës i deklaroi mediave se “ne [gjykata] kemi mjaft dëshmitarë dhe dëshmi materiale dhe për këtë arsye të pandehurit duhet ti pranojnë gjërat”. Kompetencat ndaj burgut të Mitrovicës janë transferuar tani prej Policisë së UNMIK-ut në Administrimin Penal dhe sa dihet edhe masa të tjera të sigurisë janë shqiptuar. Më 26 shkurt 2001, një serb i Kosovës i quajtur *Dejan Slavic* i akuzuar për krime lufte, gjithashtu arriti që të ikë nga burgu pasi që ishte transferuar për në spital.

Pas aprovimit të *Rregullores së UNMIK-ut 2001/1 mbi Ndalimin me ligj të gjykimeve në mungesë të personave për shkelje të rënda të Ligjit Ndërkombëtar Humanitar*, gjyqet nuk kishin më pushtet që të mbajnë gjykimet në mungesë të personave të akuzuar për krime lufte apo vepra tjera penale. Si rezultat i kësaj, në fillim të vitit 2001, gjithsejt ishin 6 të pandehur të cilët ishin në paraburgim dhe në pritje të gjykimit për krime lufte, ku njëri prej të cilëve veç është duke u gjykuar. Kishte edhe dy të pandehur të tjerë të cilët ishin duke u gjykuar për gjenocid. Përpos këtij numri të kufizuar, problemet për shkak të burimeve të kufizuara dhe brengave të sigurisë ishin përkeqësuar edhe më shumë për shkak të dështimit për t'i udhëhequr gjykimet sensitive. Në janar dhe shkurt 2001 përaafërsisht nëntë raste të krimeve të luftës apo të krimeve të kryera me motive politike ishin të parapara të gjykohen. Shumica e këtyre rasteve mbrohen nga po i njëjti avokat serb, përderisa gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar janë zotuar që të marrin për sipër lëndët tjera, të njëjta me disa nga mbrojtësi serb.

Për momentin, ekzistojnë përaafërsisht mëse 20 individë të akuzuar apo që janë nën hetime për sa i përket krimeve të luftës dhe veprave të tjera penale (*Shih Shtojcën 1 Tabela mbi krimet e luftës dhe krimet e kryera me motive politike*). Në bazë të informatave me të cilat disponojmë, katër prej tyre veç gjenden në burg. Në vazhdim, ekzistojnë përaafërsisht 10 individë të akuzuar për vrasje me motive etnike/tentime vrasjesh. Raporti paraprak i SMSJ-së potencoi faktin se ekspeditimi i gjykimeve për krime lufte dhe krime të motivuara etnikisht, nuk kishte ndodhur në mënyrë të duhur për shkak të kapaciteteve ekzistuese dhe kompetencave të gjykatave.

I. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64

Në raportin e mëparshëm të SMSJ-së, është potencuar roli tejet i rëndësishëm të cilën e luajnë gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar në zbutjen e shqetësimeve për sa i përket paanshmërisë së gjykatave. Në kohën e përpilimit të këtij raporti, numri i prokurorëve ndërkombëtar ishte rritur prej dy në katër – një për Mitrovicë, një për Prishtinë, një për Prizren dhe një për Pejë. Numri i gjykatësve ndërkombëtar gjithashtu është rritur prej gjashtë në njëmbëdhjetë – dy për secilën prej pesë gjykatave të qarkut dhe një për Gjykatën Supreme të Kosovës.²

Dy shqetësime kritike kishin lindur në këtë drejtim për sa i përket gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar:

E para, është numri i kufizuar dhe ndarja sporadike e rasteve ka rezultuar me trajtim jo të barabartë të të pandehurve. Rastet e natyrës së ngjashme dhe me seriozitet (peshë) të njëjtë, duke përfshirë edhe të pandehurit dhe viktimat e ndryshme që vijnë nga rradhët e grupeve të ndryshme minoritare, kanë qenë të gjykuara para kolegjeve të gjykatësve me përbërje të përzier – disa me prezencë e disa pa prezencë ndërkombëtare.

E dyta, është se roli i luajtur, dhe ndikimi i gjykatësve ndërkombëtar është tejet i kufizuar (limituar). Në bazë të LPP të RFJ-së, aktgjykimet duhet të bihen me shumicë të votave, përderisa secili gjykatës ka të drejtë vote.³ Duke pasur parrasysh se kolegjet e gjykatësve gjatë gjyqimeve, janë në përgjithësi të përbëra nga dy gjykatësë profesional dhe dy porotë, raporti potencon se “distribuími i barabartë i pushtetit (fuqisë) votues të gjithë gjykatësve, në masë të madhe redukton seriozisht ndikimin që gjykatësit ndërkombëtar mund ta kenë në aktgjykimin e pruar për shkak të animeve të mbajtura me motive etnike.”⁴

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi Emërimin e Gjykatësve/Prokurorëve Ndërkombëtar dhe/apo ndërrimin e vendgjyimit, hyri në fuqi më 15 dhjetor të vitit 2000 e cila njëkohësisht kërkon që të adresohen problemet në fjalë. Arsyeja e cila qëndron prapa kësaj rregulloreje është sigurimi i një sistemi të përshtatshëm për ndarjen e rasteve të ndryshme personelit ndërkombëtar në mënyrë që të mundësohet që pushteti i cili i jipet gjykatësve ndërkombëtar të jetë i mjaftueshëm që së paku të përjashtojë animin gjyqësor (subjektiviteti).

Seksioni 1 i Rregullores në fjalë i’u jep prokurorëve kompetent, të akuzuarit apo avokatit të tij të drejtë për të parashtruar ankesë ndaj vendimit të Departamentit të Drejtësisë mbi emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar (ndarjen e lëndës gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar) kur një gjë e tillë është e nevojshme që të sigurojmë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë apo një administrim të drejtë të drejtësisë.

Në mungesë të një ankese të tillë, Departamenti për Drejtësi mund të veprojë me vet-iniciativë.⁵ Pas parashtrimit të ankesës së tillë, Departamentit të Drejtësisë i jipet pushteti që të marrë në rishqyrtim ankesën në fjalë dhe në bazë të saj t'i bëjë rekomandime PSSP-së, në mënyrë që ai të jap miratimin përfundimtar për sa i përket kësaj ankese apo edhe ta refuzojë atë.

Posa të jetë aprovuar kërkesa (ankesa) e tillë, kolegji mund të thirret në përbërje prej një prokurori ndërkombëtar, një gjykatësi hetues, apo të thirret kolegji i cili do të përbëhet nga tre gjykatës, duke përfshirë në përbërjen e saj së paku dy gjykatës ndërkombëtar ("kolegji i gjykatësve (trupi gjykues) nga *Rregullorja 64*").

Edhe pse nxjerrja e një Rregulloreje të tillë ishte mëse e mirëseardhur në atë kohë, në këtë kontekst mund të themi se ekzistojnë dy brenga kritike siç janë: e para, është se kriteret nuk janë finalizuar dhe nuk janë bërë të njohura për mbrojtës, e gjithashtu edhe sigurimi se rastet e natyrës dhe seriozitetit të njëjtë do të trajtoheshin njësoj, dhe e dyta, Rregullorja ndalon me ligj ndarjen e rasteve pasi që të ketë filluar gjykimi apo pasi që të jetë parashtruar ankesa.

Trajtimi jo i barabartë i të pandehurve

Si përgjigje ndaj raportit paraprak të SMSJ-së, Departamenti i Drejtësisë kishte deklaruar se "emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar ka reduktuar në mënyrë dramatike mundësinë e animeve që mund të ndodhin në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë." Ata vazhdojnë të thonë se "*gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar janë emëruar me qëllim që të ndëgjojnë rastet më sensitive, ato me prapavijë etnike,*" emërimet këto që sipas tyre vazhdojnë që të reduktojnë në mënyrë dramatike çfarëdo mundësie për anime gjyqësore siç është e paraqitur edhe me raportin e OSBE-së...."⁶

Departamenti i Drejtësisë i ka dëgjuar SMSJ-së të gjitha kërkesat në bazë të Rregullores 64. Gjithashtu, kohëve të fundit ka konfirmuar faktin se përderisa ato të mos posedojnë me ndonjë politikë apo ndonjë kriter të finalizuar për sa i përket refuzimit apo aprovimit të kërkesave në bazë të *Rregullores 2000/64*, kriter ky i cili është në përfundim e sipër dhe që ju ka shpërndarë mbrojtësve. Mungesa e çfarëdo kriteri të qartë dhe transparent në këtë aspekt në bazë të të cilave kërkesat e parashtruara pranohen apo refuzohen nënkupton faktin se avokati mbrojtës dhe/apo aplikantët e tjerë janë në pamundësi që të pregadisnin dhe të prezentojnë në mënyrë të përshtatshme bazat për një ankese të tillë. Disa raste të ngjashme me ato të cilat kanë pranuar kolegjin e gjykatësve të paraparë me *Rregulloren 64*, nuk janë marrur në konsideratë apo refuzuar në bazë të kësaj rregulloreje përpos faktit se ato përfshijnë rastet që për të pandehur kanë serbët e Kosovës për të cilët pohohet se kanë kryer vepra të rënda penale.

Më 12 janar 2001, avokati mbrojtës i *Radovan Apostoloviqit*, një Serb i Kosovës ky i cili është i akuzuar për krime të luftës, kishte parashtruar ankesën në bazë të drejtës e cila i jipet me *Rregulloren 2000/64*. *Apostoloviq*, së bashku me katër serbë të tjerë, pohohet se

ka plaçkitur dhe djegur shtëpitë e Shqiptarëve të fshatit Suvî Do, gjë që kishte rezultuar me zhvendosjen e popullatës shqiptare nga ai vend. Ankesa e parashtruar lind, përveç tjerash, edhe shqetësime për sa i përket paanshmërinë e gjykatave, dukuri kjo e cila më së miri dëshmohej me kohëzgjatjen e paraburgimit.⁷SMSJ, ishte informuar se gjykatësi ndërkombëtar ishte pyetur për mendim. Gjykatësi mendoi se nuk ka nevojë për ndonjë koleg të gjykatësve të paraparë me *Rregulloren 64*, për arsye se ajo kishte ndjenjen se gjykatësit vendor nuk do të vepronin në mënyrë të anshme. Departamenti i Drejtësisë e refuzoi këtë ankesë më 23 janar 2001. SMSJ, e ka të njohur faktin se Departamenti i Drejtësisë e ka parashtruar ankesën në fjalë me vet-iniciativë e cila ankesë është aprovuar.

Dejan Slavic është një Serb i Kosovës i akuzuar për krime të luftës në lidhje me pohimin për involvimin e tij në ekzekutimin e 23 Shqiptarëve në pranverë të vitit 1999. Më 17 janar 2000, avokati i tij mbrojtës kishte parashtruar ankesë në bazë të *Rregullores 2000/64*. Bazat në të cilat mbështetej kjo ankesë përfshinte edhe natyrën e veprës penale dhe gjasën se ka pasur një mungesë të paanshmërisë në këtë aspekt. Si në rastin e *Apostoloviqit* të përmendur si më lartë, kur ishte vënë kontakt me gjykatësin ndërkombëtar i cili mëpastaj kishte deklaruar se “mund të rregulloj çështjen me gjykatësit vendor” dhe se nuk ka nevojë për ndonjë koleg të gjykatësve si të paraparë me *Rregulloren 64*. Sipas informatave me të cilat disponon SMSJ-ja për momentin, ankesa në rastin *Slavic* ishte refuzuar dhe gjykimi pritet që të mbahet së shpejti i cili do të udhëhiqet nga trupi i gjykues i përbërë nga katër gjykatës Shqiptarë dhe një ndërkombëtar. *Dejan Slavic* arriti që të ik nga burgu më 26 shkurt 2001 dhe për momentin mbetet në arrati.

Avokati mbrojtës i *Stojan Jovanoviqit dhe Bogoljub Misiçit* kishte parashtruar ankesë për këta të dy në bazë të *Rregullores 64* më 10 janar 2001. *Jovanoviq dhe Misiç* paraprakisht kishin qenë nën hetime për krime të luftës, edhe përkundër faktit se më 1 shkurt 2001 *Jovanoviqi*, dhe më 5 shkurt 2001 *Misiçi*, ishin të akuzuar për sulm serioz mbi një grup Shqiptarësh të gjinisë mashkullore gjatë v.1999. Duket se nuk është pruar asnjë vendim për sa i përket ankesës së bërë në këtë drejtim.

Në janar të vitit 2001 gjykimi i *Igor Simiqit* udhëhiqej nga trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Prizren. *Simiqi* është i akuzuar për gjenocid, ku përveç të tjerash ai akuzohet edhe për vrasjen e pohuar të 26 burrave Shqiptarë në Mitrovicë. Ndjekja penale e rastit në fjalë udhëhiqet nga një prokuror ndërkombëtar, përderisa procesi gjyqësor udhëheqet nga trupi gjykues i përbërë nga një gjykatës ndërkombëtar dhe katër gjykatës të tjerë Shqiptarë. Në pajtim me LPP të RFJ-së, pas 30 ditë të ndërprerjes së procesit gjyqësor ai kishte rifilluar përsëri. Prokurori dhe gjykatësi ndërkombëtar e kishte përkujtuar avokatit mbrojtës të drejtën për ankesë në bazë të *Rregullores 2000/64* ankesë kjo e cila kërkon ndryshimin e përbërjes së trupit të gjykues duke kërkuar që shumica e trupit gjykues të përbëhet nga gjykatës ndërkombëtar. Edhe përkundër natyrës dhe përmbajtjes së aktakuzës, mbrojtja refuzoi që të parashtronte kërkesë në këtë drejtim, dhe për këtë shkak procesi gjyqësor vazhdoi që të udhëheqet nga i njëjti trupi gjykues. Nuk ishte vërejtur se

ishite parashtruar ankesë nga ana e ndonjë gjykatësi apo prokurori ndërkombëtar apo nga vetë Departamenti i Drejtësisë.

Qasja e kufizuar e Rregullores

Seksioni 2(4) i Rregullores pamundëson krijimin e trupave gjykues të parapara me *Rregulloren 2000/64* në momentin pasi që procesi gjyqësor të ketë filluar, apo pamundëson parashtrimin e ankesës pasi që gjykata e shkallës së dytë të ketë filluar punën e saj. Fakti i cili i arsyeton këto dispozita është se procedurat gjyqësore të parregullta mund të rregullohen nëpërmjet të ankesës apo mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Kufizimet në fushëveprimin e qasjes së *Rregullores 2000/64* mund të reduktojnë efektivitetin e saj dhe ndikimin që ato mund ta kenë në rastet e caktuara. Dëshmitë për animet gjyqësore dhe shpërdorimet e ndryshme do të lindin mjaft shpeshtë nga këto procedura gjyqësore, të cilat si rrjedhojë do të kenë vendimet e marrura mbi pranueshmërinë e dëshmimeve, vendimet mbi zgjatjen apo ndërprerjen e paraburgimit, apo për trajtim të padrejtë. Për më shumë, zgjatja e intervenimit të personelit ndërkombëtar në këtë drejtim, ankesa e cila është në proces e sipër apo ndonjë mjet tjetër i jashtëzakonshëm juridik i cili pret zgjidhje, mund të rezultojë në një zgjatje të gjatë dhe të panevojshme të paraburgimit.

Rasti i *Momçilo Trajkoviçit* na siguron një shembull të brengosjes për sa i përket *Rregullores së UNMIK-ut 2000/64*. *Trajkoviçi* ishte arrestuar dhe burgosur më 7 shtator të vitit 1999 dhe që nga ajo kohë ishte mbajtur në paraburgim gjer më tani. Më 21 shtator 2000 kundër tij ishte ngritur aktakuza për krime të luftës nga Gjyqi i Qarkut në Gjilan.

Trajkoviçi ngarkohej me dy vepra penale; një për tentim vrasjeje dhe posedim të paligjshëm të armëve ndërsa tjetra për krime të luftës. Aktakuza e parë pohonte se *Trajkoviçi* kishte hapur zjarr me AK 47 mbi një grup të meshkujve Shqiptarë të cilët ishin duke e ngritur flamurin Shqiptar, sulm i cili për pasojë kishte një të lënduar. Pas dy muajve, gjatë një bastisjeje në shtëpinë e tij të udhëhequr nga KFOR-i ishin gjetur një numër i armëve dhe një sasi e caktuar e municionit.

Aktakuza për krime të luftës pohon se, ndërmjet 24 majit 1999 deri në hyrjen e forcave të KFOR-it në Kosovë, *Trajkoviçi* kishte keqpërdorur pozitën e tij zyrtare si shef i policisë në Kamenicë me qëllim të urdhërimit, planifikimit dhe kryerjes në baza sistematike të vrasjeve, zhvendosjeve të popullsisë, marrjen e pengjeve, dënimeve kolektive, plaçkitjeve dhe shkatërrimeve të pronave. Pohohet se gjatë asaj kohe *Trajkoviçi* kishte përpiluar një listë të personave më eminent të asaj ane dhe kishte urdhëruar ekzekutimin e tyre. Aktakuza vazhdon me specifikimin e një numri të shembujve të vrasjeve, plaçkitjeve dhe zjarrvënieve të cilat kishin ndodhur me urdhër të *Trajkoviçit*.

Gjykimi i *Trajkoviçit* kishte filluar më 23 nëntor të vitit 2000, i cili udhëheqej nga një trup gjykues i përbërë nga katër gjykatës Shqiptarë dhe një ndërkombëtar. Ndjekja penale udhëheqej nga një prokuror publik Shqiptar. Gjatë procesit gjyqësor, prokurori publik

kërkoj që së paku nga ana e tij të ketë mundësi që të zhvillojë rastin nën akuza të krimeve të luftës në bazë të mendimeve të dëshmitarëve. Edhe përkundër vërejtjes së avokatit mbrojtës, e cila pasoi pas një mori thëniesh të bëra nga ana e dëshmitarëve, Kryetari i trupit gjykues, një gjykatës ndërkombëtar, i lejoi prokurorit publik që ta pyes dëshmitarin “sipas mendimit tuaj (ku në një rast ai përmendi “dhe sipas mendimit të njerëzve të Kosovës”) ku qëndron marrëdhënia ndërmjet të pandehurit dhe viktimës dhe vdekjes së tij?” Dëshmitarët përgjithësisht u përgjegjën: “i pandehuri kishte dhënë urdhërin për vrasjen e viktimës, për shkak se asgjë nuk ka mundur të bëhet pa urdhërin dhe dijeninë e tij.” Kryetari i trupit gjykues shpjegoi mëpastaj se trupi gjykues do t’i merr parasysh dëshmitë dhe deklaratat e dëshmitarëve, mirëpo rëndësi më të vogël (peshë më të lehtë) do të kenë deklaratat e dhëna “sipas mendimit”. Gjatë ekzaminimeve (shqyrtimeve) në fjalë, përpjekje fare të vogla ishin bërë si duket për sa i përket sqarimit të bazave të mendimeve të dëshmitarëve. Edhe përkundër faktit se kjo dëshmi kishte vlerë të dyshimtë dhe se do të kishte mundësi që të krijojë (shkaktojë) paragjykime tek anëtarët e trupit gjykues, veçanërisht tek gjykatësit porot, ishte e pamundur që të parashtrohej kërkesa për trupin gjykues të përbërë sipas *Rregullores 64* gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në fjalë.

Më 6 mars 2001, *Trajkoviqi* ishte liruar prej disa pjesëve të akuzës përderisa ishte shpallur fajtor për disa të tjera në kuadër të aktakuzës së ngritur kundër tij për krime të luftës. Ai gjithashtu ishte shpallur fajtor për posedim të paligjshëm të armëve dhe për tentim vrasjeje dhe si rezultat i kësaj atij i ishte shqiptuar dënimi me 20 vjet burg. Për sa i përket dënimeve të shqiptuara në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me krime të luftës (të cilat aktgjykimi i kualifikon ato si krime kundër njerëzimit), aktgjykimi i shkruar i cili i identifikon veprat e ndryshme penale për të cilat ai ishte shpallur fajtor, me një përjashtim, përfundon se këto vepra penale janë kryer nga “policë” apo “forca policore”. Nuk ka ndonjë dëshmi e cila e ndërlidhë përfshirjen e të pandehurit me njëren prej këtyre krimeve specifike. E vetmja vepër penale e cila pretendon të ketë “lidhje të drejtpërdrejtë” me involvimin e *Trajkoviqit* në të është hapja zjarr ndaj një burri. Në këtë kontekst, viktimia paraprakisht kishte deklaruar se atij ia merrte mendja se i pandehuri e kishte urdhëruar hapjen zjarr ndaj tij. Më vonë ai e ndryshoi dëshminë e tij (deklaratën), duke deklaruar se personi që kishte gjuajtur me armë i paskësh thënë atij se ai ishte duke operuar në bazë të urdhërave të të pandehurit.

II. Rasti i Lulzim, Bajram dhe Agim Gashit

Vëllezërit e nacionalitetit rom *Lulzim, Bajram dhe Agim Gashi* (“*Gashët*”) ishin arrestuar dhe burgosur nga KFOR-i më 7 nëntor 1999. Më 20 tetor 1999, vendimi i parë për zgjatjen e paraburgimit ishte marrur në atë kohë duke e zgjatur paraburgimin e tyre edhe për një muaj. Sipas dosjeve të Gjykatës Supreme, më 8 janar 2000 Gjykata Supreme zgjati paraburgimin e “*Gashëve*” deri më 8 mars 2000, respektivisht 8 korrik 2000. Më 8 korrik 2000, duke vepruar në bazë të *Rregullores së UNMIK-ut 1999/26*, Gjykata Supreme zgjati paraburgimin edhe për një kohë deri më 8 tetor 2000, datë kjo e cila shënon fundin e periudhës kohore prej 12 muajve të paraburgimit të *Gashëve*.

Më 13 tetor 1999, KFOR-i kishte dërguar dosjen mbi rastin “*Gashët*” prokurorit publik në Gjyqin e Qarkut në Prizren. Më 18 tetor 1999, prokurori publik bëri kërkesën për

fillimin e procedurës hetimore kundër *Gashëve* për vepra penale të krimeve të luftës. *Agim Gashi* e kishte dhënë deklaratën e tij para gjykatësit hetues më 19 tetor 1999. *Lulzim dhe Bajram Gashi* e kishin dhënë deklaratën e tyre para gjykatësit hetues më 20 tetor 1999.⁸ Seanca të dëgjimit të cilat inkuadronin edhe dhënien e dëshmimeve nga 8 dëshmitarë, ishin mbajtur më 8,9 dhe 23 nëntor të vitit 1999.

Zgjatjet e paarsyeshme të procedurës hetimore

Në bazë të procesverbalit të rastit në fjalë, erdhëm në përfundim se seanca e dëgjimit e fundit e mbajtur gjatë procedurës hetimore të inicuar kundër *Gashëve*, ishte mbajtur më 23 nëntor 1999. Pas thujtjes 11 muajsh të mosveprimit në këtë aspekt, më 6 tetor 2000, gjykatësi hetues e kishte përcjellur dosjen e rastit në fjalë zyres së prokurorit publik në Prizren.⁹ Prokurori publik mëpastaj parashtroi kërkesën, në bazë të nenit 174(2) të LPP të RFJ-së për zgjatjen e periudhës kohore të nevojshme për ngritjen e aktakuzës dhe për paraburgimin e *Gashëve*. Neni 174(2) i LPP-së së RFJ-së e cila ka të bëjë me zgjatjen e periudhës kohore për pregaditjen e akuzës, mirëpo nuk jep baza të mjaftueshme ligjore për sa i përket zgjatjes së paraburgimit.

Prokurori publik citon se “*vëllimi i procesverbalit së rastit dhe koha e shkurtë për pregaditjen e akuzës*” janë arsytet e tija kryesore për parashtrimin e kërkesës në fjalë. Kërkesa për zgjatjen e periudhës kohore të nevojshme për ngritjen e aktakuzës dhe për zgjatjen e paraburgimit ishte pranuar, po të njëjtën ditë kur ajo ishte parashtruar nga ana e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Gjykatësi hetues gjatë atij rasti theksoi se zgjatja e tillë, së paku pjesërisht, buron nga dështimi i Tribunalit Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë për t’u përgjegjur ndaj kërkesës për zbulimin e dëshmisë (hapjen e procesverbalit për rastin në fjalë). Ai gjithashtu deklaroi se policia e UNMIK-ut nuk i ishte përgjigjur kërkesës për informata që kanë të bëjnë me “deportimin e Shqiptarëve dhe plaçkitjen e shtëpive të tyre.”

Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë ka përpiluar udhëzime (direktiva) specifike në bazë të të cilave Prokuroria mund t’ju sigurojë organeve përkatëse në Kosovë, për rastet përkatëse, material i cili është i rëndësishëm për zhvillimin e procedurës hetimore si dhe zhvillimin e rasteve penale për të mirën e ndjekjes penale. Udhëzimet (Direktivat) përkatëse në mënyrë mjaft të qartë bëjnë me dije se çdo kërkesë duhet të parashtrohet me shkrim në të cilën kërkesë gjithashtu duhet specifikuar natyra e materialit i cili kërkohet si dhe natyra e lëndës dhe gjithashtu edhe zona gjeografike të cilës ajo kërkesë i referohet. Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë bën me dije se ata nuk kanë pranuar ndonjë kërkesë, qoftë në formë të shkruar apo me gojë, për sa i përket rastit “*Gashi*”.

Policia e UNMIK-ut kishte informuar SMSJ-në se ata nuk përzihen në rastet që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe andaj nuk posedojnë me informata në lidhje me këtë rast.

Ligji vendor

LPP e RFJ-së nuk përmban kufizime kohore për sa i përket përfundimit (kompletimit) të procedurës hetimore. Edhe përkundër faktit se me këtë Ligj nuk parashihet ndonjë kufizim kohor në këtë drejtim, është mëse e qartë se shikuar në bazë të nenit 190(2) të LPP të RFJ-së, kur i pandehuri gjendet në paraburgim, “zgjatja e paraburgut duhet të reduktohet në kohën më të shkurtër të nevojshme. Është detyrë e të gjitha organeve që marrin pjesë në procedurën penale dhe e organit që ofron ndihmë juridike, të veprojnë me urgjencë të posaçme kur i pandehuri gjendet në paraburg.”

Ligji Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut

E drejta në gjykim brenda një kohe të arsyeshme është e garantuar me nenin 5 (3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo përputhet me të drejtën e cilë është më e përgjithësuar dhe parashihet me nenin 6(1) të po të njëjtës Konventë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka hasur në shkelje të ndryshme të nenit 5(3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet kur kemi zgjatje të periudhës kohore e cila përshkohet me një mosveprim nga ana e organeve përkatëse në këtë drejtim. Në rastin *Toth kundër Austrisë*, rast ky me një kornizë kohore të ngjashme me atë të rastit *Gashi*, Gjykata kishte përfunduar se periudha e akumuluar kohore prej 11 muajve e mosveprimit (gjendjes inerte) në këtë drejtim rezultoi me shkelje të kërkesave për kryerje të shpejtë të procedurës në fjalë, të cilat rrjedhin nga neni 5(3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁰

Duke pasur parrasysh përgjigjen e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë dhe në mungesë të detyrimit dhe arsyeve drejtë të bazuara, periudha kohore prej 11 muajsh mosveprimi (gjendje inerte) e cila arriti kulminacionin e vet, më 6 tetor 2000, me rastin e prezentimit të lëndës “*Gashët*” Zyres së Prokurorisë së Qarkut në Prizren, është i paarsyetueshëm. Kërkesa e parashtruar nga ana e prokurorit publik për sa i përket vëllimit të lëndës gjyqësore dhe kohës së shkurtër për të pregaditur aktakuzën është tërësisht jo-adekuate për mënjanimin e mungesës së ekspedivitetit të drejtë në ngritjen e aktakuzës apo në tërëhjekjen nga aktakuza para 24 tetorit të vitit 2000. Këto shqetësime vulosen si dhe përkeqësohen edhe mëtej për shkak të faktit se lënda në fund ishte hedhur poshtë për shkak të mungesës së dëshmive. SMSJ-ja nuk e ka të njohur faktin se a kanë pranuar “*Gashët*” ndonjë kompenzim për shkak të paraburgimit të tyre të paligjshëm apo për procedurën e gjatë hetimore.

III. Gjykimet për krime të luftës dhe krime etnikisht të motivuara

Shaban Beqiri dhe Xhamajl Sejdiu

Gjykimi i *Shaban Beqirit dhe Xhamajl Sejdiut* i cili filloi më 25 korrik 2000. Të pandehurit, që të dytë Shqiptarë të Kosovës, ishin të akuzuar për vrasje të dy Serbëve të Kosovës në korrik të vitit 1999. Ndjekja penale udhëheqej nga një prokuror publik Shqiptar, përderisa trupi Gjykues përbëhej nga katër gjykatësë Shqiptarë dhe një ndërkombëtar.

E veja e njëres prej viktimave kishte dhënë dëshminë në cilësinë e dëshmitarit okular për vrasjen e burrit të saj dhe viktimës tjetër. Ajo i identifikojë pozitivisht të pandehurit për involvimin e tyre në vrasjen në fjalë, së bashku me dy meshkuj tjerë të panjohur. Në deklaratat e saja të dhëna para KFOR-it Amerikan, ajo gjithashtu kishte deklaruar se *Beqiri* ka pasur të veshur një fanelë të verdhë, përderisa të tjerët kishin të veshur fanela të zeza. Ajo gjithashtu i siguroi KFOR-it Amerikan një letër, me nënshkrim të zotit *Beqiri* (si kapetan i UÇK-së), me të cilën bëhej me dije se ai kishte kërkuar dorëzimin e armëve me të cilat ato mund të dispononin, duke u kërcënuar edhe me përdorim të forcës. Raporti i përpiluar nga KFOR-i Amerikan ishte gjithashtu i bashkangjitur procesverbalit të gjyqit. E bija e viktimës së dytë gjithashtu dëshmoi në gjyq në cilësinë e dëshmitarit okular në lidhje me vrasjet në fjalë, dëshmia e së cilës ishte në përputhje me dëshminë e parë. Edhe pse avokati mbrojtës parashtronte pyetje të shpeshta për sa i përket letrës në fjalë, gjykata nuk e bënte një gjë të tillë. Nuk kishte ndonjë dëshmi mjeko-ligjore të prezentuar në këtë rast.

Të pandehurit ishin liruar mëpastaj më 24 tetor 2000. Prokurori publik dhe/apo trupi gjykues dështuan që të shqyrtojnë (ekzaminojnë) rrethanat përshkuese të rëndësisë që e paraqet fakti se në kohën e kryerjes së vrasjes *Beqiri* kishte të veshur fanelën e verdhë, fakt të cilin e deklaruan edhe dëshmitarët okularë. Në bazë të raportit të KFOR-it Amerikan, *Beqiri* kishte të veshur fanelë të verdhë në momentin e arrestimit, arrestim ky i cili ndodhi vetëm pak kohë pas vrasjes. Prokurori publik dhe/apo trupi gjykues gjithashtu dështuan që të ekzaminojnë (shqyrtojnë) autenticitetin (mirëfillësinë) dhe origjinën e letrës të cilën pohohet se e ka përpiluar *Beqiri* me të cilën ai iu kërcënohet viktimave. Këto dëshmi ndoshta do të kenë mundur që të sigurojnë një vërtetim (pohim) të rëndësishëm për dëshminë e dhënë nga dëshmitarët okular dhe do të kenë formuar një pjesë mjaft të rëndësishme të këshillimit (marrjes së vendimit) gjyqësor.

Sava Matiq

Sava Matiq ishte arrestuar dhe paraburgosur më 27 dhjetor 1999 në baza të dyshimit se ka kryer krime të luftës. Tetë dëshmitarë ishin intervistuar gjatë zhvillimit të procedurës hetimore. Tre prej dëshmitarëve ishin në pamundësi që të sigurojnë dëshmi të drejtëpërdrejta për veprat penale të kryera nga *Matiqi*. Një dëshmitar deklaroi se ai e kishte parë *Matiqin* më 27 mars 1999 në fshatin Krushë e Madhe, së bashku me tre zyrtar të tjerë të policisë. Po në këtë ditë në atë fshat thuhet të ishin vrarë 42 persona. Dëshmitari vazhdoi me deklaratën e tij duke pohuar se 4 persona kishin arritur që ti

shpëtojnë kësaj masakre. Asnjëri prej këtyre personave nuk ishte thirrur për të dëshmuar dhe gjithashtu nuk ishte dhënë kurrfarë shpjegimi se pse ata nuk ishin thirrur. Gjithashtu edhe një dëshmitar tjetër dëshmoi të ketë qenë i sulmuar nga ana e policisë serbe në shtator të vitit 1998. Ai e njohu *Matiqin* duke e identifikuar si njërin i cili ishte prezent gjatë atij sulmi. Ai gjithashtu vazhdoi për më tepër duke thënë se në bazë të asaj çka kishte ndëgjuar nga popullata, *Matiqi* lavdërohej për vrasjen e mëse 60 personave.

Një dëshmitar Shqiptar gjithashtu siguroi dëshmi të mjaftueshme se kishte dëgjuar se *Matiqi* kishte sulmuar dy burra Shqiptarë në maj 1999. Dëshmitari ishte i informuar për sa i përket atij sulmi nga një bashkëfshatar i viktimës, përderisa asnjëri prej tyre nuk ishte thirrur për të dëshmuar.

Një dëshmitar tjetër i cili dëshmoi kundër *Matiqit* deklaroi se ai (*Matiqi*) vinte me policë të tjerë në fshatin e tij për ti keqtrajtuar njerëzit e atij fshati përderisa gjatë një rasti ai ia kishte vjedhur 100 DM. Një dëshmitar tjetër deklaroi se në një datë të paspecifikuar në vitin 1999, *Matiqi* e kishte rrahur atë së bashku me dy bashkëfshatarë të tij. Dëshmitë nuk ishin marrur prej këtyre personave tjerë.

Më 26 maj 2000 gjykatësi hetues në një rast ia kishte besuar ndërmarrjen e veprimeve hetimore policisë së UNMIK-ut. Më 24 korrik 2000, shefi i Njësisë Qëndrore Hetuese në kuadër të Policisë së UNMIK-ut i kishte shkruar një letër gjykatësit hetues duke cituar se vetëm një dëshmitar ishte në gjendje që ta identifikojë *Matiqin* gjatë foto-identifikimit dhe se identifikimi në fjalë nuk ishte i besueshëm (qëndrueshëm).

Kundër tij (*Matiqit*) ishte ngritur aktakuza më 11 shtator 2000, për krime të luftës. Gjykimi filloi më 22 janar 2001 para trupit gjykues të përbërë nga dy gjykatës ndërkombëtar dhe një Shqiptar. Ndjekja penale udhëheqej nga një prokuror Shqiptar. Aktakuza përmban pohime të përgjithshme për aktivitete kriminale të shkallës së gjerë duke përfshirë këtu, përveç të tjerash edhe atë se “*Matiqi* i zbatonte urdhërat me përpikëri për sulmin e civilëve të pambrojtur, kishte kryer vepra penale të torturës dhe sjellje johumane, kishte marrur pengje, kishte burgosur njerëz në mënyrë të paligjshme dhe i kishte dërguar ata me forcë që të punojnë, kishte shkatërruar në mënyrë të paligjshme dhe vjedhur pronat e ndryshme dhe atë në shkallë mjaft të gjerë pa ndonjë arsytim ushtarak...” Aktakuza vazhdon dhe flet se *Matiqi*, si një nënoficer, kishte marrur pjesë edhe në masakrën e 42 civilëve të Krushës së Madhe më 26 mars të vitit 1999, gjithashtu edhe në rrahjen, keqtrajtimet fizike dhe psikike të fshatarëve të Potoqanit të Ulët.

Rolin kryesor gjatë zhvillimit të aktakuzës e kishin lujatur tre të mbijetuarit (“X, Y dhe Z”) e masakrës e cila pohohet të ketë ndodhur në Krushë të Madhe. Dëshmitari X paraprakisht deklaroi se nuk ishte i sigurtë se a ishte me të vërtetë *Matiqi* i përzier në atë masakër. Në një numër të rasteve, megjithatë, personit X, i shin prezentuar fotografitë e *Matiqit* dhe pasi që ishte konsultuar me të mbijetuarit e tjerë të masakrës - ku që të gjithë kishin deklaruar se *Matiqi* ishte në krye të njësisë policore e cila i kishte kryer ato vrasje. Kryetari i trupit gjykues (gjykatës ndërkombëtar) pasi që kishte bërë presion mbi dëshmitarin që të përgjegjet qartë po ose jo në lidhje me përzierjen e *Matiqit* në ato vrasje, dhe pasi që personi X, kishte vazhduar të pohoj se nuk ishte i sigurtë, ai

(gjykatësi) kishte kërkuar që të regjistrohet në procesverbal se dëshmitari kishte refuzuar që të përgjegjet në pyetje.¹¹

Dëshmitarët Y, dhe Z, ishin thirrur nga ana e palës ndjekëse për të vërtetuar dëshminë e personit X. Dëshmia e dhënë nga ana e dëshmitarit Y, ndryshonte në masë mjaft të madhe prej deklaratës së tij të dhënë gjatë procedurës hetimore të zhvilluar nga policia dhe KFOR-i. Gjatë këtyre intervistave, personi Y, kishte identifikuar edhe një person tjetër të kishte qenë në krye të policisë gjatë kryerjes së masakrës në fjalë. Gjatë gjykimit personi Y, deklaroi se tani ishte i sigurtë se udhëheqësi i masakrës ishte *Matiqi*. Dëshmitari nuk ishte marrur në pyetje për sa i përket kësaj kundërthënjeje. (mospërputhje). Në fakt, gjykatësi ndërkombëtar anëtar i trupit gjykues i cili mëpastaj u ballafaqua (përballua) me dëshmitarin Z, duke deklaruar në mënyrë të paqëndrueshme se “Çka do të thuashit nëse unë ju them që dëshmitari tjetër në këtë rast ka thënë se [një person tjetër] ishte udhëheqës i njësisë policore në fjalë? Përgjegjja “Nuk di asgjë për këtë.” Dëshmitari Z, gjithashtu deklaroi se *Matiqi* ishte oficer komandues i asaj njësie policore e cila e kishte kryer masakrën. Gjatë hetimeve në polici, personi Z, nuk ishte i sigurtë se a ishte *Matiqi* i involvuar në atë masakër në rradhë të parë apo jo. Gjatë gjykimit, megjithatë, ai deklaroi se ai ishte i sigurtë për atë pasi që e pa *Matiqin* në gjyq.

Një dëshmitar tjetër deklaroi se ai (*Matiqi*) ishte ai i cili ia kishte drejtuar revolen dhe gjithashtu kishte ndëgjuar se *Matiqi* ishte i përzier në vrasjen e tre djemoshave 17 vjeçar, mirëpo ai me sytë e vet nuk e kishte parë *Matiqin* drejtëpërdrejtë të kishte vrarë dikë. Një dëshmitar tjetër gjithashtu tha se nuk posedonte me informata për sa i përket *Matiqit* dhe duket të ishte thirrur për të dëshmuar për një rast tjetër.

Tre dëshmitarët e tjerë dhanë dëshmi për sa i përket sulmit i cili ishte kryer nga *Matiqi* dhe një polic tjetër në një vreshtë gjatë vitit 1999. Një person tjetër i cili foli në cilësinë e dëshmitarit okular, pohoi të kishte përjetuar vetë sulmin në fjalë. Asnjëri prej këtyre dy dëshmitarëve të mbetur nuk e kishte parë drejtëpërdrejtë *Matiqin* duke e kryer atë vepër, mirëpo ata deklaruan se atyre iu ishte thënë për involvimin e *Matiqit* në atë incident. Gjatë mbylljes së procesit gjyqësor, deklaratat e dhëna nga dy dëshmitarët në fjalë ishin lexuar si pjesë e procesverbalit. Njëri prej tyre deklaroi se *Matiqi* kishte ardhur në fshatin Potoqani i Ulët në një datë të paspecifikuar dhe kishte filluar që t’i maltretojë njerëzit e atij fshati. Në një rast dëshmitari pohon madje se edhe ishte plaçkitur nga ai (*Matiqi*). Dëshmitari tjetër nuk siguroi dëshmi tjera për sa i përket rastit *Matiq*, mirëpo dha komente të përgjithshme për sa i përket faktit se fshati Potoqan i Ulet ishte djegur dhe plaçkitur nga serbët.

Gjatë fjalimeve mbyllëse prokurori publik dorëzoi fjalimin e shtypur në tre faqe trupit gjykues dhe vetëm i përsëriti ca detaje në lidhje me atë rast. Avokatit mbrojtës nuk i ishte siguruar kopja e fjalimit në fjalë dhe për këtë arsye ai ishte në pamundësi që të sigurojë se fjalimi përmbante një përmbledhje të dëshmimeve të pranueshme dhe relevante.

Matiqi nuk u shpall fajtor për krime të luftës me vendimin e pruar me shumicë të votave, mirëpo u shpall fajtor për shkaktim të lëndimeve të lehta trupore gjatë sulmit i cili

pohohet të ketë ndodhur më 23 Prill 1999 në një vreshtë të atij fshati. *Matiqi* u dënua me dy vjet burg. Në shkelje të LPP së RFJ-së, gjykatësi Shqiptar i trupit gjykues nuk ishte prezent gjatë leximit të aktgjykimit.¹²

Pas aktgjykimit në fjalë, një artikull i Agjencisë Frans Presse citonte se gjykatësi Shqiptar i trupit gjykues të ketë thënë se vendimi për të mos shpallur fajtor Serbin e akuzuar për pjesëmarrje në ekzekutimin e 42 Shqiptarëve etnik të Kosovës është “një vendim absurd, një maskaradë.” Ai vazhdoi të thoshte se “Drejtësia Kosovare ka dështuar....ka pasur dëshmi të mjaftueshme për ta dënuar atë për krime të luftës.” Ai (gjykatësi) ishte i “dëshpruar me vendimin e marrur nga ana e dy gjykatësve ndërkombëtar anëtar të trupit gjykues, për të mos shkuar për një dënim i cili do ta shpallte atë (*Matiqin*) fajtor për krime të luftës...”¹³

Afrim Xheladini

Më 23 Janar 2001, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan filloi gjykimi i *Afrim Xheladinit*. Veprimet hetimore për sa i përket akuzave të ngritura kundër tij u ndërmorrën nga ana e një gjykatësi ndërkombëtar, para se të hynte në fuqi *Rregullorja 2000/64*. Në bazë të informatave me të cilat disponon SMSJ-ja në këtë drejtim, në pajtim me *Rregulloren 2000/64*, një gjykatës ndërkombëtar e informoi Departamentin e Drejtësisë për sa i përket rastit në fjalë mirëpo përgjigja ishte se rasti nuk është mjaft serioz për të kërkuar trupin gjykues me përbërje ashtu si të paraparë me *Rregulloren 2000/64*. Si rezultat i kësaj, trupi gjykues përbëhej nga gjykatësi Shqiptar i cili vepronte në cilësinë e Kryetarit të trupit gjykues dhe nga dy gjykatës porot gjithashtu të nacionalitetit Shqiptar. Ndjekja penale udhëheqej nga një prokuror publik gjithashtu i nacionalitetit Shqiptar.

Më 19 Dhjetor 2000 në bazë të nenit 157 të Ligjit Penal të Kosovës u ngrit aktakuza kundër *Xheladinit* për “Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm”. Aktakuza pohon se më 20 Tetor 2000, *Xheladini* kishte gjuatur dy granata dore në lokalitë të një Serbi në Viti. Tre serbë të Kosovës u lënduan gjatë kësaj, përderisa dëmi i shkaktuar arrinte vlerën përafërsisht deri në 10,000 DM. Ushtarët e një patrolle të KFOR-it Amerikan e cila po kalonte andej pari ishin dëshmitar të rastit gjatë së cilës ata edhe e arrestuan *Xheladinin* në afërsi të vendit të ngjarjes. *Shtëpia e Xheladinit* u bastis mëpastaj gjatë së cilës u gjetën mëse 9 granata, një numër i siguresave dhe plumbave, së bashku me 400g të eksplozivit TNT. *Xheladini* refuzoi të ketë kryer atë vepër penale duke pohuar se ishte gjendur aty pari në afërsi të vendit të ngjarjes në momentin kur eksplozimi kishte shpërthyer.

Xheladini, i cili u arrestua më 20 Tetor 2000, ishte mbajtur në paraburgim në Gjilan deri më 24 Janar 2001 kur kryetari i Trupit gjykues edhe e kishte pruar vendimin mbi lirimin e tij.

Ndëgjimi i të pandehurit

Gjatë ndëgjimit të pandehurit, kryetari i trupit gjykues mori në pyetje të pandehurin në mënyrën e cila shkonte në favor të mbrojtjes së tij. Gjykatësi nuk e mori në pyetje atë për sa i përket dallimeve ndërmjet dëshmisë së tij të dhënë para gjyqit dhe deklaratës së dhënë para gjykatësit hetues.

Thirrja në gjyq e dëshmitarëve serb

Më 23 Janar 2000, gjykimi ishte shtyer për arsye të mosardhjes së dëshmitarëve Serb. Në proceverbale ishte futur gjithashtu edhe kërkesa për ndjekjen e seancës gjyqësore nga ana e këtyre dëshmitarëve. Njëri prej këtyre dëshmitarëve ishte arritur që të kontaktohet në Viti. Ai informoi OSBE-në se kishte refuzuar që të ndjek seancën e dëgjimit për shkak se duhej të qëndronte para një trupi gjykues të përbërë nga Shqiptarët. Dëshmitarët e tjerë ndodhën në Serbi.

Dështimi për ti informuar Dëshmitarët e KFOR-it Amerikan

Nëntë dëshmitarë të KFOR-it Amerikan ishte dashur që të ndjeknin seancën gjyqësore më 24 Janar 2001. Këta dëshmitarë janë me rëndësi kritike për lëndën e prokurorit publik për arsye se ishin dëshmitar okular në momentin kur ndodhi sulmi me granata dhe gjatë arrestimit të të pandehurit në afërsi të vendit të ngjarjes. Ekziston një kontest në këtë aspekt se a ka kërkuar në të vërtetë gjyqi pjesëmarrjen e këtyre dëshmitarëve gjatë seancës së dëgjimit.

Më 23 Janar 2001 u kontaktua edhe KFOR-i Amerikan për sa i përket përmbushjes së paralajmërimit të kërkuar. Këshilltarët juridik të KFOR-it Amerikan bënë me dije se ata nuk kishin pranuar kurrfarë informata për sa i përket datës se kur do të mbahet gjykimi. Më 24 Janar 2001, tetë dëshmitarë të KFOR-it morën pjesë në seancën gjyqësore.

Trajtimi i dëshmitarëve të KFOR-it dhe procesverbali e gjykimit

Përkundër faktit se kemi të bëjmë me shtyerje të seancave gjyqësore më 23 Janar 2001 me qëllim që të merreshin në pyetje dëshmitarët e KFOR-it më 24 Janar 2001, kryetari i trupit gjykues nuk kishte bërë gati përkthimet e deklaratave të dëshmitarëve në fjalë. Ndihmësja e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut ishte detyruar që të përkthejë në atë rast. Kryetari i trupit gjykues zhvilloi një seancë agresive të dëgjimit gjatë së cilës dëshmitarët e KFOR-it iu nënshtruan një intervistimi (hetimi) të hollësishëm të ashtuquajtur kryqëzor, gjatë së cilës ai dukej disi i nervozuar nga deklaratat e dëshmitarëve në fjalë.

Në një mori rastesh kryetari i trupit gjykues parafranoi disa prej seksioneve të deklaratave të dhëna nga ana e dëshmitarëve të KFOR-it në një mënyrë që shkonte në dobi të të pandehurit. Kryetari i trupit gjykues nuk arriti që të përkthejë deklaratat në gjuhën angleze me qëllim që ato të vërtetohen nga ana e dëshmitarëve. Parafrazimi u bë në atë mënyrë ashtu që të ketë mundësi të paraqiten disa pjesë të procesverbalit të seancës

gjyqësore si të pasakta, rezultatet e së cilës do të mund të minojnë çfarëdo rishqyrtimi të ardhshëm të rastit në fazën e apelacionit (në shkallë të dytë).

Lirimi i të pandehurit nga paraburgimi

Më 23 janar 2001 ishte emëruar prokurori publik pra në ditën e gjykimit gjatë së cilës ai nuk posedonte kopje shtesë të procesverbalit të rastit. Gjatë procedurës gjyqësore, ai nuk morri në pyetje të pandehurin për sa i përket mospërputhjes së disa deklaratave të tij të dhëna para gjykatësit hetues (sa i përket lokacionit ku janë gjetur armët dhe emrave të viktimave). Në fund të procedurës gjyqësore prokurori publik kërkoi zgjatjen e paraburgimit për të pandehurin.

Më 24 Janar 2001, prokurori publik i cili kishte përpiluar aktakuzën mori përsipër rastin në fjalë. Në fund të procedurës gjyqësore, avokati mbrojtës kërkoi që i pandehuri të lirohet deri në përfundimin e gjykimit. Kjo kërkesë u pranua edhe nga ana e prokurorit publik, ku mëpastaj kryetari i trupit gjykues urdhëroi lirimin e tij. Gjykimi ishte shtyer për një datë të pacaktuar.

Zoran Stanojeviq

Zoran Stanojeviq ishte arrestuar dhe burgosur më 14 gusht 1999. Më 9 shtator 1999, filloi procedura hetimore kundër tij për sa i përket pohimeve për kryerje të veprës penale të vrasjes dhe tentim vrasjes. Vetëm dy dëshmitarë ishin thirrur gjatë zhvillimit të procedurës hetimore në fjalë. Këta dëshmitarë deklaruan se *Stanojeviq* ishte njëri prej policëve të cilët kishin marrur pjesë në sulmin kundër fshatit Raçak më 15 janar 1999. Të dy dëshmitarët deklaruan se *Stanojeviq* kishte hapur zjarr kundër tyre gjatë së cilës këta dëshmitarë kishin pësuar lëndime. Ata vazhduan për më tepër duke deklaruar se *Stanojeviq* ka hapur zjarr kundër një burri Shqiptar gjatë së cilës edhe e ka vrarë atë.

Dita e parë e gjykimit, 25 korriku 2000, ishte shtyer për një ditë tjetër për arsye të mospjesëmarrjes së dëshmitarëve.

Dita e tjetër e gjykimit ishte caktuar për 24 janar 2001. Pas parashtrimit me sukses së kërkesës të paraparë me *Rregulloren 2000/64*, rasti në fjalë i ishte dorëzuar një gjykatësi ndërkombëtar gjatë së cilës seanca gjyqësore udhëheqej nga trupi gjykues i përbërë nga dy gjykatësë ndërkombëtar dhe një Shqiptar. Gjatë kësaj seance gjyqësore i pandehuri dëshmoi gjatë së cilës ai kundërshtoi pohimet në fjalë, duke kërkuar vërtetimin e alibisë për këtë gjë. I biri i viktimës ishte thirrur gjithashtu për të dëhmuar. Ai deklaroi se më 16 janar 2001, ai kishte gjetur trupin e pajetë të të atit të tij në oborrin e një shtëpie të zbrazët. Ai gjithashtu arriti që të takohej me dy dëshmitarët e tjerë të cilët i thanë atij se e kishin parë se si një polic i quajtur "*Zoran*" ia kishte vrarë të atin. Ai deklaroi se në atë ditë dëshmitarët kishin pasur lëndime në këmbë dhe krahëror. Dëshmitari në fjalë nuk arriti që të sigurojë dëshmi të cilat parashohin involvimin e drejtëpërdrejtë të *Stanojeviqit* në kryerjen e asaj vrasjeje.

Më 24 janar 2001, trupi gjykues kërkoi dëshmi mjeko-ligjore, deklarata të dëshmitarëve dhe dokumente të tjera nga ana e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë për sa i përket akuzës në fjalë me të cilën ngarkohet *Stanojeviqi*. Rasti ishte shtyer për një ditë tjetër në pritje të përgjigjes nga ana e Tribunalit Ndërkombëtar për Krime Luftë për Ish-Jugosllavinë dhe për shkak të faktit se atë ditë kishte reduktime të energjisë elektrike në objektin e gjykatës. Përkundër faktit se *Stanojeviqi* kishte kaluar mëse 17 muaj në paraburgim dhe se 8 muaj kishin kaluar që nga dita kur ishte ngritur aktakuza kundër tij – asnjë kërkesë zyrtare nga prokurori publik e as nga gjykatësi hetues nuk i ishte bërë Tribunalit Ndërkombëtar për një dëshmi të tillë.

Më 6 Shkurt 2001, përfaqësuesi ligjor i dy dëshmitarëve propozoi që të inicojë padi private kundër të pandehurit për vepër penale të vrasjes, e cila duhej ti bashkangjitej seancës kryesore. Në kohën e ngrirtjes së aktakuzës, prokurori publik dështoi që të lëshoi deklaratën e kërkuar për tërheqjen e aktakuzës (akuzës) për vepër penale të vrasjes në shkelje të LPP-së së RFJ-së.

Më 20 shkurt 2001, përfaqësuesi ligjor i dy dëshmitarëve të rastit prezentojë një akuzë të freskët në emër të dëshmitarëve si palë të dëmtuara. Akuza në fjalë pohon se *Stanojeviqi*, i cili në atë kohë vepronte në cilësinë e policit, kishte vrarë një burrë Shqiptar dhe kishte tentuar që t'i vrasë edhe dy dëshmitarët në fjalë. Gjykimi vazhdon.

Stojan Jovanović dhe Bogoljub Misić

Stojan Jovanović dhe Bogoljub Misić ishin arrestuar dhe burgosur më 31 Janar 2000, në baza të dyshimit se kishte kryer krime të luftës.

Në mes të 3 shkurtit 2000 dhe 12 dhjetorit 2000 njëmbëdhjetë dëshmitarë ishin marrur në pyetje për sa i përket akuzave në fjalë. *Jovanović dhe Misić* mbetën në paraburgim edhe gjatë zhvillimit të procedurës hetimore.

Më 24 maj 2000, u kërkua nga policia e UNMIK-ut që të ndërmerr veprime hetimore në këtë drejtim. Më 27 maj 2000, hetuesi i policisë së UNMIK-ut përpiloi një memorandum në të cilën pohonte se prej nëntë dëshmitarëve të marrur në pyetje vetëm njëri prej tyre ishte në gjendje që ta identifikojë *Jovanovićin* si person i cili ka qenë i përzier në një sulm mbi grupin e meshkujve Shqiptar, sulm ky i cili kishte ndodhur në vitin 1998. Pohohet se edhe Misiçi të kenë qenë prezent gjatë sulmit. Në bazë të Memorandumit të dërguar gjykatësit hetues, të datës 18 qershor 2000, Zëvendës Komandant pranë Njësisë Qëndrore të Hetimeve të policisë së UNMIK-ut, person i cili është përgjegjës për hetimet në kuadër të policisë, përfundoi se “nuk ekziston ndonjë dëshmi e cila bën me dije për faktin se *Stojan Jovanović* ka qenë i përzier në krimet për të cilat akuzohet dhe për të cilat ngarkohet.” Ai vazhdon më tutje duke deklaruar “Unë do të kërkojë që gjyqi të urdhërojë menjëherë lirin e *Stojan Jovanovićit* nga paraburgimi dhe që akuzat me të cilat ngarkohet të tërhiqen.” Prokurori publik ndërkombëtar edhe zyrtarisht u tërheq nga akuza për krime luftë me të cilat ngarkohet personi në fjalë, më 12 shkurt 2001.

Në shkurt 2001, megjithatë, kundër *Jovanovićit dhe Misiçit* u ngrit aktakuza për pjesëmarrje në një bashkim të personave i cili kishte rezultuar me dhunë, arrestime dhe

burgosje të paligjshme dhe shkaktime të lëndimeve të rënda. Përkundër faktit se procedura hetimore kishte kaluar nëpër periudhën njëmbëdhjetë muajshe, prokurori publik citon në aktakuzë se, “Pasi që të përfundojmë me rishqyrtimin e tërësishëm të lëndës së rastit, duke përfshirë këtu edhe raportet e policisë dhe tërë dosjen gjyqësore, do të propozohen edhe dëshmitarë të tjerë në këtë drejtim.” Për momentin nuk disponojmë me të gjithë materialin përkatës (të gjitha raportet), do të mund që të mos disponojmë me të gjitha dëshmitë e kërkuara gjatë procedurës hetimore dhe nuk disponojmë me kopje të lëndës së plotë gjyqësore. Ngritja e aktakuzës është e domosdoshme në këtë drejtim për shkak të kohëzgjatjes 1 vjeçare të procedurës hetimore, andaj ngritja e aktakuzës është bërë duke u bazuar në një numër të kufizuar të informative me të cilat disponojmë.”

Komandanti “X” i TMK-së

Më 20 gusht 2000, një Komandant “X” i TMK-së së bashku me truprojen e tij pohohet të kenë marrur pjesë në sulmin i cili si pasojë kishte thyerjen e kafkës në anën e viktimës. Në bazë të informatave me të cilat disponon SMSJ-ja, ekziston një numër i dëshmitarëve okular të cilët e kishin parë incidentin.

Truproja e tij u gjykua dhe u shpall fajtor për vepër penale të sulmit dhe në bazë të kësaj u dënua me 30 ditë burg. Rasti i “X-it” u transferua në gjyqin për kundërvajtje dhe gjithashtu gjyqi lëshoi thirrjen për gjyq të personit X me të cilën ai duhej të paraqitej në gjyq më 4 shtator 2000. Personi X në fakt u paraqit në atë datë. Duke marrur parasysh seriozitetin e lëndimeve të pësuar nga ana e viktimës, rasti iu dorëzua zyres së prokurorit publik të gjyqit komunal të Mitrovicës për shqyrtim. Rasti në fjalë për momentin ndodhet tek një prokuror publik ndërkombëtar. Edhe përkundër faktit se personi për të cilin supozohet të ketë qenë bashkëpjesëmarrës në sulm është shpallur fajtor dhe se kishte një numër të dëshmitarëve okular të cilët e kishin parë incidentin, procedura hetimore kundër personit X nuk është inicuar ende dhe për këtë arsye nuk është caktuar data e gjykimit të tij. Një zyrtar i UNMIK-ut konfirmoi faktin se UNMIK-u kishte penguar autoritetet e rendit publik për të arrestuar personin në fjalë përkundër kërkesave të bëra nga ana e prokurorit publik ndërkombëtar. Në dritën e fakteve të cilat bëjnë me dije se X së paku ishte paraqitur për seancën dëgjuese më 4 shtator 2000, megjithatë është e paqartë se përse nevojitet urdhëri për arrestim (fletëarresti) në këtë aspekt. Nuk ekziston ndonjë arsye e cila na shtien të dyshojmë se a do të paraqitet i dyshuari në gjyq apo jo nëse thirret për këtë gjë.

IV. Padrejtësitë në të kaluarën: Statusi i ankesës/rishqyrtimit

Rasti Momçiloviq

Më 8 gusht 2000, Gjykata e Qarkut në Gjilan vendosi që të liroj tre meshkujt Serb të Kosovës, *Miroljub*, *Boban* dhe *Jugoslav Momçiloviq* nga akuzat për vrasje dhe tentim vrasje, ku viktimat thuhet të kenë qenë Shqiptar të Kosovës. Ata ishin shpallur fajtor për posedim të paligjshëm të armëve gjatë së cilës ata u dënuan me 12 muaj burgim.

Kryesore për rastin në fjalë ishte video inçizimi i vendit të ngjarjes në të cilin shiheshin disa persona të armatosur të cilët i afroheshin pronës së *Momçiloviqëve* gjë që paraqiste një përkrahje për mbrojtjen në vetëmbrojtje. Mbrojtja përkrahet (forcohet) edhe më shumë nëpërmjet të dëshmisë së dhënë nga disa ushtarë të KFOR-it të cilët arritën në vendin e ngjarjes të cilët pranorin se e kishin mbytur personin për të cilin thuhet se e kishin vrarë *Momçiloviqët*. Kjo dëshmi, megjithatë nuk doli në dritë deri në pjesën e dytë të gjykimit (procesit gjyqësor) në korrik të vitit 2000.

Më 16 gusht 2000, SMSJ, nxjerri një raport të quajtur “*Drejtësia në gjykim: Rasti Momçiloviq,*” e cila ngërthen në vete një katalog të shkeljeve të të drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë këtu edhe paanshmërinë në gjyq. Kjo përfshin edhe pohime serioze për sa i përket zgjatjeve të paraburgimit dhe ndjekjet penale qëllim keq. Këto shqetësime ishin gjithashtu të përsëritura edhe në tetor të vitit 2000 në Shqyrtimin e SMSJ-së për Sistemin e Drejtësisë Penale.¹⁴

Gjer më tani, asnjë procedurë hetimore nuk është inicuar për sa i përket pohimeve mbi kryerjen e veprave penale nga ana e dëshmitarëve të akuzës (palës akuzuese), duke përfshirë këtu edhe komplotin për kidnapim, tentim vrasje, posedim të paligjshëm të armëve apo betim të rrejshëm. As UNMIK-u gjer më tani nuk ka inicuar ndonjë procedurë hetimore për sa i përket pohimeve për shpërdorimet e bëra nga ana e zyrtarëve gjyqësor.

Në të vërtetë, *Nebi Asllani*, i cili ishte qëlluar nga KFOR-i Amerikan, në lidhje me këtë incident ishte paditur në **gusht 1999** për tentim vrasje të tre ushtarëve Amerikan të KFOR-it. Ai ishte liruar nga paraburgimi në dhjetor 1999. Nuk është caktuar më data e gjykimit për këtë rast.

Pyetja se pse dëshmitë e dhëna nga ana e ushtarëve të KFOR-it nuk kanë dalur në dritë deri në fazën e vonshme të procedurës gjyqësore mbetet pa përgjigje në këtë aspekt, edhe pse në bazë të informatave me të cilat disponon SMSJ-ja, Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve ka përfunduar hetimet e brendshme të tyre për sa i përket kësaj çështjeje.

Një ankesë kundër lirimit të *Momçiloviqëve* ishte inicuar nga ana e prokurorit publik. Kjo ankesë ndodhet tani për shqyrtim në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Besim Berisha

Më 20 mars 2000, *Besim Berisha* ishte liruar, nga ana e trupit gjykues të përbërë prej gjykatësve shqiptar, nga akuzat për vrasje të një mashkulli të përkatësisë etnike serbe.

I pandehuri ishte identifikuar gjatë një identifikimi të bërë nga ana e dy anëtarëve të familjes së viktimës. Ata ishin të pranishëm në momentin kur kishte ndodhur vrasja. *Berisha* gjithashtu pranoi para shokut të tij të burgut se e kishte kryer vrasjen në fjalë. Gjatë gjykimit, *Berisha* ngriti mbrojtjen e alibisë dhe e thirri shokun e tij të burgut si njërin prej dëshmitarëve të alibisë. Ai deklaroi se, në momentin e caktuar, gjendej në

paraburgim në burgun e KFOR-it italian në Pejë. Prokurori publik dhe gjyqi dështuan që të ndërmerr veprime hetimore adekuate rreth rastit në fjalë dhe dështuan që të zbulojnë faktin se alibija në fjalë ishte e pavërtetë. KFOR-i informoi SMSJ-në se regjistrat e paraburgut, i ishin siguruar prokurorit publik para se të fillonte procesi gjyqësor (gjykimi) dhe qartë bëri me dije se *Berisha* nuk ndodhej në paraburgim në momentin e kryerjes së vrasjes.

Akgjykimi në formë të shkruar shumë qartë e bazon vendimin e gjyqit në alibinë, që *Berisha* në momentin e vrasjes gjendej në paraburgim, dështimi i dy dëshmitarëve okular për të marr pjesë në seancën gjyqësore dhe fakti se shenjat e gishtërinjëve të marra nga shtëpia e viktimës nuk përputheshin me ato të *Berishës*. Në prill të vitit 2000, SMSJ-ja prezantoi një raport për sa i përket rekomandimit të Departamentit të Drejtësisë për të inicuar procedurën hetimore rreth sjelljes së gjyqit. Gjer më tani, asnjë veprim hetimor nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

Pas pyetjeve të ndritura nga SMSJ-ja, më 26 prill 2000, prokurori publik parashtroi ankesë kundër vendimit të gjyqit. Ankesa mbështetet në veçimin e deklaratave të dëshmitarëve okular dhe dy dëshmitarëve të tjerë nga lënda, refuzimi për t'i ekzaminuar dosjet (regjistrat) e Qendrës së Paraburgimit në Pejë dhe dështimi për t'i marrur në pyetje dëshmitarët okular gjatë seancës gjyqësore. Për shkak se Gjyqi i Qarkut nuk ia kishte dorëzuar aktgjykimin (vendimin e gjyqit) dhe ankesën e parashtruar *Berishës*, në pajtim me nenin 123 të LPP-së së RFJ-së, Gjyqi Suprem ktheu prapa dosjen e lëndës në mënyrë që ato ti jipen në vështrim *Berishës*. Pas vendimit të gjyqit për lirim, ishte shumë vështirë që të gjindet *Berisha* për qëllime të shërbimeve. Më 16 dhjetor 2000, pas skadimit të periudhës kohore të dedikuar për nojftim publik, aktgjykimi dhe ankesa konsideroheshin se ishin dhënë në vështrim.¹⁵ Më 1 mars 2001, SMSJ-ja ishte informuar për faktin se nojftimi ishte joadekuat dhe se kjo procedurë duhet të përsëritet. Më 15 mars 2001, u paraqit edhe zyrtarisht ankesa pranë Gjyqit Suprem.

¹ Njëri prej të burgosurve ishte rikapur më vonë (në vijim).

² Një gjykatës ndërkombëtar bëri publike shkuarjen e tij, hyri në fuqi më 14 Prill 2001.

³ Neni 116 i LPP-së së RFJ-së.

⁴ *Pasqyrë e Sistemit të Drejtësisë Penale të SMSJ-së*, faqja 70.

⁵ Seksioni 1(2) *Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64*.

⁶ Shihni paraqitjen për shtyp të UNMIK-ut të datës 20 Tetor 2000, *Gjykatësit Ndërkombëtar kanë "redukuar në mënyrë drastike" gjaset për të pasur anime gjyqësore nëpër Gjyqet e Kosovës: UNMIK*.

⁷ *Apostoloviqi* kishte kaluar mëse 13 muaj në paraburgim.

⁸ Gjykatësi plotësues si duket kishte ndëgjuar disa prej dëshmitarëve të tjerë në lidhje me rastin "*Gashët*" me qëllim që ti ndihmojë gjykatësit të posaemëruar hetues.

⁹ Prokurori publik ndërkombëtar i autorizuar për rastin "*Gashët*" pranoi dosjen e lëndës rreth 12 Tetorit të vitit 2000.

¹⁰ Neni 224 (1991) paragrafi 76.

¹¹ Në bazë të informatave me të cilat disponon SMSJ-ja kjo nuk ishte përkthyer nga përkthyesi në dosje.

¹² *Shih Nenin 291(1) dhe Neni 352 i LPP-së së RFJ-së*

¹³ *Vendimi për të lruar serbët e akuzuar për krime lufte është absurd*, 30 Janar 2001 AFP.

¹⁴ Faqja 65 et seq.

¹⁵ Shih Nenin 123(4) të LPP-së së RFJ-së.

Zvezdan Simiç

Më 8 gusht 2000, *Zvezdan Simiç* ishte shpallur fajtor për vrasje të dy Shqiptarëve të Kosovës dhe si rezultat i kësaj ishte dënuar me 8 vjet e 6 muaj burg. Në raportin paraprak të SMSJ-së ishin shprehur shqetësimet për sa i përket mos-përputhshmërisë (kontradiktat) së dëshmive me aktgjykimin e pruar. Kjo veçanërisht buron nga fakti se dëshmitarët kryesor të rastit kishin ofruar dëshmi konfuzuese dhe hipotetike sa i përket pranisë së *Simiqit* në vendin e ngjarjes ku kishte ndodhur vrasja. Avokati mbrojtës paraqiti ankesë kundër vendimit të Gjyqit Suprem të Kosovës. Ata gjithashtu përveç tjerash paraqitën pohimet e tyre për sa i përket animeve gjyqësore të cilat ishin sidomos të shprehura tek anëtarët e trupit gjykues. DD, kishte rekomanduar kolegjin e *Rregullores 64*.

Shtojca 1

<u>Krimet e luftës dhe krimet e krvera me motive etnike</u>				
<ul style="list-style-type: none"> • E bazuar në statistikat me të cilat disponon SMSJ-ja të datës 28 Shkurt 2001 • SK/SHK = përkatësia etnike e të pandehurit/viktimës • SHK: Shqiptar i Kosovës; Serb i Kosovës; RK: Rom i Kosovës 				
Statusi	Gjenocid ¹	Krimet e luftës ²	Vrasjet ³	Dhunimet ⁴
Kundër të cilëve është ngritur aktakuza	7 SK/SHK - 7	19 SK/SHK - 19	10 SHK/SK - 4 SK/SHK - 6	0
Kundër të cilëve nuk është ngritur aktakuza	0	1 SK/SHK - 1	0	0
Në paraburgim	1 SK/SHK - 1	5 SK/SHK - 5	5 SK/SHK - 2 SHK/SK - 3	0
Të ikur	5 SK/SHK - 5	13 SK/SHK - 13	1 SK/SHK - 1	0
Të arratisurit	1 SK/SHK - 1	3 SK/SHK - 3	2 SK/SHK - 2	0
Gjykimet e përfunduara	3	2 SHK/SHK - 1 SK/SHK - 1	15 SHK/SK - 4 SK/SHK - 10 RK/SHK - 1	2 SHK/RK - 2
Fajtor	1	1 SHK/SHK - 1	6 SK/SHK - 5 RK/SHK - 1	2 SHK/RK - 2
Të pafajshëm	2**	1*** SK/SHK - 1 RK/SHK - 3	2 SHK/SK - 2	0
Tërheqja e akuzës	1	4	9	0
Gjithsejt të pandehurit mbetur në paraburgim	1	4	9	9

¹ Neni 141 LPP e RFJ-së

² Neni 142 LPP e RFJ-së

³ Përfshihen edhe vrasjet e rënda, vrasjet dhe tentim vrasjet

⁴ Përfshihen edhe dhunimi dhe dhunimi i rëndë

** Shih analizat rreth rasteve *Milosh Jokiq* dhe *I Mituri "X"* në Seksionin 7: Akuzat për gjenocid.

*** *Sava Matiq* nuk ishte shpallur fajtor për krime lufte, mirëpo ishte shpallur fajtor për sulm.

PJESA 9: AKUZAT PËR GJENOCID

Hyrje

Gjenocidi në përgjithësi mirret si njëra prej krimeve më serioze ndërkombëtare që prej ekzistimit të njerëzimit. Në vijë me seriozitetin e saj, barra e provës për të dëshmuar gjenocidin është mjaft e madhe. Me qëllim që të shpallet një person fajtor për gjenocid, pala ndjekëse (akuzuese) duhet të dëshmojë që, me qëllim që të shkatërrojë në tërësi apo pjesërisht një grup etnik, i pandehuri ka kryer një numër të veprave veçanërisht të emërtuara, kundër individëve të cilët i ka marrë për shënjestër, për shkak se i takojnë këtij apo atij grupi etnik.

Pragu (kufiri) i kufizimeve ekstreme për sa i përket dëshmive për gjenocidin e kryer është zbatuar në rastin *Prokurori kundër Jelisiçit*.¹ *Jelisiçi* ishte shpallur fajtor në 16 pika të akuzës për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe gjithashtu ishte shpallur fajtor edhe në 15 pika të tjera të akuzës për krime kundër njerëzimit – mirëpo ishte liruar nga një pikë e akuzës e ajo ishte akuza për gjenocid. Përderisa Dhoma e Gjykimit pranë Tribunalit Ndërkombëtar për krime lufte për territorin e Ish-Jugosllavisë ishte kënaqur me faktin se kërkesa *actus reus* për gjenocid ishte përmbushur mjaft – vrasja e pjesëtarëve të një grupi etnik të mbrojtur – **pala ndjekëse kishte dështuar që të dëshmojë se vrasjet ishin kryer me qëllim të pastër gjenocidal.**

Në bazë të statistikave me të cilat disponon SMSJ-ja, janë gjithsejt 7 individë për të cilët dyshohet se kanë kryer apo kanë qenë të involvuar në kryerjen e gjenocidit. Për momentin vetëm njëri prej tyre gjendet në paraburgim. Gjithashtu kemi edhe tre gjykime të përfunduara që kanë të bëjnë me akuza për gjenocid. Në dy prej tre këtyre gjykimeve akuzat ishin redukuar dhe të pandehurit ishin shpallur fajtor për krime të luftës dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm. *Miroslav Vuković* ishte shpallur fajtor për gjenocid nga ana e trupit gjykues të përbërë prej një shumice të gjykatësve Shqiptarë dhe një gjykatësi ndërkombëtar më 18 janar 2001, dhe si rezultat i kësaj ishte dënuar me 14 vjet burg.

I. Gjenocidi në kuadër të ligjit vendor

Ish Jugosllavia ishte bërë anëtare e Konventës për Gjenocid më 11 dhjetor 1948 si dhe kishte ratifikuar Konventën në fjalë më 29 gusht 1950. Neni 141 i LP së RFJ-së, përmban definicionet për gjenocidin ashtu siç e parasheh ligji vendor. Definicioni i ligjit vendor për gjenocidin përfshin edhe “zhvendosjen me forcë të popullatës” si një akt i cili mund të përbëjë një *actus reus* për gjenocid. **Është shumë me rëndësi që të ceket, megjithatë, se nuk ngjan se zhvendosja me forcë e personave nga shtëpitë e tyre në vete do të plotësojë qëllimin e kërkuar për të shkatërruar një grup të tillë. Pala ndjekëse (akuzuese) duhet të tregojë se zhvendosja me forcë e popullsisë ishte një mjet i “cili e vën grupin në fjalë në kushte të atilla jetese që sjellin shfarosjen e plotë ose të pjesshme të grupit,” vepër kjo e përmendur në nenin 141 të LP-së së RFJ-së.**

¹ *Prokurori kundër Goran Jelisiçit* 14 dhjetor 1999 në <http://www.icty.org>.

II. Aktakuzat/Gjykimet

Milosh Jokiq

Milosh Jokiq ishte akuzuar për gjenocid më 25 shkurt 2000 në Gjyqin e Qarkut në Gjilan. Aktakuza pohon se, me qëllim ‘që të shkatërrojë kombin shqiptar’, më 8 maj 1999 *Jokiq*, së bashku me 9 paramilitarë të tjerë, hapën zjarr nga armët automatike në ajër, duke shkaktuar panik e cila përfundimisht rezultoi me një dëbim të mëse 2000 banorëve të fshatit Verban. Aktakuza vazhdon për mëtej në të cilën thuhet se, në datat e ndara njëra gjatë muajit prill e tjetra gjatë muajit maj 1999, *Jokiq* ishte përgjegjës për vrasjen e një burri Shqiptar si dhe urdhëroi ekzekutimin e një familje tjetër rome.

Gjykimi i *Jokiqit* u mbajt në Gjyqin e Qarkut në Gjilan, në data që ndryshonin njëra me tjetrën, njëra më 15 maj 2000 dhe 20 Shtator 2000. Gjykimi u mbajt para trupit gjykues i cili përbëhej kryesisht nga gjykatësit shqiptar dhe një ndërkombëtar, përderisa akuza udhëheqej nga prokurori publik me përkatësi Shqiptare. Në ditën e parë të gjykimit aktakuza e dytë, njëra pikë e së cilës i referohet dhunimit të një femre Shqiptare, i ishte bashkangjitur aktakuzës së parë.

Përkundër faktit se prokurori publik vazhdoi t’i përmbahej akuzës për gjenocid gjatë tërë procesit gjyqësor, siç ishte pruar edhe me aktakuzë, gjyqi e shpalli fajtor *Jokiqin* për krime lufte dhe e dënoi me 20 vjet burg.

Igor Simiq

Dragan Jovanoviq, Igor Simiq, Srdjan Aleksiç, Vlastimir Aleksiç, Branislav Popoviq dhe Tomislav Vučković janë persona kundër të cilëve ishte ngritur aktakuza për gjenocid më 20 qeshor 2000. Aktakuza pohon se të pandehurit, duke vepruar së bashku, vranë 26 Shqiptarë të Kosovës më 14 prill. Aktakuza vazhdon për mëtej, ku thuhet se në periudhën kohore në mes të marsit dhe majit të 1999-tës, *Dragan Jovanoviq* dhe *Tomislav Vučković* kishin hyrë në mëse 100 shtëpi dhe lokale biznesi të cilat ishin pronë e Shqiptarëve banorë të Mitrovicës, kishin urdhëruar banorët në fjalë që ti lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të ia mbajnë për Shqipëri dhe pas kësaj kishin plaçkitur dhe djegur pronat në fjalë. Për *Dragan Jovanoviqin* gjithashtu thuhet të ketë vjedhur para dhe ari nga Shqiptarët e Kosovës banorë të Mitrovicës si dhe thuhet të ketë qenë bashkëpjesëmarrës në vrasjen e dy Shqiptarëve të Kosovës në Mitrovicë.

Aktakuza vazhdon mëtej, ku thuhet se “në bazë të deklaratave të dhëna gjatë procedurës hetimore pa kurrfarë dyshimi është caktuar se të pandehurit kanë kryer veprë penale për të cilën akuzohen me këtë akt padi [gjenocid në bazë të Nenit 141 të LP të RFJ-së] në kohën, vendin, me mënyrën dhe motivin e cila është e paraqitur saktësisht në deklaratë.” Për më shumë, të pandehurit “ishin pregaditur me paramendim dhe kanë kryer me plan një *mori veprash penale të caktuara kundër Shqiptarëve të Kosovës banorë të Mitrovicës.*” Veprat penale të tyre ishin kryer “*me qëllim të vetmin, për të shkatërruar, që është për të dëbuar Shqiptarët nga Mitrovica, që është, nga Kosova me qëllim që të krijohet një shtet etnikisht i pastër serb.*” (me theks të shtuar)

Gjykimi i *Igor Simiqit* filloi më 5 dhjetor 2000 para trupit gjykues të Gjyqit të Qarkut të Mitrovicës. Gjykimi është ende duke vazhduar para trupit gjykues të përbërë kryesisht nga gjykatësit Shqiptarë dhe një gjykatës ndërkombëtar (i cili vepron në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues). Ndjekja penale udhëheqet nga një prokuror ndërkombëtar. Procedurat gjyqësore kundër të pandehurve të tjerë janë ndaluar për momentin për shkak të ikjes së të pandehurve nga Burgu i Mitrovicës në gusht dhe shtator 2000 dhe për shkak të zbatimit në praktikë të *Rregullores 2001/1*, e cila parandalon me ligj mbajtjen e *gjykimeve në mungesë* për të gjitha rastet të cilat kanë të bëjnë me shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar.

Gjatë gjykimit, *Simiqi* mohoj krimet për të cilat akuzohej dhe ngriti mbrojtjen e alibisë. Dëshmia, qoftë ajo mjeko – ligjore apo deklaratë e drejtëpërdrejtë e dhënë nga ana e ndonjë dëshmitari, nuk ishte paraqitur për të treguar lidhjen e drejtëpërdrejtë të *Simiqit* me vrasjet në fjalë. Për më shumë, asnjë dëshmi nuk ka qenë e prezentuar me qëllim që të tregojë se *Simiqi* kishte vepruar në bazë të një plani të hollësishëm i cili kishte për qëllim shkatërrimin e një grupi etnik siç ishte ai Shqiptar, e as se veprat e tija ishin pjesë e një procesi të shkatërrimit të përmasave të mëdha dhe sistematik të atij grupi.

Një dëshmitar Shqiptar deklaroi se *Simiqi* ishte njëri prej paramilitarëve me maska që vepronin në atë kohë. Ajo e njohu atë në bazë të madhësisë së trupit të tij. Më vonë, sidoqoftë, ky dëshmitar deklaroi se paramilitarët *duket* të kishin qenë fqinjë të Shqiptarëve për shkak të faktit se ata mbanin maska, dhe andaj edhe *Simiqi* duket të kishte qenë njëri prej tyre.

Një dëshmitar Shqiptar dëshmoi gjatë seancës gjyqësore për palën akuzuese gjatë së cilës ai deklaroi se *Simiqi* ishte fqiu i saj që nga viti 1993 si dhe ajo e njohu edhe zërin e tij në bazë të mënyrës se si ai e kishte Shqiptuar shkronjën R . Ajo paraprakisht deklaroi para gjykatësit hetues se ajo kishte arritur që ta njeh *Simiqin* për arsye se ai (*Simiqi*) për një moment kishte hequr maskën e tij. Mbrojtja vazhdoi mëtej për të paraqitur një dokument në bazë të të cilit dëshmitari ishte duke pranuar ndihmë humanitare nga Kryqi i Kuq në Novi Pazar në kohën kur janë kryer ato vepra penale dhe për këtë arsye nuk ka pasur mundësi që të jetë dëshmitare e ngjarjeve në të cilat thuhet të ketë marrur pjesë *Simiqi*. Autenticiteti i këtij dokumenti për momentin është duke u ekzaminuar.

Një mashkull i nacionalitetit Shqiptar dëshmoi se kishte parë 4-5 persona me maska dhe uniforma të zeza të cilët posedonin automatikë. Ai ishte në gjendje që ta njoh *Simiqin* në bazë të defekteve (çrregullimet) gjatë foljes, edhe pse dëshmitari nuk ishte në gjendje të imitojë defektin (çrregullimin) në fjalë. Dëshmitari vazhdoi mëtej gjatë së cilës ai deklaroi se po të mos kishte qenë *Simiqi* involvuar në atë masakër, ai do të shpallej armik i popullit Serb. Në bazë të dëshmitarit, *fakti se një deklaratë e tillë nuk është bërë është dëshmi e mjaftueshme e cila tregon për involvimin e tij në këtë vepër*. Dëshmitari shpeshherë siguronte deklaratat (dëshmi) të cilat i kishte ndërgjuar nga personat e tjerë *ku majde edhe pranoi se kishte dhënë tre deklaratat të rrejshme para se të dëshmonte para gjyqit* – secila deklaratë ndryshonte në masë kritike nga dëshmia e dhënë para gjyqit.

Më 12 shkurt 2001 një person “X” për të cilin pohohej ti kishte shpëtuar masakrës dëshmoi para gjyqit në cilësinë e dëshmitarit të akuzës. Personi X, përveç tjerash, dëshmoi mbi involvimin e *Simiqi* në ndarjen e meshkujve prej grave dhe fëmijëve. Në të vërtetë, personi X përfundoi se *Simiqi* ishte ai i cili urdhëronte se kush duhej vrarë. Pas marrjes në pyetje kryqëzore nga ana e avokatit mbrojtës, personi X bëri me dije se kishte parë një video kasetë në të cilën *Simiqi* mirrej në pyetje nga ana e Xhendarmerisë Françeze. Kaseta shumë lehtë mund të blehet lehtë, dhe andaj edhe dëshmitarët e tjerë kanë mundur ta shohin. Personi X vazhdoi për më tepër dhe deklaroi se deklaratat e tij mund të ndërrojë në ndërkohë nëse në të ardhmen ai do të fitojë informata të reja në këtë drejtim, dhe gjithashtu deklaroi se ka gjasa që video kaseta në fjalë të ketë mundur të ndikojë në dëshminë e tij para gjyqit. Fotografitë e të pandehutit të cilat bënin me dije se ai ishte një kriminel lufte si duket ishin shfaqur menjëherë pas përfundimit të konfliktit. Pas marrjes në pyetje, si duket video kaseta me të vërtetë ekziston, mirëpo nuk përmban detajet për të cilat pohonte dëshmitari. Video inçizimi është një dokumentar për Xhendarmerinë Françeze, e cila përmban një pjesë në të cilën shfaqen *Simiqi* së bashku me të burgosurit e tjerë, mirëpo nuk i referohet marrjes në pyetje.

Më 14 shkurt 2001 kryetari ndërkombëtar i trupit gjykues bëri me dije se gjykimi duhet të shtyhet për shkak të përkthimit të dobët të procesverbalit së dëgjimeve të mbajtura gjatë procedurës hetimore. Avokati mbrojtës bëri vërejtje sa i përket vazhdimit të gjykimit në të ardhmen, duke e argumentuar me faktin se pasaktësitë e dosjeve me rëndësi kritike është dashur që të vërehen para mbajtjes së gjykimit. Në fillim të marsit 2001, pajisjet e përkthimit ishin prishur. Më 19 mars 2001, kryetari i trupit gjykues dhe prokurori publik u ankuan gjatë seancës gjyqësore se nuk janë bërë kurrfarë përpjekjesh për të rregulluar pajisjet e përkthimit.

Hetimi dhe aktakuza

Simiqi ishte arrestuar dhe burgosur më **11 gusht 1999** dhe ishte mbajtur në paraburgim deri në lirimin e tij në prill 2001. Përkundër periudhës së gjatë të paraburgimit, SMSJ, mendon se dëshmitë e prezentuara (paraqitura) para gjykatësit hetues dhe të paraqitura në aktakuzë nuk mbështesin akuzën për gjenocid. Dispozitat e LPP të FRJ për parandalimin e kësaj ndjekje penale nuk janë përfillur.

Sipas ligjit të zbatueshëm, gjykatësi heutes do të ndërprej shqyrtimin (ekzaminimin) preliminar kur gjen se “çështja është sqaruar në mënyrë të mjaftueshme” që aktakuza mund të ngritet.¹ Shkresa pastaj i dorëzohet prokurorit publik nga i cili kërkohet të bëjë një prej tri gjërave: të parashtrijë kërkesën për hetime plotësuese, të ngrisë aktakuzën apo të heq dorë nga ndjekja.²

Dëshmia e prezentuar para gjykatësit hetues sipas SMSJ-së nuk ka knaqur standardet e kërkuara për aktakuzë, sepse nuk ka pasur “dëshmi të mjaftueshme për dyshime të bazuara” se i pandehuri ka kryer veprën penale të gjenocidit; pra gjithsesi gjykatësi hetues është ai i cili mund të vlerësojë nëse është arritur kushti i “dyshimit të bazuar”.

¹ neni 74 (1) LPP i RFJ

² neni 174 (2) i LPP të RFJ

Edhe pse prokurori publik ka të drejtë të kërkoj plotësimin e hetimeve, prokurori publik vendor këtë nuk e kishte bërë. E as avokati mbrojtës nuk e kishte kundërshtuar propozim akuzën. Aktakukza bëhet përfundimtare atëher kur nuk kundërshtohet, apo kur kundërshtimi hudhet apo kur me rastin e pranimit të aktkuzës, kryetari i kolegjit kërkon një trup gjykues për të shqyrtuar ankesën kundër aktkuzës ndërsa aktakuza mbështetet.

LPP i FRJ, parasheh obligimin që aktakuza **duhet** të përbëj, në mes tjerash, “rekomandimin e provave të cilat duhet të nxirren në seancën kryesore (dhe) arsyetimin në të cilin sipas rezultatit të hetimit përshkruhet gjendja e çështjeve, shenohen provat me të cilat faktet vendimtare vërtetohen”.¹

Aktakuza në këtë rast pohon se Simic, së bashku me tjerët, “ka marrur jetërat e 26 Shqipëtarëve...sipas (marrëveshjes) paraprake”. Arsyetimi në aktkuzë thot se “këta dëshmitarë e kanë përshkruar në mënyrë shumë bindëse mënyrën e akcioneve dhe aktiviteteve të cilat i kanë ndërmarrë të pandehurit (dhe) kanë konfirmuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale të vrasjes së 2 personave...i pandehuri kishte udhëhequr akcionin e ekzekutimit të njerëzve (gjashtë)të rinjë”.

Por aktakuza nuk përmban ndonjë fakt i cili do të “vërteton” pohimet me fakte “vendimtare”. Kjo është për shkak se rezultatet e ekzaminimit nuk kishin implikuar *Simic* në vrasjen e 26 personave, as si kryesor apo në lidhje me teorinë e bashkëpjesmarrjes për të plotësuar kushtet e kërkuara nga ligji i zbatueshëm për akuzim, respektivisht “dyshimin e bazuar” se i pandehuri kishte kryer veprën penale. Çdo gjë nën “dyshimin e bazuar” nuk do të mjafton. Komentet ndaj LPP të RFJ-së theksojnë se “*paraktika gjyqësore...është se dyshimi i thjeshtë është i pamjaftueshëm...dyshimi duhet të jetë i bazuar, i bazuar në të dhëna konkrete të një cilësie të caktuar e cila është mjaft e fuqishme për justifikuar dyshimin e bazuar*”.²

Pamarrë parasysh se avokati mbrojtës nuk kishte kundërshtuar aktakuzën, LPP i FRJ lejon mundësinë për kryetarin e kolegjit të paraqesë kërkesën nga trupi gjykues për rishqyrtimin e aktkuzës në bazë të dispozitave për kundërshtim.³ Kjo përfshinë edhe të drejtën për hudhjen e aktkuzës atëherë kur nuk ka prova të mjaftueshme për dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer krimin.⁴ Nuk është parashtruar asnjë kërkesë e tillë.

LPP i FRJ obligon prokurorin publik që të mbroj aktakuzën para gjykatës.⁵ Më tutje parashikon mundësinë për hjekjen dorë nga aktakuza para senacës kryesore (neni 51 dhe 286 i LPP të FRJ). Pasi të hiqet dorë nga aktakuza asgjë tjetër nuk mbetet sipas LPP të FRJ, që të parandaloj prokurorin publik apo paditësin privat prej ngritjes së aktkuzës së re të bazuar në akuza të reja. Kjo mundësi në rastin *Simic* nuk është thirrur. Me 9 prill 2001, pas dëgjimit të thënieve të dëshmitarëve gjykimi ka zgjatur pesë muaj, prokurori publik i cili ka zavendësuar prokurorin vendor gjatë procedurës para seancës kryesore, kishte hequr dorë nga aktakuza dhe *Simic* ishte liruar.

¹ neni 262 (1) 5&6 i LPP të RFJ

² autorët Vasiljevic, Grubac në *Komentaret e LPP të RFJ*

³ neni 277 (1) LPP të RFJ

⁴ neni 270 (4) i LPP të RFJ

⁵ neni 45 (2) 3 LPP të RFJ

Miroslav Vučković

Gjyqi i Qarkut në Mitrovicë më 29 nëntor 1999 ngriti aktakuzën për gjenocid ndaj **Miroslav Vučkovićit** dhe **Bozhur Bisevacit**. Aktakuza citon se, ndërmjet 22 marsit 1999 dhe majit 1999, të pandehurit, së bashku me individë të tjerë emrat e të cilëve janë të panjohur, kishin hyrë në dy fshatra të Mitrovicës. Të pandehurit thuhet të kenë hapur zjarr nga armët e tyre dhe kishin kërcënuar se do ti vrasin banorët e këtyre fshatrave me qëllim që ti shtyjnë ata me forcë që t'i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të ikin për në pyjet dhe fshtrat përreth. Një numër i shtëpive të këtyre fshatrave ishin plaçkitur dhe djegur mëpastaj, e cila gjë kishte rezultuar në vdekjen e një gruaje të moshuar Shqiptare.

Aktakuza pohon se këto vepra ishin kryer “me qëllim që të zhvendosin me forcë (shtrëngim) popullatën shqiptare dhe me qëllim që tërësisht apo pjesërisht të shkatërrojnë komunitetin shqiptar.” Në shpjegimin e bashkangjitur aktakuzës prokurori pohon se veprat në fjalë ishin kryer gjithashtu me qëllim që të “zhvendosin me forcë popullatën shqiptare.” Mëtej theksohet se veprimet e të pandehurve ishin kryer me qëllim të vetmin e ajo është “shtyerja e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar” që t'i lëshojnë shtëpitë e tyre dhe me qëllim të pengimit të kthimit të tyre.

Gjykimi i **Miroslav Vučkovićit** filloi në gjyqin e qarkut në Mitrovicë më 19 tetor 2000. trupi gjykues i përbërë nga një gjykatës ndërkombëtar dhe 4 gjykatës Shqiptarë, duke përfshirë këtu edhe kryetarin e trupit gjykues. Ndjekja penale udhëheqej nga ana e prokurorit publik me përkatësi Shqiptare. Në fillim të gjykimit, **Vučković** kishte kaluar mëse 14 muaj në paraburgim, përderisa **Bisevac** ishte i arratisur në atë moment (gjykimi i **Bisevacit** ishte ndërprerë duke bazuar në *Rregulloren 2001/1*).

Shumë prej dëshmitarëve të thirrur nga ana e prokurorit publik siguroi dëshmi e cila nuk përputhej me deklaratat paraprake të tyre të dhëna para gjykatësit hetues. Dëshmitarët mjaft shpesh kishin dhënë dëshmi të natyrës spekuluese dhe asnjë dëshmi mjeko – ligjore nuk ishte paraqitur me qëllim që ti vërtetojnë (mbështesin) pohimet e paraqitura në aktakuzë. Për sa i përket dy pohimeve për vrasje, nuk ishin gjetur trupat e pajetë të viktimave dhe nuk ishin paraqitur kurrfarë dëshmi mjekësore apo mjeko – ligjore.

Një numër i dëshmitarëve madje dhanë edhe dëshmi që nuk vërtetojnë ndodhjen e veprave të vrasjes dhe tentim vrasjes të cilat nuk janë pjesë e aktakuzës së ngritur kundër **Vučkovićit**. Një dëshmitar tjetër deklaroi se **Vučković** mjaft i njohur para konfliktit si person i cili i kishte rrahur Shqiptarët në të kaluarën. Kjo dëshmi nuk ishte e rëndësishme dhe ishte tejet prejjudikuese.

Dëshmia e paraqitur për palën ndjekëse nuk treguan se a ishte **Vučković** i angazhuar në zbatimin e planit për shkatërrimin e grupit etnik Shqiptar apo zhvendosjes së tyre në një vend ku do të mbretërojnë aso kushte në të cilat edhe shkatërrimi i tillë i popullatës do të mund të ndodh. Një dëshmitar tjetër e përshkroi **Vučkovićin** si një person i cili e kishte dëbuar fqinun e tij Shqiptar nga prona e tij duke i thënë se kjo është “tokë serbe” dhe se ai duhet ta lëshojë atë vend sa më shpejtë. Një dëshmitar tjetër, gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit publik, përshkroi se si këta persona të cilët kishin gjetur strehim në vendin e quajtur Vinarce mëpastaj i ishin nënshtruar sulmeve të ndryshme dhe ishin

shtyer me forcë që ta lëshojnë atë vend dhe ti bashkangjiten konvojit të njerëzve të cilët ishin duke shkuar për në Shqipëri. Ky dëshmitar vazhdoi për mëtej dhe deklaroi se në mes të marsit 1999 dhe 15 prillit 1999, sulmet kundër tyre ishin dizajnuar me qëllim të frikësimit të njerëzve për ti lëshuar shtëpitë e tyre, mirëpo gjatë këtyre sulmeve nuk ishte vrarë askush.

Në krye të gjithë kësaj, dëshmia ka bërë me dije që *Vuçkoviqi* ka mundur të jetë i involvuar në ato ngjarje si kryesor, apo si ndihmës dhe bashkëpjesëmarrës në zhvendosjen e një numri të paspecifikuar të Shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre në fshatrat Gusavc dhe Vinarc, në djegjen e një numri të shtëpive dhe vjedhjen e bagëtisë dhe pronave të tjera. Gjatë këtyre veprimeve *Vuçkoviqi* ishte parë në një mori rastesh me veshje civile, uniformë të paramilitarëve apo të policisë.

Dëshmia, megjithatë, ishte e pamjaftueshme që të dëshmojë qëllimin e kërkuar gjenocidal për të shkatërruar tërësisht apo pjesërisht një grup etnik siç është ai shqiptar. Definicioni i gjenocidit të cilin e parasheh ligji vendor kërkon që të dëshmohet “qëllimi për të shkatërruar një grup nacional, etnik, racor apo fetar në tërësi apo pjesërisht...” Pala ndjekëse duhet të tregojë se *Vuçkoviqi* kishte pasur qëllim që të shkatërroi një grup etnik siç është ai Shqipëtar – se këto veprime nuk kanë qenë të dizajnuara vetëm për të shkatërruar komunitetet e fshatrave për të cilat vepra ai edhe akuzohet.

Në esencë, prokurori publik i kombinoj dëshmitë për zhvendosje në një dëshmi të mjaftueshme për të treguar qëllimin për të shkatërruar një grup etnik siç është ai shqiptar. Me qëllim të përmbushjes së kësaj qasjeje, ai është dashur që të tregojë se me zhvendosje të njerëzve prej shtëpive të tyre ai ka pasur qëllim që të shkatërroi këtë grup etnik, së paku pjesërisht. Nuk kishte dëshmi të tjera të cilat do ta mbështetnin këtë konstatim.

Në fakt, pas lirimit të *Vuçkoviqit* nga dy pika të akuzave për vrasje të cilat përmbaheshin në aktakuzë, nuk ekzistonte ndonjë dëshmi e cila do të tregonte se veprimet e *Vuçkoviqit* do të shpënin drejt apo ishin dedikuar që të shpiejnë drejt një shkatërrimi të Shqiptarëve të Kosovës. Veprat në fjalë duket të kenë qenë të kufizuara për nga brezi i fshatrave specifik siç janë ai i Gusavcit dhe Gornji Suvi Do, fshatra këta të komunës së Mitrovicës. Prokurori publik nuk paraqiti ndonjë dëshmi e cila do të tregojë se *Vuçkoviqi* ka vepruar në bazë të një plani të gjerë të shkatërrimit sistematik të popullatës shqiptare. Gjithashtu nuk u paraqit asnjë dëshmi e cila do të tregojë se *Vuçkoviqi* kishte zhvendosur banorët Shqiptarë të këtyre fshatrave duke i vendosur ata në aso kushte të cilat sjellin shfarosjen e tyre.

Përkundër dështimeve që kishin ndodhur në rastin kundër *Vuçkoviqit*, ai ishte shpallur fajtor për gjenocid dhe ishte dënua me 14 vjet burg. Një anëtar i trupit gjykues nuk ishte pajtuar me këtë vendim.⁵ Gjer më tani nuk është siguruar akgykimi i shkruar i cili është në shkelje të ligjit të aplikueshëm.⁶

⁵ Konferenca e përbashkë për shtyp e KB, OSBE, UNHCR dhe BE-së, 19 janar 2001

⁶ Neni 356 (1) LPP i RFJ-së

Është kundër kësaj çka është thënë gjer më tani, fakti se OSBE-ja ka publikuar një botim për shtyp, më 18 janar 2001, në të cilën OSBE-ja shpreh shqetësimet e saja për faktin se aktgjykimi ishte “kontradiktor” me dëshminë e dhënë dhe kërkonte që të parashtrohet një ankesë para trupit gjykues të paraparë me *Rregulloren 64* shumicën e anëtarëve të së cilës e përbëjnë gjykatësit ndërkombëtar. Për momentin është e paqartë se a do të sigurohet një kolegji i tillë i gjykatësve. Kryetari i kolegjit i cili gjykonte rastin në fjalë iu përgjegj pyetjeve të mediave duke deklaruar se aktgjykimi i pruar kishte baza të mjaftueshme ligjore dhe ishte i pruar në dritën e “viktimizimit të një popullatë të tërë e cila jeton nëpër vatrat e saja dhe deportimit të tyre për ti vënë ata në kushte të tmerrshme të jetesës, plaçkitjes së gjërave të vlefshme, djegjen e shtëpive dhe banesave të tyre...”

III. Trajnimi mbi Ligjin Ndërkombëtar Humanitar

Në shtator të vitit 2000, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë dhe Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë për territorin e Ish – Jugosllavisë, organizoi një seminar për gjykatësë, prokurorë publik si dhe për një trupë të këshilltarëve mbrojtës si vendor ashtu edhe për ata ndërkombëtar.⁷ Ky seminar paraprakisht kishte për qëllim të sigurojë një trajnim i cili do të jetë një pjesë e pregaditjeve për gjykatën për krimet e luftës në Kosovë dhe krimet etnike (KËECC), një projekt ky i cili ishte braktisur mëpastaj. Përderisa iniciativat e tilla duhet mirëseardhur, mbarëvajtja prezente e gjykimeve për gjenocid dhe ndjekja penale e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar kanë përkrahur idenë për të siguruar që rastet e tilla të ndjeken penalisht nga ana e prokurorëve ndërkombëtar me përvojë të duhur në ligjin ndërkombëtar penal dhe atë humanitar, përderisa që gjithashtu edhe shumica e anëtarëve të trupit gjykues të jenë ndërkombëtarë.

⁷ Ky seminar përfshiu përaafërsisht 34 gjykatësë dhe prokurorë si dhe 6 avokat mbrojtës. Prej 40 pjesëmarrësve të këtij seminari vetëm tre prej tyre vinin nga rradhët e grupeve minoritare. Përfaqësuesi i IGJK-së bëri me dije se kjo ka ndodhur, përveç tjerash, edhe për shkak të problemeve të sigurisë me të cilat ballafaqohen gjykatësit minoritar.